



Plani i Menaxhimit

PARKU KOMBËTAR I EKOSISTEMIT NATYROR DETAR PRANË GADISHULLIT TË KARABURUNIT DHE ISHULLIT TË SAZANIT

Drafti përfundimtar



Dhjetor 2014

Përgatitur nga:



Plani i Menaxhimit për Parkun Kombëtar të Ekosistemit Natyror Detar pranë Gadishullit të Karaburunit dhe Ishullit të Sazanit

Plan i Menaxhimit u përgatit në bazë të Marrëveshjes së Grantit ndërmjet zyrës së UNDP-së në Shqipëri dhe Programit për Mesdheun të WWF-së datë 07/04/2014.

Hartimi i Planit të Menaxhimit:

Zeljka Rajkovic, WWF

Genti Kromidha, INCA

Fotot

Fotoja e kopertinës nga Zeljka Rajkovic

Fotot në Figurën 17 nga INCA dhe Zeljka Rajkovic

Perkthimi ne shqip: Esmeralda Subashi

Citime

Z. Rajkovic dhe G. Kromidha (2014) Përmbledhje e Planit të Menaxhimit për Parkun Kombëtar të Ekosistemit Natyror Detar pranë Gadishullit të Karaburunit dhe Ishullit të Sazanit, UNDP, 80 faqe + Shtojcat.

Tabela e Përmbajtjes

1	HYRJE	6
2	PËRSHKRIMI I ZONËS SË MBROJTUR	9
2.1	VENDNDODHJA, KUFIJTË DHE STATUSI LIGJOR	9
2.2	POLITIKAT DHE LEGJISLACIONI	12
2.2.1	LEGJISLACIONI NDËRKOMBËTAR	12
2.2.2	LEGJISLACIONI I BE-SË	12
2.2.3	LEGJISLACIONI KOMBËTAR	13
2.3	GRUPET E INTERESIT	15
1.1.1.	ROLET DHE PËRGJEGJËSITË E GRUPEVE TË INTERESIT	15
2.3.1	MATRICA E ANGAZHIMIT TË GRUPEVE TË INTERESIT	17
2.4	PËRSHKRIMI I SISTEMIT NATYROR TË ZM-SË	19
2.4.1	HYRJE	19
2.4.2	PËRSHKRIM I PËRGJITHSHËM	19
2.4.3	KLIMA	20
2.4.4	GJEOLGJIA, TOPOGRAFIA DHE GJEOMORFOLOGJIA	20
2.4.5	HIDROLOGJIA, DRENAZHIMI DHE BURIMET UJORE	20
2.4.6	BURIMET E BIODIVERSITETIT	20
2.5	FACILITETET EKZISTUESE TË ZONËS SË MBROJTUR DHE PËRDORIMI AKTUAL NGA VIZITORËT	25
2.5.1	ZYRA DHE STENDAT E INFORMACIONIT	25
2.5.2	AKSESI DHE PLAZHET	25
2.5.3	SHËTITJET ME VARKA	25
2.5.4	ZHYTJET	26
2.6	SISTEMI SOCIAL - EKONOMIK	26
2.6.1	POPULLSIA DHE FSHATRAT	26
2.6.2	STRUKTURA E FAMILJEVE	26
2.6.3	ARSIMI	26
2.6.4	PUNËSIMI	26
2.6.5	EMIGRIMI	27
2.6.6	BESIMI FETAR	27
2.6.7	VEPRIMTARITË EKONOMIKE	27
2.6.8	INFRASTRUKTURA	29
2.6.9	PRONËSIA MBI TOKËN	30
2.7	STRUKTURA AKTUALE DHE E PARASHIKUAR E QEVERISJES	31
2.8	PEIZAZHI DHE TRASHËGIMIA KULTURORE	32
2.9	STUDIMET DHE KËRKIMET SHKENCORE NË LIDHJE ME ZONAT E MBROJTURA DETARE.	32
3	VLERËSIMI I ZONËS SË MBROJTUR DHE ANALIZA E KUADRIT INSTITUCIONAL	34
3.1	ANALIZA E VLERAVE DHE KËRCËNIMEVE	34
3.1.1	VLERAT	34
3.1.2	KËRCËNIMET	37
3.1.3	MODELET KONCEPTUALE	40
4	MENAXHIMI I ZONËS SË MBROJTUR	44
4.1	VIZIONI	44
4.2	TEMAT, OBJEKTIVAT DHE VEPRIMTARITË E PLANIT TË MENAXHIMIT	44
4.2.1	TEMA A: RUAJTJA E BIODIVERSITETIT	45
4.2.2	TEMA B: TRASHËGIMIA KULTURORE DHE PEIZAZHI	48
4.2.3	TEMA C: MBËSHTETJA E KOMUNITETEVE VENDASE DHE PËRDORIMI I QËNDRUESHËM I BURIMEVE NATYRORE	50
4.2.4	TEMA D: NDËRGJEGJËSIMI DHE EDUKIMI	57

4.2.5	TEMA E: MENAXHIMI, ADMINISTRIMI DHE QËNDRUESHMËRIA	60
4.3	ZONAT E MENAXHIMIT TË PKD “KARABURUN-SAZAN”	64
4.3.1	PËRGATITJA E PLANIT TË ZONIMIT	64
4.3.2	ZONAT E MENAXHIMIT	65
5	PLANI FINANCIAR	74
5.1	PLANI I BURIMEVE NJERËZORE	79
6	MONITORIMI DHE VLERËSIMI I MENAXHIMIT	79
6.1	MONITORIMI I PLANIT TË MENAXHIMIT	79
6.2	VLERËSIMI I EFEKTIVITETIT TË MENAXHIMIT	80
7	REFERENCAT / BIBLIOGRAFIA	81
8	SHTOJCAT	83
8.1	SHTOJCA 1: LLOJET DETARE ME INTERES NDËRKOMBËTAR NË ZONËN KARABURUN-SAZAN QË JANË RENDITUR NË KONVENTAT MË TË RËNDËSISHME	84
8.2	SHTOJCA 2: LLOJET DETARE ME INTERES KOMBËTAR NË ZONËN KARABURUN-SAZAN (SIPAS LISTËS SË KUQE SHQIPTARE 2007)	86
8.3	SHTOJCA 3: PËRMBLEDHJE E ZONAVE TË MBROJTURA NGA PESHKIMI	87
8.4	SHTOJCA 4: HARTA E PARKUT KOMBËTAR DETAR “KARABURUN-SAZAN” (VLERAT, KËRCËNIMET, ZONAT)	88

Lista e Tabelave

TABELA 1:	TEMAT, QËLLIMET DHE OBJEKTIVAT E MENAXHIMIT	8
TABELA 2:	LEGJSLACIONI PËRKATËS NDËRKOMBËTAR PËR PKD “KARABURUN-SAZAN”	12
TABELA 3:	LISTA E LEGJSLACIONIT PËRKATËS KOMBËTAR PËR PKD “KARABURUN-SAZAN”	13
TABELA 4:	ROLET DHE PËRGJEGJËSITË E GRUPEVE TË INTERESIT	15
TABELA 5:	ANALIZA SWOT PËR RUAJTJEN E BIODIVERSITETIT	45
TABELA 6:	ANALIZA SWOT PËR TRASHËGIMINË KULTURORE DHE PEIZAZHIN	48
TABELA 7:	ANALIZA SWOT PËR MBËSHTETJEN E KOMUNITETEVE VENDASE DHE PËRDORIMIT TË QËNDRUESHËM TË BURIMEVE NATYRORE	51
TABELA 8:	ANALIZA SWOT PËR NDËRGJEGJËSIMIN DHE EDUKIMIN	57
TABELA 9:	ANALIZA SWOT PËR MENAXHIMIN, ADMINISTRIMIN DHE QËNDRUESHMËRINË	60
TABELA 10:	MBULIMI I ZONËS DHE SHËNIMI I ZONAVE TË NDRYSHME NË HARTA	65
TABELA 11:	ZONAT DHE RREGULLIMI I VEPRIMTARIVE	71
TABELA 12:	KOSTOJA E VEPRIMTARIVE TË MENAXHIMIT SIPAS TEMAVE	74
TABELA 13:	KOSTOT E VEPRIMTARIVE TË MENAXHIMIT SIPAS PRIORITETEVE	74
TABELA 14:	KOSTOT E VEPRIMTARIVE TË MENAXHIMIT SIPAS QASJEVE TË MENAXHIMIT	74
TABELA 15:	BURIMET FINANCIARE PËR VEPRIMTARITË E MENAXHIMIT (10 VJET)	75
TABELA 16:	PLANI I BURIMEVE NJERËZORE	79
TABELA 17:	VEPRIMTARITË PËR MONITORIMIN E ZBATIMIT TË PLANIT TË MENAXHIMIT	80

Lista e Figurave

FIGURA 1: HARTA E ZONAVE TË MBROJTURA	9
FIGURA 2: HARTA E ZMD " KARABURUN-SAZAN"	11
FIGURA 3: MATRICA E ANGAZHIMIT TË GRUPEVE TË INTERESIT	18
FIGURA 4: RENDITJA E VLERAVE	37
FIGURA 5: RENDITJA E KËRCËNIMEVE	40
FIGURA 6: MODELI KONCEPTUAL PËR RUAJTJEN E BIODIVERSITETIT	41
FIGURA 7: MODELI KONCEPTUAL PËR TRASHËGIMINË KULTURORE DHE HISTORIKE	42
FIGURA 8: MODELI KONCEPTUAL PËR PESHKIMIN LOKAL	42
FIGURA 9: MODELI KONCEPTUAL I TURIZMIT	43
FIGURA 10: HARTA E ZONIMIT TË PARKUT KOMBËTAR DETAR "KARABURUN-SAZAN"	73

Shkurtime dhe akronimet

ACCOBAMS	Marrëveshja për Ruajtjen e Cetaceve në Detin e Zi dhe Detin Mesdhe dhe Zonës përreth të Atlantikut
AKT	Agjencia Kombëtare e Turizmit
CBD	Konventa për Biodiversitetin
CITES	Konventa për Tregtinë Ndërkombëtare të Llojeve të Rrezikuara të Faunës dhe Florës së Egër
OSHC	Organizata e Shoqërisë Civile
VNM	Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis
GEF	Fondi Global Mjedisor
IBA	Zonë me Rëndësi për Shpendët dhe Biodiversitetin
INCA	Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri
IUCN	Unioni Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës
METT	Mjeti për Gjurmimin e Efektivitetit të Menaxhimit
ZMDB	Zonë e Mbrojtur Detare dhe Bregdetare
MM	Ministria e Mjedisit
ZMD	Zonë e Mbrojtur Detare
SKBPV	Strategjia Kombëtare e Biodiversitetit dhe Plani i Veprimit
KKRRT	Këshilli Kombëtar i Rregullimit të Territorit
AKM	Agjencia Kombëtare e Mjedisit
PKD	Park Kombëtar Detar
OMP	Organizata e Menaxhimit të Peshkimit
ZM	Zonë e Mbrojtur
QRVZVM	Qendra Rajonale e Veprimtarive për Zonat Veçanërisht të Mbrojtura
ZRV	Zonat e Ruajtjes së Veçantë
ZVM	Zonat Veçanërisht të Mbrojtura
PSZMDB	Plani Strategjik për Zonat e Mbrojtura Detare dhe Bregdetare
UNDP	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara
WWF MedPO	Programi për Mesdheun i Fondit Botëror për Ruajtjen e Natyrës

1 HYRJE

Parku Kombëtar i ekosistemit natyror detar pranë Gadishullit të Karaburunit dhe ishullit të Sazanit është shpallur më 28 prill 2010 nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave. Sipërfaqja e përgjithshme e Parkut Kombëtar “Karaburun-Sazan” është 12.570,82 ha, ku zona detare pranë Karaburunit përbëhet nga 9.848,95 ha dhe zona detare pranë ishullit të Sazanit përbëhet nga 2.721,87 ha.

Plani i Menaxhimit për Zonën e Mbrojtur Detare dhe Bregdetare “Karaburun-Sazan” është hartuar në kuadër të projektit “Përmirësimi i Mbulimit dhe Efektivitetit të Menaxhimit të Zonave të Mbrojtura Detare dhe Bregdetare” të Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP) (në vijim i referuar si Projekti për ZMDB-të). Projekti për ZMDB-të ka mbështetur fazën operative dhe funksionale të ZMDB-së së parë në Shqipëri. Ai nisi në janar 2011 dhe do të vazhdojë deri në prill 2016. Projekti për ZMDB-të financohet nga Fondi Global për Mjedisin (GEF) dhe bashkë-financohet nga Ministria e Mjedisit (ME) dhe UNDP. Hartimi i Planit të Menaxhimit (PM) për Karaburun-Sazanin është vetëm një nga veprimtaritë e Projektit për ZMDB-të dhe është përgatitur gjatë gjithë vitit 2014.

Më 07/04/2014 u nënshkrua një Marrëveshje Granti ndërmjet Zyrës së UNDP-it në Shqipëri dhe Programit për Mesdheun të WWF –së. Marrëveshja e Grantit u nënshkrua në formën e Memorandumit të Bashkëpunimit dhe është e vlefshme nga 1 janar deri më 31 dhjetor 2014. Plani i Menaxhimit u hartua në bashkëpunim nga Programi për Mesdheun i Fondit Botëror për Ruajtjen e Natyrës (WWF MedPO) dhe Instituti për Ruajtjen e Natyrës (INCA). Zeljka Rajkovic nga WWF MedPO dhe Genti Kromidha nga INCA drejtuan procesin e hartimit të Planit të Menaxhimit dhe që të dy kanë përvojë në planifikimin e menaxhimit.

Plani i Menaxhimit u drejtohet të gjitha grupeve të interesit të ZMDB-së “Karaburun-Sazan” dhe do të zbatohet nga Administrata e Menaxhimit të PKD “Karaburun-Sazan”, që ende nuk është krijuar. Plani i Menaxhimit është hartuar nëpërmjet qasjes pjesëmarrëse, duke përfshirë katër seminare me grupet e interesit, takime, pyetësorë, etj. duke pasur parasysh mendimet dhe nevojat e komuniteteve vendase, qeverisjes lokale dhe rajonale, si edhe të qeverisë qendrore.

Kjo ishte hera e parë që PM-ja u përgatit në mënyrë të tillë që grupet e interesit u konsultuan gjatë procesit të hartimit të PM-së dhe jo në fund të procesit. Qasja rriti interesin e grupeve të interesit të cilat morën pjesë në mënyrë aktive dhe kontribuan në këtë proces. I takon administratës së menaxhimit të përpiqet të ruajë pronësinë dhe besimin e krijuar gjatë hartimit të PM-së.

Struktura e Planit të Menaxhimit ndjek “Strukturën Standarde të Planeve të Menaxhimit të Zonave të Mbrojtura në Shqipëri”, të miratuar nga Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave më 21 shkurt 2013 (Urdhri Nr. 148).

Pjesa e parë e Planit të Menaxhimit bën përshkrimin e Parkut Kombëtar Detar (PKD), duke renditur të gjitha të dhënat përkatëse mbi vendndodhjen, statusin ligjor, politikat dhe legjislacionin. Kjo pjesë përmban gjithashtu një analizë të grupeve të interesit dhe

përshkrimin e sistemit natyror të ZM-së, të shërbimeve/faciliteteve ekzistuese të ZM-së dhe përdorimit të saj nga vizitorët, të sistemit social- ekonomik, të strukturës së qeverisjes aktuale dhe asaj që parashikohet për të ardhmen, peizazhit dhe trashëgimisë kulturore, si edhe të studimeve dhe kërkimeve shkencore në lidhje me zonën e mbrojtur detare (ZMD).

Pas këtij përshkrimi, vlerësimi i zonës së mbrojtur dhe i kuadrit institucional ofron një vështrim të thelluar të vlerave, kërcënimeve dhe kuadrit institucional aktual. Pjesa II që merret me menaxhimin e zonës së mbrojtur paraqet vizionin e ZMD-së dhe pastaj trajton temat e Planit të Menaxhimit dhe më pas zonat e menaxhimit të PKD-së. Vizioni për menaxhimin e zonës është: “Karaburun-Sazani është një zonë detare e mirë menaxhuar me vlera të jashtëzakonshme, ku burimet përdoren në mënyrë të qëndrueshme për të mbështetur një ofertë të larmishme turistike”.

Plani është ndarë në një numër temash, ku secila ka një qëllim që Plani synon të përmbushë. Qëllimet kanë një sërë objektivash me tregues që mund të monitorohen për të përcaktuar nëse objektivat dhe qëllimet po realizohen. Çdo objektivi ka listën e veprimtarive të prioritizuara që do të zbatohen dhe këto veprimtari kanë gjithashtu treguesit e tyre, monitorimi i të cilëve tregon nëse plani po zbatohet apo jo. Janë pesë tema menaxhimi, secila me një qëllim dhe një numër objektivash specifike. Gjithsej, u identifikuan 13 objektiva specifike dhe 60 veprimtari që janë shpërndarë ndërmjet këtyre objektivave. Temat, qëllimet dhe objektivat e menaxhimit renditen në Tabelën 1.

Zonimi përfshin përshkrimin e çdo zone, një hartë zonimi dhe një tabelë të veprimtarive në çdo zonë, me rregulloren e veprimtarive.

Për çdo veprimtari, në planin e menaxhimit jepet një përlogaritje e kostove financiare. Pas planit financiar, bëhet përshkrimi i monitorimit dhe vlerësimit të menaxhimit. Në fund jepet një listë referencash dhe shtojcash, ku përfshihet lista e llojeve, hartat, etj.

Synohet që Plani i Menaxhimit të jetë dokumenti i planifikimit strategjik të Administratës së Menaxhimit për 10 vitet e ardhshme. Ndryshimet që do të ndodhin gjatë këtyre 10 viteve do të përfshihen në rishikimin e veprimeve të menaxhimit. Mundësia për t'i ndryshuar veprimet ekzistuese mundëson që Plani të jetë elastik, dhe në të njëjtën kohë, të vijohet me ndjekjen e udhëzimeve të përcaktuara në vizionin dhe qëllimet e Planit të Menaxhimit.

Meqenëse vizioni i Planit të Menaxhimit është një qëllim afatgjatë i zonës së mbrojtur, jetëgjatësia e tij është më e madhe se kohëzgjatja e Planit. Nëse nuk do të ketë ndryshime në statusin e zonës së mbrojtur, vizioni mbetet i njëjti duke siguruar kështu vazhdimësinë e menaxhimit. Po ashtu, nëse nuk ka ndryshime të rëndësishme, objektivat e Planit do të mbeten të pandryshuara të paktën për periudhën e ardhshme dhjetëvjeçare.

Pas pesë vitesh, do të bëhet analiza e zbatimit të Planit të Menaxhimit dhe rezultateve të arritura, prandaj edhe Plani do të rishikohet. Nëse është e nevojshme, veprimet e menaxhimit do të ndryshohen pjesërisht apo rishikohen plotësisht. Sa i takon monitorimit, do të bëhet analiza e veprimeve të mëparshme për të shpjeguar çfarë është bërë dhe nuk është bërë, arsyet përse një veprim i caktuar nuk është zbatuar dhe njohuritë dhe përvoja e përdorur gjatë procesit të rishikimit.

Tabela1: Temat, qëllimet dhe objektivat e menaxhimit

TEMA: RUAJTJA E BIODIVERSITETIT
QËLLIMI: Ruajtja dhe mbrojtja e llojeve dhe habitateve detare me vlerë nëpërmjet rregullimit të veprimtarive në det dhe përmirësimit të njohurive mbi rëndësinë e biodiversitetit.
OBJEKTIVAT:
Reduktimi i degradimit dhe ruajtja e madhësisë dhe statusit të livadheve të Posidonia-s para plazheve (pjesa perëndimore) gjatë kuadrit kohor të planit të menaxhimit (10 vjet)
Ndalimi i degradimit dhe ruajtja e statusit të formacioneve koralogjene dhe habitateve të tjera detare të cënueshme gjatë kuadrit kohor të planit të menaxhimit (10 vjet)
Ruajtja e statusit të favorshëm të llojeve detare të rrezikuara dhe të mbrojtura dhe sigurimi i kalimit të sigurt të llojeve karizmatike (breshkave të ujit/detare, fokave mesdhetare, delfinëve dhe balenave) përmes korridorit gjatë kuadrit kohor të planit të menaxhimit (10 vjet)
TEMA: TRASHËGIMIA KULTURORE DHE PEIZAZHI
QËLLIMI: Ruajtja dhe mbrojtja e karakteristikave kulturore dhe historike dhe formacioneve të mahnitshme gjeologjike nëpërmjet përmirësimit të rregulloreve dhe nxitjes së praktikave të mira.
OBJEKTIVAT:
Ruajtja e vlerës estetike të peizazhit gjatë kuadrit kohor të planit të menaxhimit (10 vjet)
Ruajtja e formacioneve gjeologjike duke ndaluar degradimin e shkëmbinjve dhe shpellave (Shpella e Haxhi Aliut, Gjiri i Gramës etj.), në 5 vitet e ardhshme
Ruajtja e gjendjes aktuale të mbetjeve/ rrënojave arkeologjike nënujore në zonat arkeologjike gjatë kuadrit kohor të planit të menaxhimit (10 vjet)
TEMA: MBËSHETETJA E KOMUNITETEVE VENDASE DHE PËRDORIMI I QËNDRUESHËM I BURIMEVE NATYRORE
QËLLIMI: Mbështetja e zhvillimit të komunitetit vendas nëpërmjet promovimit të praktikave të suksesshme të peshkimit dhe turizmit të qëndrueshëm që sigurojnë përdorimin e matur të burimeve natyrore.
OBJEKTIVAT:
Përmirësimi i rezervave të peshkut nëpërmjet ruajtjes së numrit të llojeve dhe rritjes së sasisë të popullatave të peshkut në 5 vitet e ardhshme.
Sigurimi i një oferte cilësore dhe të shumëllojshme turistike dhe arritja e nivelit të qëndrueshëm të turizmit në plazhe, shpella dhe zona zhytjeje gjatë kuadrit kohor të planit të menaxhimit (10 vjet)
Sigurimi i një përvoje cilësore turistike, duke përfshirë plazhe natyrore të qeta, të pastra dhe jo të mbipopulluara, gjatë kuadrit kohor të planit të menaxhimit (10 vjet)
TEMA: NDËRGJEGJËSIMI DHE EDUKIMI
QËLLIMI: Rritja e ndërgjegjësimit dhe përmirësimi i njohurive në drejtim të rëndësisë së ruajtjes së biodiversitetit dhe përdorimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore, si edhe promovimi i vlerave dhe përfitimeve të ZMD-ve.
OBJEKTIVAT:
Rritja e ndërgjegjësimit të vizitorëve dhe publikut të gjerë për vlerat e ZMD-së
Edukimi i grupeve të interesit në lidhje me çështje që kanë të bëjnë me kontributin e tyre në përmirësimin e menaxhimit të ZMD-së
TEMA: MENAXHIMI, ADMINISTRIMI DHE QËNDRUESHMËRIA
QËLLIMI: Sigurimi i menaxhimit efektiv të ZMD-së nëpërmjet ngritjes së kapaciteteve, sigurimit të burimeve të nevojshme njerëzore dhe financiare, dhe përmirësimi i komunikimit dhe bashkëpunimit me grupet përkatëse të interesit.
OBJEKTIVAT:
Krijimi i Administratës së Menaxhimit, marrja në punë e stafit, rritja e nivelit të njohurive dhe aftësive të tyre, dhe pajisja e duhur e tyre në lidhje me gjendjen e ekzistuese në vitin 2014.
Përmirësimi i komunikimit dhe bashkëpunimit me banorët vendas dhe autoritetet vendore.

2 PËRSHKRIMI I ZONËS SË MBROJTUR

2.1 Vendndodhja, kufijtë dhe statusi ligjor

Parku Kombëtar i Ekosistemit Natyror Detar pranë Gadishullit të Karaburunit dhe Ishullit të Sazanit shtrihet në kufirin mes detit Adriatik dhe Detit Jon. Vendndodhja e PKD-së tregohet në Figurën 1.




Figura 1: Harta e Zonave të Mbrojtura

Burimi: Faqja e Internetit e Projektit "Përmirësimi i mbulimit dhe menaxhimi i ZMDB-ve në Shqipëri"¹

Parku Kombëtar Detar mbulon zonën detare përgjatë vijës bregdetare të gadishullit të Karaburunit dhe ishulli i Sazanit shtrihet në Qarkun e Vlorës. Gadishulli i Karaburunit dhe ishulli i Sazanit është pjesë e Bashkisë së Vlorës.

¹<http://mcpa.iwlearn.org/protected-areas/map-of-protected-areas/view>

Parku Kombëtar i ekosistemit natyror detar pranë Gadishullit të Karaburunit dhe ishullit të Sazanit është shpallur më 28 prill 2010 nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave. Sipërfaqja e përgjithshme e Parkut Kombëtar “Karaburun-Sazan” është 12.570,82 ha, ku zona detare pranë Karaburunit përbëhet nga 9.848,95 ha dhe zona detare pranë ishullit të Sazanit përbëhet nga 2.721,87 ha. Kufijtë e PKD-së janë përcaktuar nga Vendimi i Shpalljes i lartpërmendur. Zona detare afër Karaburunit ka kufijtë e mëposhtëm: (Harta e PKD “Karaburun-Sazan” tregohet në Figurën 4)

- Në veri: Pika 1 (që shtrihet në det) me largësi 1 milje detare (1852 m) nga kepi i Gjuhëzës me këto koordinata 4353018.48 V dhe 4478005.72 L, deri te pika 2 (që shtrihet në det) me largësi 1 milje detare (1852 m) nga kepi i Shën Vasilit me koordinata 4363780.19 V dhe 4477378.71 L;
- Në lindje: Pika 2 (që ndodhet në det) me largësi 1 milje detare (1852 m) nga Kepi i Gjuhëzës me koordinata 4363780.19 V dhe 4477378.71 L, që vazhdon më tej përgjatë vijës bregdetare nga kepi i Shën Vasilit, kepi i Dhim Kushtës dhe kepi dhe gjiri i Shën Janit, kepi i Gjuhëzës, ndjek vijën bregdetare perëndimore të malit të Karaburunit, bregdetit të Gjinarës, shpatit të Bishtit të Malit, Rrezen e Kanalit, shpatin e Langadhës deri te pika 3 me koordinata 4379221.15 V dhe 4449696.28 L;
- Në jug: Pika 3, me koordinata 4379221.15 V dhe 4449696.28 L, deri te pika 4 (që shtrihet në det) me largësi 1 milje detare (1852 m) nga shpati i Langadhës me koordinata 4378104.94 V dhe 4448193.75 L;
- Në perëndim: Pika 4 (që shtrihet në det), me distancë 1 milje detare (1852 m) nga shpati i Langadhës me koordinata 4378104.94 V dhe 4448193.75 L, e cila ndjek izobatin deri te pika 1 (në det) me largësi 1 milje detare (1852 m) nga kepi i Gjuhëzës, me koordinata 4353018.48 V dhe 4478005.72 L.

Zona detare pranë ishullit të Sazanit ka kufijtë e mëposhtëm:

- Pika 1, me koordinata 4354004.14 V dhe 4487718.40 L;
- Pika 2 me koordinata 4355536.33 V dhe 4486707.03 L;
- Pika 3, me koordinata 4351587.21 V dhe 4485140.06 L;
- Pika 4, me koordinata 4357134.42 V dhe 4486668.09 L;
- Pika 5, me koordinata 4355142.57 V dhe 4486658.75 L.

Dy zona të tjera të afërta nga e njëjta njësi e madhe ekologjike detare-tokësore (Llogara-Rrëza e Kanalit-Dukat-Orikum-Karaburun) kanë pasur gjithashtu një status mbrojtjeje më herët: 1) Llogaraja (1010 ha) e cila ka statusin e Parkut Kombëtar (Kategoria II sipas IUCN-së, që në vitin 1966) dhe 2) Rrëza e Kanalit-Gadishulli i Karaburunit (20000 ha) e shpallur më parë (1966) si rezervat gjuetie dhe që nga viti 1992 ka statusin e Rezervës Natyrore të Menaxhuar (Kategoria IV sipas IUCN-së). Në këtë zonë mbrohen gjithashtu me ligj një numër Monumentesh Natyrore dhe Kulturore (Kategoria III sipas IUCN-së). Deri tani, është bërë progres i kufizuar në drejtim të sigurimit të statusit ligjor të tyre dhe menaxhimit të tyre në përputhje me objektivat e menaxhimit të tyre.



Figura 2: Harta e Parkut Kombëtar të Ekosistemit Natyror Detar pranë Gadishullit të Karaburunit dhe Ishullit të Sazanit”

Burimi : Faqja e Internetit e Projektit “Përmirësimi i mbulimit dhe menaxhimi i ZMDB-ve në Shqipëri”²

Karaburun-Sazani është një park kombëtar, Kategoria II sipas IUCN-së³. Ligji për Zonat e Mbrojtura bën lidhjen mes kategorive kombëtare të ZM-ve dhe atyre të IUCN-së.

²<http://mcpa.iwlearn.org/protected-areas/map-of-protected-areas/view>

³IUCN-ja është Unioni ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës.

2.2 Politikat dhe legjislacioni

2.2.1 Legjislacioni ndërkombëtar

Lista e legjislacionit përkatës ndërkombëtar për PKD “Karaburun-Sazan” jepet në Tabelën 2.

Tabela 2: Legjislacioni përkatës ndërkombëtar për PKD “Karaburun-Sazan”

Legjislacioni ndërkombëtar	Viti ⁴	Objektivat dhe implikimet që kanë të bëjnë me menaxhimin e ZM-së
Konventa për Biodiversitetin (CBD 1992)	1994	Synon ruajtjen e biodiversitetit, përdorimin e qëndrueshëm të komponentëve të tij dhe ndarjen e drejtë dhe të barabartë të përfitimeve që vijnë nga burimet gjenetike
Synimet /targets e Aich për Konventën e Biodiversitetit (për t’u arritur 2020) • Synimi/ Target11 • Synimi/ Target12	2010	Synimi/target 11. Përfshirja e 17% të ujërave tokësore dhe ujërave të brendshme e 10% të zonave detare dhe bregdetare në sistemet e zonave të mbrojtura Synimi/Target 12. Parandalimi i zhdukjes së llojeve të kërcënuara dhe përmirësimi i statusit të tyre të ruajtjes
Konventa e Barcelonës për Mbrojtjen e Mjedisit Detar dhe Rajonit Bregdetar të Mesdheut (1975, e ndryshuar në vitin 1995)	1990 (2001 ndryshimet)	Synon mbrojtjen e mjedisit detar dhe bregdetar të Mesdheut teksa nxit planet rajonale dhe kombëtare për arritjen e zhvillimit të qëndrueshëm
Protokolli për Zonat Veçanërisht të Mbrojtura dhe Biodiversitetin në Mesdhe (ZVM/BD) (1995)	2001	Synon promovimin e ruajtjes dhe menaxhimit të qëndrueshëm të zonave detare dhe bregdetare me vlera natyrore apo kulturore dhe promovimin e ruajtjes së llojeve të rrezikuara apo kërcënuara
Marrëveshja për Ruajtjen e Cetaceve në Detin e Zi dhe Detin Mesdhe dhe Zonës përreth të Atlantikut (Marrëveshja ACCOBAMS 2001)	2001	Parashikon krijimin e ZMD-ve në zona që shërbejnë si habitate për cetacetë dhe /ose të cilat ofrojnë burime të rëndësishme ushqimi për to
Konventa e Bernës për Ruajtjen e Faunës së Egër dhe Habiteteve Natyrore Evropiane (1979)	1999	Synon ruajtjen e florës dhe faunës së egër dhe habiteteve natyrore të tyre dhe promovimin e bashkëpunimit evropian
Konventa e Bonit për Ruajtjen e Llojeve Shtegtuese të Kafshëve të Egra (1979)	2001	Synon ruajtjen e llojeve shtegtuese tokësore, ujore dhe zogjve/ajrore gjatë gjithë gamës së tyre
Konventa për Tregtinë Ndërkombëtare të Llojeve të Rrezikuara të Florës dhe Faunës së Egër (CITES, 1975)	2003	Synon të sigurojë që tregtia ndërkombëtare e kafshëve dhe bimëve të egra nuk kërcënon mbijetesën e tyre

2.2.2 Legjislacioni i BE-së

Duke pasur parasysh që Shqipëria është vend kandidat për në Bashkimin Evropian, direktivat e BE-së do të duhet të transpozohen në legjislacionin kombëtar të Shqipërisë. Procesi ka filluar tashmë, por, duke pasur parasysh kompleksitetin e *aquis communautaire*⁵, pritet që të zgjasë derisa Shqipëria të bëhet pjesë e BE-së.

Direktivat për Natyrën janë Direktiva e BE-së për Ruajtjen e Habiteteve Natyrore dhe Faunës dhe Florës së Egër (Direktiva për Habitatet 92/43/EEC) dhe Direktiva e BE-së për Ruajtjen e Shpendëve të Egër (Direktiva për Shpendët 2009/147/EC). Natura 2000 është pjesa kryesore e politikës së BE-së për natyrën dhe biodiversitetin. Natura 2000 është një rrjet i gjerë i BE-së i zonave të mbrojtjes natyrore i krijuar në bazë të Direktivës së Habiteteve të vitit 1992.

⁴Viti i aderimit apo ratifikimit nga Shqipëria.

⁵Legjislacioni i akumuluar, aktet ligjore, dhe vendimet e gjykatave të cilat përbëjnë korpusin e së drejtës së Bashkimit Evropian

Qëllimi i rjetit është të sigurojë mbijetesën afatgjatë të llojeve dhe habitateve të kërcënuara më të vlefshme të BE-së.

Dy direktiva shtesë të BE-së që kanë lidhje me mjedisin detar janë Direktiva e BE-së që krijon një Kuadër për Veprim Komunitar në Fushën e Politikës së Ujit (Direktiva Kuadër e Ujit 2000/60/EC) dhe Direktiva Kuadër e Strategjisë Detare (Direktiva Detare 2008/56/EC). Direktiva Kuadër e Ujit i angazhon vendet anëtare të BE-së për të arritur një status/gjendje të mirë cilësore dhe sasiore të të gjithë trupave ujorë (duke përfshirë ujërat detare deri në një milje detare nga bregu) deri në vitin 2015. Qëllimi i Direktivës Detare është mbrojtja më efektive e mjedisit detar në të gjithë BE-në. Ajo synon arritjen e Statusit të Mirë Mjedisor (GES) të ujërave detare deri në 2020 dhe mbrojtjen e bazës së burimeve nga e cila varen veprimtaritë ekonomike dhe sociale që zhvillohen në det. Për ta arritur këtë qëllim, Direktiva krijon rajonet dhe nën-rajonet detare evropiane në bazë të kriterëve gjeografike dhe mjedisore.

2.2.3 Legjislacioni kombëtar

Lista e legjislacionit përkatës kombëtar për Parkun kombëtar Detar paraqitet në Tabelën 3.

Tabela 3: Lista e legjislacionit përkatës kombëtar për Parkun Kombëtar të Ekosistemit Natyror Detar pranë Gadishullit të Karaburunit dhe Ishullit të Sazanit

Legjislacioni kombëtar	Viti ⁶	Objektivat dhe implikimet që kanë të bëjnë me menaxhimin e ZM-së
Dokumente strategjike		
Strategjia Kombëtare për Biodiversitetin dhe Plani i Veprimit (SKBPV), 2000 dhe Planet e Veprimit për Ruajtjen e Cetaceve (2007), livadhet e <i>Posidonia oceanica</i> (2007) dhe Breshkat detare dhe habitatet e tyre natyrore (2012)	2000 2007-2012	E vlefshme për periudhën 2000-2015; Progresi më i rëndësishëm i arritur në mbulimin e ZM-ve
Plani i Punës plan dhe strategjia për rritjen e sipërfaqes dhe forcimin e administratës së zonave të mbrojtura në Shqipëri, në Veprimtarinë për mundësimin e Biodiversitetit, 2007	2007	Ofroi hollësi për përmirësimin e mbulimit të ZM-së dhe hodhi themelet për krijimin e Zonës së parë të Mbrojtur Detare në Shqipëri
Plani Strategjik për Zonat e Mbrojtura Detare dhe bregdetare (PSZMDB), prill 2013	2013 (Drafti përfundimtar)	Përfshin analizën e gjendjes së ZMDB-ve, bën rishikimin e kriterëve për identifikimin e ZMDB-ve, si edhe propozon veprimtaritë për zbatimin e PSZMDB-ve
Ligje		
Ligji Nr.8906, datë 06.06.2002 “Për zonat e mbrojtura” i ndryshuar me Ligjin Nr. 9868, datë 04.02.2008	2002 (2008 ndryshimet)	Krijon kuadrin ligjor për shpalljen, planifikimin, administrimin, menaxhimin dhe përdorimin e zonave të mbrojtura dhe të burimeve të tyre natyrore dhe biologjike
Ligji Nr. 9587, datë 20.07.2006, “Për mbrojtjen e biodiversitetit”, i ndryshuar me Ligjin Nr. 37/2013	2006 (2013 ndryshimet)	Ka për qëllim ruajtjen dhe mbrojtjen e biodiversitetit nëpërmjet rregullimit të përdorimit të qëndrueshëm të elementeve të tij përmes integritit të elementeve kryesore të biodiversitetit në strategji, plane, programe, dhe të gjitha nivelet e vendimmarrjes
Ligji Nr. 10006, datë 23.10.2008, “Për mbrojtjen e faunës së egër” ndryshuar me Ligjin Nr. 41/2013	2008 (2013 ndryshimet)	Ka për qëllim mbrojtjen, menaxhimin dhe kontrollin e faunës së egër për të siguruar ruajtjen e llojeve, popullatave dhe habitateve të tyre

⁶Viti i miratimit dhe ndryshimet vijuese, sipas rastit.

Legjislacioni kombëtar	Viti ⁶	Objektivat dhe implikimet që kanë të bëjnë me menaxhimin e ZM-së
Ligji Nr. 64/2012, datë 31.05.2012, “Për Peshkimin”	2012	Rregullon peshkimin, menaxhimin e tij, ofron mbrojtje për jetën detare dhe ujërat e brendshme, dhe rregullon “zonat e mbrojtura të peshkimit”
Legjislacion shtesë për zonat e mbrojtura		
Vendimi nr. 266, datë 24.04.2003 “Për administratat e Zonave të Mbrojtura”	2003	Specifikon detyrat dhe funksionet e administratave të ZM-ve, veçanërisht për parqet kombëtare dhe rezervatet/zonat e menaxhuara natyrore të menaxhimit të habitateve dhe llojeve (kategoritë II dhe IV të ZM-ve sipas IUCN-së)
Vendimi Nr. 267 për procedurat që rregullojnë propozimin dhe shpalljen e zonave të mbrojtura dhe zonave buferike, datë 24.04.2003	2003	Rregullon procedurat për shpalljen e zonave të mbrojtura dhe zonave buferike
Vendimi Nr. 897, datë 21.12.2011 për miratimin e rregullave të shpalljes së zonave veçanërisht të mbrojtura	2011	Shpallja e zonave veçanërisht të mbrojtura (ZVM) bëhet në bazë të Ligjit për Zonat e Mbrojtura. ZMV-të lidhen me ZM-të që kanë statusin e Konventës së Ramsarit si ligatina të rëndësishme ndërkombëtare, apo statusin e konventës së Bernës si zona të rëndësishme të veçantë për mbrojtjen e florës dhe faunës.
Rregullorja Nr. 86, datë 11.02.2005, “Për Ngritjen e Komiteteve të Menaxhimit për Zonat e Mbrojtura”	2005	Rregullon krijimin, funksionet dhe funksionimin e komiteteve të menaxhimit të ZM-ve
Urdhri Nr. 148, datë 21.02.2013, “Për miratimin e Strukturës së Standardizuar të Planit të Menaxhimit për Zonat e Mbrojtura”	2013	Përcakton përmbajtjen e planeve të menaxhimit të zonave të mbrojtura
Urdhri Nr. 1280, datë 20.11.2013, “Për miratimin e Listës së Kuqe të Faunës dhe Florës së Egër”	2013	Rishikimi dhe përditësimi i Listës së Kuqe ekzistuese të hartuar për herë të parë në Shqipëri në vitin 2007
Rregullorja Nr 1, datë 29.03.2005, “Për zbatimin e legjislacionit mbi peshkimin dhe akuakulturën”	2005	Ndalon peshkimin rreth grykave të lumenjve, peshkimin dhe akuakulturën në pjesën e jashtme të Karaburunit (deri në një milje detare ose deri në 50 m thellësi), peshkimin me rrjeta me tërheqje fundore ose pelagjike në gjirin e Vlorës, peshkimin në kanalet e lagunës
Rregullorja Nr. 8, datë 11.11.2009, “Për masat e menaxhimit për shfrytëzimin e qëndrueshëm të burimeve të peshkimit në det”	2009	Ndalon përdorimin e rrjetave fundore brenda 3 milje detare nga bregu i detit ose deri në 50 m thellësi, rrjetave çift brenda 1.5 milje detare nga bregu i detit, dragave hidraulike 0.3 milje detare nga bregu i detit, dhe mrezhave 300 m nga bregu i detit
Rregulloret për PKD “Karaburun-Sazan”		
Vendimi Nr.289, datë 28.04.2010, për shpalljen Park Kombëtar të ekosistemit natyror detar të ishullit të Sazanit dhe gadishullit të Karaburunit, i ndryshuar me Vendimin Nr. 444, datë 28.04.2010	2010	E shpall ekosistemin natyror detar të ishullit të Sazanit dhe gadishullit të Karaburunit Park Kombëtar Detar
Urdhri Nr. 446, datë 16.08.2012, për Ngritjen e Komitetit të Menaxhimit të Parkut Kombëtar të Llogarasë, Parkut Kombëtar Detar “Karaburun-Sazan” dhe Kompleksit Natyror “Karaburun-Rrëza e Kanalit-Orikum- Tragjas-Dukat	2012	Cakton anëtarët e Komitetit të Menaxhimit në bazë të Rregullores për Ngritjen e Komiteteve të Menaxhimit për Zonat e Mbrojtura

2.3 Grupet e interesit

1.1.1. Rolet dhe përgjegjësitë e grupeve të interesit

Grupet e interesit qeveritare dhe joqeveritare u identifikuan dhe më pas u analizuan. Ato u grupuan (shih Tabelën 4), u përcaktuan lidhjet ndërmjet çdo grupi interesi dhe PKD-së, dhe për çdo grup interesi u përcaktua niveli i angazhimit të tyre.

Tabela 4: Rolet dhe përgjegjësitë e grupeve të interesit

Grupet e interesit	Lidhja ndërmjet grupeve të interesit dhe PKD-së	Niveli i angazhimit
Ministritë/ Autoritetet kombëtare		
Ministria e Mjedisit	Përgjegjëse për kuadrin ligjor për menaxhimin e ZM-së; autoriteti që harton standardet e ZM-së; mbikëqyr menaxhimin e ZM-së	Mbahet e kënaqur/ angazhohet nga afër- fuqi/pushtet dhe përgjegjësi e madhe në lidhje me ZM-të
Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit	Përgjegjëse për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e Strategjisë Kombëtare të Turizmit; kuadrin ligjor për zhvillimin e turizmit, procesin e zhvillimit dhe planifikimit; mbështetjen për administratën rajonale dhe organizimin e turizmit në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal	Mbahet e kënaqur- fuqi e madhe; interes i moderuar
Ministria e Mbrojtjes	Baza ushtarake që ndodhet në gadishullin e Karaburunit dhe ishullin e Sazanit	Mbahet e kënaqur- fuqi e madhe; interes i ulët
Agjencia Kombëtare e Planifikimit Hapësinor	Hartimi i standardeve të planifikimit dhe mbikëqyrja e zbatimit të instrumenteve të planifikimit hapësinor	Mbahet e informuar
Agjencia Kombëtare e Bregdetit	Mbrojtja e bregdetit, promovimi dhe monitorimi i projekteve për zhvillimin e zonës bregdetare	Mbahet e kënaqur/ angazhohet nga afër- fuqi/pushtet mjaft i madh në promovimin dhe mbrojtjen e zonave bregdetare
Inspektorati Kombëtar i Planifikimit Urban	Zbatimi i ligjit në lidhje me planifikimin dhe ndërtimin hapësinor	Mbahet i informuar
Agjencia Kombëtare e Turizmit	Kryen funksionet në lidhje me promovimin dhe marketingun e turizmit, p.sh. prodhimin dhe shpërndarjen e publikimeve promovuese, portaleve zyrtare turistike, turnetë njohëse, marrëdhëniet me publikun, panairot tregtarë turistike, etj.	Angazhohet nga afër / mbahet e informuar – ka rëndësi në marrjen dhe vlerësimin e të dhënave për turizmin dhe në përgatitjen e strategjive turistike dhe paketave të informacionit
Organizatrat shtetërore		
Drejtoria Rajonale e Shërbimit Pyjor	Përgjegjëse për menaxhimin e ZM-ve (duke përfshirë Karaburun-Sazan)	Angazhohet nga afër – fuqi dhe interes i moderuar
Inspektorati Rajonal Mjedisor	Zbatimi i ligjit, kontrolli i veprimtarive të paligjshme; mbrojtja nga zjarri	Monitoron/mbahet e informuar- fuqi e moderuar, interes i ulët
Agjencia Rajonale e Mjedisit -ARM	E pranishme në çdo Prefekturë; zbatimi i procedurave në lidhje me lejet mjedisore, mbledhja e të dhënave mjedisore	Vetëm monitoron- fuqi e vogël dhe kompetenca jo shumë të rëndësishme
Qendra Ndërinstitucionale e Operacioneve Detare	Një institucion ndërsektorial përgjegjës për monitorimin e zonës detare të Shqipërisë dhe planifikimin dhe bashkërendimin e veprimtarive në det	Mbahet e informuar
Inspektorati i Peshkimit Vlorë	Përgjegjësi për vëzhgimin e veprimtarive të peshkimit, duke përfshirë edhe PKD-në	Monitoron- mund të kishte fuqi, por për momentin ka interes të ulët
Policia Kufitare dhe Migracionit	Përgjegjësi për PKD-në si edhe	Monitoron- ka fuqi, por për momentin

Grupet e interesit	Lidhja ndërmjet grupeve të interesit dhe PKD-së	Niveli i angazhimit
	(kontrolli i hyrjes në zonë)	ka interes të ulët
Administrata lokale/rajonale		
Prefektura Vlorë	Mbikëqyr zbatimin e kuadrit ligjor dhe kontrollon autoritetet e qeverisjes vendore	Mbahet e kënaqur- fuqi e madhe për disa çështje, interes i moderuar
Këshilli i Qarkut Vlorë	Harton dhe zbaton politikat rajonale dhe bashkërendon punën me autoritetet e qeverisjes qendrore dhe vendore	Mbahet i kënaqur- fuqi e madhe për disa çështje, interes i moderuar
Bashkia Vlorë	Merr vendime për zhvillimin lokal (bizneset); vizitorët e PKD-së kryesisht qëndrojnë në Vlorë	Mbahet e kënaqur- fuqi e madhe për disa çështje, interes i moderuar
Bashkia Orikum	Përgjegjëse për administrimin lokal të zonës, zhvillimin dhe menaxhimin e turizmit vendas; studimet urbanistike, Planin e Zhvillimit deri në vitin 2013	Interes i lartë në zhvillimin e turizmit vendas dhe fuqi mjaft e madhe në nivel lokal
Bashkia Qendër	Përgjegjëse për ishullin e Sazanit, por Ushtria është ende e pranishme atje	Mbahet e kënaqur- fuqi e madhe për disa çështje, interes i moderuar
Entet/ndërmarrjet publike		
Kapiteneria e Portit Vlorë	Sapo të rregullohet hyrja në PKD, mund të bëhet më e rëndësishme	Monitoron-fuqi e vogël dhe interes i ulët
Drejtoria e Portit Vlorë	Autoriteti Portual në Vlorë, për momentin nuk ofron ankorime për turistët që vijnë nga deti	Monitoron-fuqi e vogël dhe interes i ulët
Shoqatat e përdoruesve		
Dhoma e tregtisë dhe Industrisë, Vlorë	Shoqata e Bizneseve Private në Vlorë, potencial për promovim	Monitoron-fuqi e vogël dhe interes i ulët për momentin
Organizata e Menaxhimit të Peshkimit	UNDP ka nënshkruar një marrëveshje me OMP-në për sigurimin e 3 rojeve mjedisore/ rangers, karburant dhe logjistikë, të cilat shkruajnë raporte javore; rojet mjedisore/rangers mund të regjistrojnë vetëm veprimtaritë e paligjshme	Mbahet e informuar- e interesuar dhe ka njëfarë fuqie
Shërbimet turistike		
Organizata e Operatorëve Turistikë	Agjencitë turistike	Angazhohen nga afër- e rëndësishme për zhvillimin e turizmit; angazhohet drejtpërdrejt në PKD
Marina e Orikumit	Marina private, rreth 600 shtretër, plotësisht e pajisur, organizon gara me varka	Monitoron/ mbahet e informuar – fuqi e vogël dhe interes potencial i moderuar
Oazi Blu	Qendër Zhytjeje	Angazhohet nga afër- e rëndësishme për zhvillimin e turizmit; angazhohet drejtpërdrejt në ZM
Organizatat e Shoqërisë Civile (OSHC-të)		
Organizata për edukim Mjedisor – SEEP	OSHC-të mjedisore	Mbahen të informuara / angazhohen nga afër- interes i lartë, fuqi e kufizuar
Shoqata për Mbrojtjen e Gjirit të Vlorës		
Qendra për Kërkim, Bashkëpunim dhe Zhvillim - CRCO		
Qendra Auleda		
Të drejtat e njeriut & Mjedisi		
Qendra Aulona		
Organizata Aarhus		
Pronësia		
Agrobiznesi		
BioAdro		
Dukati		
Oriku		

Grupet e interesit	Lidhja ndërmjet grupeve të interesit dhe PKD-së	Niveli i angazhimit
PineFlag		
Organizata e Intelektualëve të Himarës		
Institucionet kërkimore		
Universiteti "Ismail Qemali"	Departamentet e shkencave natyrore dhe Turizmit, bërja e kërkimeve në ZMD	Pozicion i moderuar- rol dhe kontribut i rëndësishëm në kërkimin shkencor, por jo aq shumë në menaxhimin e ZM-së, interes i moderuar
Komuniteti vendas		
Peshkatarët	Përdoruesit e PKD-së, promovimi i AMD-së, rritja e ndërgjegjësimit	Mbahen të informuar– do të informohen nëpërmjet OMP, njëfarë interesi
Media		
Stacionet e radiove lokale	Informimi për veprimtaritë e ZMD-së, promovimi i ZMD-së, rritja e ndërgjegjësimit, etj.	Mbahen të informuara
Stacionet e televizioneve lokale		
Gazetat		
Mediat kombëtare		
Institucionet arsimore		
Shkollat fillore	Veprimtari edukuese në ZMD, rritja e ndërgjegjësimit për ZMD-në	Mbahen të informuara
Shkollat e mesme		
Universiteti		
Bibliotekat publike		
Organizatrat ndërkombëtare/Donatorët/ Ndhimja për Zhvillim		
Qendra e Informacionit e Bashkimit Evropian Vlorë	Lehtëson shpërndarjen e informacionit për BE-në dhe Shqipërinë	Mbahen të informuara; fuqi e ulët, interes i lartë
Komisioni Evropian	Mbështet ruajtjen e biodiversitetit në vend	
UNDP	Mbështet krijimin dhe menaxhimin e ZMD-së	
Banka Botërore	Mbështet ruajtjen e biodiversitetit në vend	
WWF	Mbështet ngritjen e kapaciteteve të zonave të mbrojtura	
MedPAN	Mbështet ZMD-në në nivel rajonal	

2.3.1 Matrica e angazhimit të grupeve të interesit

Plani i Menaxhimit për PKD "Karaburun-Sazan" është përgatitur nëpërmjet angazhimit të komunitetit vendas dhe grupeve të tjera të interesit/ përdoruesve të zonës. Në fillim të procesit të përgatitjes së Planit të Menaxhimit u zhvilluan intervista gjysmë të strukturuar me institucionet dhe komunitetin vendas për të krijuar një panoramë më të mirë të mendimeve dhe nevojave të tyre. U intervistuan përfaqësues nga shtatë institucione: Ministria e Mjedisit, Organizata e Menaxhimit të Peshkimit, Bashkia Orikum, Këshilli i Qarkut Vlorë, Drejtoria e Shërbimit Pyjor Vlorë, Prefektura Vlorë dhe Komuna Qendër Vlorë.

Shumica e të intervistuarve (70%) e pranuan biodiversitetin si vlerën më të rëndësishme; ata gjithashtu pranuan vlerat kulturore dhe historike, turizmin etj. Ata pranojnë humbjen e vlerave për shkak të zbatimit të dobët të ligjit dhe veprimtaritë e paligjshme si ndryshimet më të rëndësishme negative sa u takon vlerave. Ndër kërcënimet më të mëdha të ruajtjes së vlerave ata rendisin gjuetinë dhe peshkimin e paligjshëm, mbledhjen e midhjeve shkëmbshpuese, zhvillimin e turizmit të paligjshëm (baret dhe restorantet), ndotjen, zjarret, etj. Hapat e nevojshme për ruajtjen e vlerave- më të ngutshmet: zbatimi i ligjit dhe bashkëpunimi ndër-institucional; më realiste; fuqizimi i rojeve mjedisore/rangers dhe strukturave të tjera mbikëqyrëse. Institucionet kërkojnë që rolet dhe përgjegjësitë e ZMDB "Karaburun-Sazan" duhet të jenë mbrojtja e vlerave, promovimi dhe ndërgjegjësimi i

publikut, zbatimi i ligjit për të ndalur gjuetinë dhe peshkimin e paligjshëm, si edhe zhvillimi i zonës.

Komuniteti vendas sheh rolet dhe përgjegjësitë e mëposhtme për ZMDB “Karaburun-Sazan: mbrojtja dhe promovimi i vlerave, duke përfshirë edhe vlerat nënujore, zhvillimin e turizmit, ndalimin e gjuetisë dhe peshkimit të paligjshëm, menaxhimin efektiv, si edhe mbështetjen financiare të projekteve lokale.

Pothuajse 1/3 (29%) mendojnë se ka pasur rritje të ndërgjegjësimit që nga krijimi i ZMDB “Karaburun-Sazan”; disa mendojnë se ka më shumë turizëm dhe punësim lokal; që jeta detare është më e pasur; dhe që ka më pak zjarre; pak prej tyre nuk shohin ndonjë ndryshim.

Duke pasur parasysh vizionin e zonës nga perspektiva e komunitetit vendas, ata e shohin atë kryesisht si një zonë të zhvilluar turistike e pasur me biodiversitet dhe vlera kulturore, një qendër e rëndësishme për mbrojtjen e natyrës, pa gjueti dhe peshkim të paligjshëm.

Në Figurën 3 paraqitet matrica e angazhimit të grupeve të interesit, ku grupet e interesit analizohen sipas pushtetit/fuqisë dhe interesit të tyre. Kjo ndihmon në përcaktimin e ndikimit që kanë grupet e interesit në lidhje me PKD-në dhe përzgjedhjen e qasjes së duhur të komunikimit/ nivelit të duhur të angazhimit për çdo grup interesi/ aktorësh.




Figura 3: Matrica e angazhimit të grupeve të interesit

Grupet e interesit që kanë pushtet/fuqi të madhe dhe interes të ulët duhet të mbahen të kënaqura. Ato që kanë interes të ulët dhe pushtet/fuqi të vogël vetëm duhen monitoruar me përpjekje minimale. Grupet e interesit me pushtet/fuqi të vogël dhe interes të madh duhet të mbahen të informuara dhe së fundmi grupet e interesit me interes të lartë dhe pushtet/fuqi të madhe duhet të angazhohen nga afër në procesin e menaxhimit.

2.4 Përshkrimi i sistemit natyror të ZM-së

Dokumentet e mëposhtme janë konsultuar për përshkrimin e PKD “Karaburun-Sazan”:

- Plani i Menaxhimit. Kompleksi: Llogara-Rrëza e Kanalit-Dukat-Orikum-Tragjas-Radhimë-Karaburun (UNDP/GEF dhe Ministria e Mjedisit 2005a);
- Propozimi për një Zonë të Mbrojtur Detare në Shqipëri (Tilot 2009);
- Vlerësimi i boshllëqeve të ZM-ve, Biodiversiteti Detar, Legjislacioni për ZM-të dhe ZMD-të (Kashta, 2010);
- Plani Prioritar i Veprimit për Zonën e Mbrojtur Detare të Sazan- Karaburunit (Beqiraj *et al.*, 2010).

2.4.1 Hyrje

Parku Kombëtar i Ekosistemit Natyror Detar pranë Gadishullit të Karaburunit dhe Ishullit të Sazanit është krijuar të ofrojë një qasje pragmatiste që synon vendosjen e ekuilibrit ndërmjet zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe ruajtjes së burimeve natyrore duke siguruar mbrojtjen afatgjatë dhe mirëmbajtjen e biodiversitetit, teksa ofron në të njëjtën kohë një rrjedhë të qëndrueshme të produkteve natyrore dhe shërbimeve për të mbështetur zhvillimin e komuniteteve bregdetare. Objektivat kryesore të krijimit të tij janë:

- Mbrojtja dhe ruajtja e biodiversitetit dhe vlerave të tjera natyrore të zonës në periudhën afatgjatë.
- Promovimi i praktikave të shëndosha të menaxhimit për qëllimet e prodhimit të qëndrueshëm.
- Mbrojtja e burimeve natyrore nga tjetërsimi për qëllime të tjera të përdorimit të tokës që do të ishin të dëmshme për biodiversitetin e zonës.
- Kontributi në zhvillimin rajonal dhe kombëtar.

2.4.2 Përshkrim i përgjithshëm

Shpatet e gadishullit të Karaburunit janë vende tejet të rrëpira në anën perëndimore me kulme të larta në pjesën qendrore. Bregu perëndimor i gadishullit skalitet nga shpella dhe kanione të thella që rrallëherë përfundojnë me plazhe zalli ose xhepa rëre. Shpatet e tij karakterizohen nga shkëmbinj të lartë vertikalë që vazhdojnë nën ujë në thellësi të mëdha. Këta shkëmbinj janë tepër të gërryer dhe mund të vërehen një numër i madh shpellash, kryesisht nënujore, aty ku shpesh rrjedhin burime të ujërave të ëmbla.

Gadishulli i Karaburunit është vendi më i spikatur me cilësi mesdhetare. Ai karakterizohet nga një nivel shumë i ulët turbullimi të ujit. Mjedi medio-litoral karakterizohet nga formacione koralogjene ndonjëherë mbi një metër, të përbëra prej algash koralogjene *Lithophyllum lichenooides*, një lloj i mbrojtur dhe shumë i veçantë nga pikëpamja gjeo-morfologjike, biologjike dhe turistike, dhe që mund të shfaqet me pamje jashtëzakonisht të mahnitshme.

Ishulli i Sazanit (16 km i gjatë dhe 3-5 km i gjerë), përballë Vlorës dhe në veri të gadishullit të Karaburunit, ka një formë elipsoide në veri-veriperëndim-jug-juglindje, duke pasur majën kulmore në lartësi 345 m tek Gryka e Djallit. Pjesa perëndimore karakterizohet nga brigje shkëmbore vertikale që janë skalitur nga kanione të thella dhe që zgjerohen nga shpella të shfaqura kryesisht nën-ujë, siç shfaqen tek gadishulli i Karaburunit. Kanionet më të rëndësishme janë tek Kepi i Pëllumbave dhe Gryka e Ferrit. Në pjesën lindore, vija bregdetare është më e ulët dhe pjesa jug-perëndimore e saj formohet nga shtresa të rrëpira gëlqerore që zhyten në det.

2.4.3 Klima

Zona karakterizohet nga një klimë mesdhetare me dimër të butë dhe reshje të bollshme, si dhe me verë të nxehtë dhe të thatë. Reshjet mesatare vjetore variojnë nga 1000 deri 1200 mm, të cilat bien kryesisht në periudhën e dimrit, nga nëntori në prill. Rrezatimi diellor vjetor i zonës është rreth 1.540 kwh (kilovatë në orë)/m² me sasinë më të lartë në korrik (216,5 kwh/m²). Mesatarja vjetore e lagështirës së ajrit është 66% dhe temperatura mesatare vjetore është 17° C që varion nga 24 deri 26° C në korrik, dhe 10° C në janar. Në dimër, erërat fryjnë kryesisht nga veri-lindja dhe jugu me shpejtësi mesatare prej 7.2 m/ s, duke arritur kulmin e erërave të jugut në 40 m/s (UNDP/ GEF dhe Ministria e Mjedisit, 2005c).

2.4.4 Gjeologjia, topografia dhe gjeomorfologjia

Zona përfshin dy njësi gjeo-morfologjike, formacionet terrigjene të cilave mund të gërryhen ndjeshëm (p.sh. *fish*/ depozita kuaternare të *molasës*) dhe shkëmbinj karbonatikë (gurë gëlqerorë dhe gëlqerorë-dolomit, me *rudiste*/molusqe dyvalvore fosilesh në formë koni ose fosile foraminiferesh), të Kretakut të sipërm, p.sh. në malet karstike të Rrëzës së Kanalit-Karaburunit) (UNDP/ GEF dhe Ministria e Mjedisit, 2005b).

Zona Rrëza e Kanalit-Karaburuni karakterizohet nga një platformë e ngushtë dhe e pjerrët. Brigjet shkëmbore zhyten vertikalisht me shpejtësi të madhe në det, duke arritur shpejt thellësi të konsiderueshme që arrijnë më shumë se 20 m vetëm 200 m larg bregut të detit. Ana lindore e gadishullit të Karaburunit përbëhet nga një numër shkëmbinjsh të moshave të ndryshme, nga epokat Jurasike dhe Neogjene (*Jurassic & Neogene*) siç janë periudhat Akuitane, Helvetiane, Tortoniane, dhe Pliocene (*Aquitanian, Helvetian, Tortonian dhe Pliocene*). Pjesa jugore përbëhet kryesisht nga shkëmbinj të periudhës Pliocene, të shoqëruar me sedimente të kohëve të fundit. Bregdeti lindor është nga epoka e Kretakut të Sipërm, e përbërë kryesisht nga gurë gëlqerorë. Pjesa perëndimore e ishullit të Sazanit përbëhet nga shkëmbinj të epokës së Kretakut të Sipërm (gurë gëlqerorë masivë ose *rudiste*/molusqe dyvalvore fosilesh në formë koni, ose fosile foraminiferesh), ndërsa pjesa lindore përbëhet nga shkëmbinj të epokës Burdigaliane (gurë gëlqerorë litografikë).

2.4.5 Hidrologjia, drenazhimi dhe burimet ujore

Formacionet me gurë gëlqerorë të zonës karakterizohen nga një strukturë poroze në të cilën shpesh ujërat filtrohen dhe përshkojnë nëntokën pa pengesë. Ujërat nëntokësore janë të pasura dhe shfaqen në burime karstike që vërshojnë ujërat tyre të ëmbla në laguna, p.sh. Laguna e Oriksmit. Përgjatë gadishullit të Karaburunit mund të hasen burime të ujërave të ëmbla përgjatë bregdetit, që shkarkojnë ujërat e tyre të ftohta nga fundi i sipërfaqes së detit. Megjithatë, pjesa e brendshme e gadishullit është e shkretë dhe e thatë.

2.4.6 Burimet e Biodiversitetit

Përveç pjesës së ligatinave, zona bregdetare është kryesisht shkëmbore, e shoqëruar në disa vende me brigje të rëndësishme me shkëmbinj gëlqerorë të mbuluara me bimësi tipike mesdhetare, ndërsa në nivel lokal përgjatë bregdetit, me plazhe në formë xhepush me zhavorr (zall) dhe rërë. Brigjet shkëmbore janë të mbuluara zakonisht nga një kaçube tipike mesdhetare, e cila është ende me shumicë në ishullin e Sazanit dhe përgjatë Rrëzës së Kanalit-Karaburunit. Ligatinat bregdetare dhe dunat janë të mbuluara kryesisht nga halofite dhe psamofite dhe të shoqëruara me vende me ujëra të kripura dhe të ëmbla. Kjo pjesë e gjithë bregdetit shkëmbor paraqet peizazhe me cilësi të jashtëzakonshme panoramike, veçanërisht nga mjetet e lundrimit, kur vizitohen shpellat, kanionet dhe gjiret e vogla, p.sh. shpella e Haxhi Aliut dhe shpella e Duk Gjonit (Fremuth, 2000; Pergent, 2002; Qiriazhi dhe Sala, 2006;. Sala etj, 2006; Tilot dhe Jeudy de Grissac, 1994).

Peizazhet nënujore janë gjithashtu të një cilësie të jashtëzakonshme, me shkëmbinjtë, shpellat nënujore, shoqërimet e faunës dhe florës, dhe në disa vende të shoqëruara edhe me mbetje arkeologjike (Tilot dhe Jeudy de Grissac, 1994; Upton, 2006). Kjo është sigurisht zona më e mirë dhe më mbresëlënëse e bregdetit shqiptar për zhvillimin e veprimtarive detare, si ato të zhytjeve me bombul oksigjeni/scuba diving, i cili nuk është shumë i zhvilluar në Shqipëri.

Diversiteti biologjik është relativisht i lartë në ujërat detare të zonës, me specie të rralla dhe një florë dhe faunë shumë të zhvilluar të fundit të detit bregdetar dhe me një fizionomi tipike mesdhetare që karakterizohet nga një shumësi speciesh Mesdhetare-Atlantike. Livadhet e *Posidonia oceanica* ofrojnë një biodiversitet relativisht të lartë të makrofaunës së fundit të detit, duke përfshirë sfungjerët, knidarët, briozoarët, molusqet, anelidët, krustacet, ekinodermët etj.) dhe ascidiet (Beqiraj et al., 2008).

Algat koralogjene, një formacion biogjenik në formë rrethore, të cilat mund të shtrihen në nivel lokal në më shumë se 1 m gjerësi, janë të pranishme në fazën mediolitorale përgjatë brigjeve perëndimore të Karaburunit, ishullit të Sazanit dhe zonës së Rrëzës së Kanalit.

Sipas *BirdLife International* (2014), zona e gjirit të Vlorës, gadishullit të Karaburunit dhe maleve të Çikës është klasifikuar si një Zonë e Rëndësishme e Shpendëve dhe Biodiversitetit (IBA) për Shqipërinë (vlerësimi IBA është kryer në vitin 2000)⁷. Janë regjistruar rreth 70 lloje të shpendëve të ujit në këtë zone, ndër të cilat pelikani kaçurrel (*Pelecanus crispus*) dhe karabullaku i vogël (*Phalacrocorax pygmaeus*).

Zona është gjithashtu e rëndësishme për peshkimin. Përgjatë brigjeve të Rrëzës së Kanalit-Karaburun dhe Sazanit kryhet peshkim artizanal. Peshkatarët profesionistë përdorin kryesisht peshkimin me grep dhe me varka peshkimi me rrjetë. Fauna e peshqve me interes tregtar përbëhet nga disa lloje që jetojnë në fund të detit dhe në grupe, peshq të vegjël dhe të mëdhenj, krustace dhe molusqe.

Vlerat historike dhe arkeologjike të këtyre viseve janë unike dhe mund të tërheqin turistët kombëtarë dhe ndërkombëtarë. Të pranishme janë gjithashtu disa mbetje arkeologjike dhe historike në zonën e lagunës së Orikumit, gjirit të Vlorës, Karaburunit, p.sh. Gjiri i Gramës dhe disa shpella.

2.4.6.1 Makiat mesdhetare dhe brigjet shkëmbore

Një diversitet i lartë i bimësisë karakterizon shpatet e kodrave dhe habitateve të tjera të gadishullit dhe ishullit. Rrëza e Kanalit-Karaburuni dhe ishulli i Sazanit kanë kryesisht makia të llojit sero-mesdhetar skerofilik, me dominim të *Pistacia lentiscus*, *Quercus coccifera*, *Juniperus phoenicea* dhe *Brachypodium ramosus*. Pylli me *Quercus ithaburensis subsp. macrolepis* në gadishullin Karaburunit konsiderohet si një nga pyjet më të mirë-ruajtura të kësaj peme lisi në Shqipëri. Gryka e Xhenemit dhe ishulli i Sazanit përbëjnë gjithashtu dy habitate të tjera të rëndësishme për shtretërit e zgjeruar të *Euphorbia dendroides* dhe aleancës *Oleo-Ceratonia*, të cilat kanë vlera shkencore në aspektet bio-geografike dhe ekologjike.

Në këtë zonë janë të pranishme gjithashtu një numër i konsiderueshëm i llojeve të bimëve tokësore, të cilat i përkasin Listës së Kuqe të Florës Shqiptare të vitit 2007, të tilla si: *Athamanta macedonica*, *Brassica oleracea subsp. oleracea*, *Brassica incana*, *Laurus nobilis*,

⁷ <http://www.birdlife.org/datazone/sitefactsheet.php?id=2908>

Origanum vulgare, *Prunus webbii*, *Quercus ilex*, *Limonium anfractum*, *Lotus cytisoides*, *Desmazeria marina*, *Capparis spinosa*, *Prasium majus*, *Ephedra distachia*, *Orchis sp.div.*, dhe *Daphne gnidiu* (UNDP/GEF dhe Ministria e Mjedisit, 2005b).

2.4.6.2 Habitatet bregdetare dhe detare

Vegjetacioni shkëmbor bregdetar është i pranishëm në ishullin e Sazanit dhe gadishullin e Karaburunit, ku shumica e brigjet janë shkëmbore. Brigjet me rërë ose zhavorr hasen vetëm në zona të vogla. Shkëmbinjtë vertikalë me lartësi 200-300 m janë të pranishëm në disa zona (Gryka e Xhenemit, Shpella e Haxhi Aliut etj).

Brezi i ulët (deri në 5-6 m mbi nivelin e detit) dominohet nga komunitetet e llojeve *ksero-halofitike-Crithmo-Limonietaea*. Ky brez karakterizohet nga speciet e mëposhtme: *Crithmum maritimum*, *Limonium anfractum*, *Elymus pycnanthus*, *Desmazeria marina*, *Lotus cytisoides* etj.

Brezi i sipërm banohet nga *aleanca Capparo-Putorion Lov*. Taksonomia karakteristike e këtij brezi përfshin: *Capparis spinosa*, *Putoria calabrica*, *Ephedra distachia* etj.

Llojet e habitateve detare të identifikuar në Parkun Kombëtar Detar Karaburun-Sazan deri 2014 janë paraqitur në Tabelën 5. Harta e Habitave Detare të Parkut Kombëtar Detar (PKD) Karaburun-Sazan tregohet në figurën 4.

Tabela 5: Llojet e habitateve detare të identifikuar në PKD Karaburun-Sazan

Zonat bregdetare litorale	Nëndarja e zonave	Biocenozat
Zona mediolitorale (zona e mesme e nëntokës bregdetare)	Shkëmbinj dhe shtretër të fortë mediolitoralë	Biocenoza e shkëmbinjve mediolitoralë të poshtëm
		Biocenoza e shpellave mediolitorale.
Zona infralitorale (zona e afërt e nëntokës bregdetare)	Livadhet e <i>Posidonia oceanica</i> .	Biocenoza e livadheve të <i>Posidonia oceanica</i> (=Shoqërim me <i>Posidonia oceanica</i>)
	Shkëmbinj dhe shtretër të fortë infralitoralë	Biocenoza e algave infralitorale.
Zona circalitorale (zona përreth nëntokës së bregdetit)	Shkëmbinj dhe shtretër të fortë circalitoralë	Biocenoza koralogjene
		Biocenoza e shpellave gjysmë të errëta.

2.4.6.3 Lloje peshqish dhe krustacesh të rëndësishme për tregtim

Fauna nënujore është mjaft e larmishme dhe relativisht e bollshme, veçanërisht në pjesën perëndimore të Rrëzës së Kanalit-Karaburun dhe përreth ishullit të Sazanit. Komunitetet e peshkut të detit pelagjik përbëhen nga *Merluccius merluccius*, *Trachurus trachurus*, *Parapenaeus longirostris*, *Mullus surmulletus*, dhe *Exocetus volitans*. Në nënshtresat shkëmbore afër bregdetit janë të pranishme edhe komunitetet e mëposhtme: *Diplodus Sargus*, *D. vulgaris*, *D. annularis*, *Serranus cabrilla*, *Spicara maena*, *Coris sp*, *Thalassoma pavo*, popullatat e vopës; në gropat e thella ka gjithashtu *Anthias anthias*, *Phycis phycis*,

kerr/rufjo të madh *Epinephelus sp.* dhe morena. Janë regjistruar edhe lloje të tjera interesante të përmasave të mëdha si *Mola mola* dhe *Xiphias gladius*.

Llojet e peshqve të ujërave të Karaburunit që ia vlen të përmenden, të cilat përfshihen në Shtojcën III të Konventës së Barcelonës janë: kerri/rufjo (*Epinephellus marginatus*), toni i kuq (*Thunnus thynnus*) dhe peshku shpatë (*Xiphias gladius*).

Në këtë zonë jetojnë gjithashtu edhe disa krustace të rëndësishme si karavidhet (*Homarus gammarus*), karavidhet e ujrave të ëmbla (*Palinurus elephas*), aragostat (*Scyllarides latus*), si dhe gaforret (*Maja squinado*). Këto lloje përfshihen në Shtojcën III të Konventës së Barcelonës, si lloje shfrytëzimi i të cilëve rregullohet me këtë konventë.



Figura 4: Harta e Habitatit të Parkut Kombëtar Detar “Karaburun-Sazan”

2.4.6.4 Llojet Karizmatike

Habitatet detare dhe bregdetare shqiptare vizitohen shpesh nga gjitarët e rrallë detarë. Foka mesdhetare (*Monachus monachus*) është një vizitor shumë i rrallë i ujërave bregdetare shqiptare. Kanionet dhe shpellat e zonës, shpesh të pamundura të arrihen, përfaqësojnë një habitat ideal për fokën mesdhetare, raste të cilat janë raportuar në gadishullin e Karaburunit në vitin 1982 dhe në ishullin Sazanit në 1991 (Vangeluweet etj, 1996). Dëshmi të qarta të pranisë së fokës mesdhetare janë gjetur në disa shpella, ku jepen gjurmë të shenjave në rërë që korrespondojnë me një trup gjigand dhe jashtëqitje (Antolovic J. etj, 2005). Me sa duket, shpellat përgjatë bregdetit shqiptar, veçanërisht ato të bregdetit perëndimor të gadishullit të Karaburunit, mund të shërbejnë si urë për riprodhimin e mundshëm në të ardhmen të

brigjeve të Adriatikut Qendror dhe Verior nga fokat mesdhetare, sesa si strehime "lokale" të rëndësishme të riprodhimit të popullatave të fokës mesdhetare. Zona është vizituar herë pas here edhe nga delfini i zakonshëm (*Delphinus delphis*) dhe delfini turishkurtër (*Tursiops truncatus*).

Në ujërat detare të kësaj zone është regjistruar edhe prania e breshkës së detit (*Caretta caretta*). Kjo zonë mund të jetë një korridor i rëndësishëm i emigrimit të këtyre breshkave të detit nga strehimet e tyre në ishullin Zakynthos në Greqi në detin Jon për në bregdetin e Patokut të Detit Adriatik në Shqipëri, i cili është identifikuar kohët e fundit si një vend i rëndësishëm ushqimi për këto lloje.

Nënshtresa shkëmbore, në veçanti vargjet shkëmbore të larta të Karaburunit dhe ishullit të Sazanit, janë ideale për foletë pelagjike të vezëve të pulëbardhave, p.sh. *Laridae*. Llojet më përfaqësuese të shpendëve në gadishullin e Karaburunit janë kali i qyqes dhe krahëthati (*Falco peregrines*).

2.4.6.5 Llojet e rralla, të rrezikuara dhe të kërcënuara

Parku Kombëtar i Ekosistemit Natyror Detar pranë Gadishullit të Karaburunit dhe Ishullit të Sazanit është vendbanimi i një numri të konsiderueshëm llojesh të rralla, të rrezikuara dhe të kërcënuara të faunës në shkallë globale, rajonale dhe kombëtare. Të paktën 36 lloje detare, të cilat janë me rëndësi ndërkombëtare dhe që i përkasin listave të llojeve të rrezikuara dhe/ose të mbrojtura nga disa konventa, janë të pranishme në zonën Karaburun-Sazan. Këto lloje përfshijnë leshterikët e detit, algat, sfungjerët, knidarët, molusqet, krustacet, ekinodermët, peshqit, zvarranikët, fokat, dhe cetacet. Në shkallë kombëtare, rreth 75% e llojeve të rrezikuara të kafshëve detare, kryesisht jo-vertebrorët e mëdhenj bentikë, të cilët i përkasin Listës së Kuqe të Faunës Shqiptare (2007), janë regjistruar në zonën Karaburun-Sazan. Ruajtja e këtyre llojeve të kërcënuara është një detyrim ndërkombëtar dhe një nga prioritetet e Strategjisë Kombëtare të Biodiversitetit dhe Planit të Veprimit përkatës. Llojet më të rëndësishme dhe të ndjeshme dhe të biocenozës (leshterikëve të detit) në zonën e gadishullit të Karaburunit – Ishullit të Sazanit, janë:

- Korali i Kuq (*Red Coral/ Corallium rubrum*),
- Midhjet shkëmbshpuese (*Lithophaga lithophaga*),
- Peshqit kerr/ rufjo (*Epinephelus marginatus*),
- Ylli i detit (*Ophidiaster ophidianus*),
- Biocenoza Koralore,
- Biocenoza e livadheve me *Posidonia oceanica*,
- Biocenoza e dominuar nga *Lithophyllum byssoides* (*Lithophyllum byssoides rims*),
- Biocenoza e algave infralitorale - komunitetet *Cystoseira*.
- Fokat Mesdhetare (*Monachus monachus*),
- Delfini i zakonshëm (*Delphinus delphis*), dhe
- Breshkat e Detit (*Caretta caretta*).

Llojet detare me interes ndërkombëtar në zonën Karaburun-Sazan që janë klasifikuar në konventat më të rëndësishme mund të gjenden në Shtojcën 1. Llojet bimore detare me interes kombëtar në zonën Karaburun-Sazan (sipas Listës së Kuqe Shqiptare 2007) mund të gjenden në Shtojcën 2. Në Listën e Kuqe të faunës shqiptare 2007 ka rreth 220 lloje të faunës detare. Rreth 75% e tyre evidentohen edhe për zonën e Vlorës, duke përfshirë zonën e Karaburunit-Sazanit.

2.5 Facilitetet ekzistuese të Zonës së Mbrojtur dhe përdorimi aktual nga vizitorët

2.5.1 Zyra dhe stendat e informacionit

Në vitin 2012 projekti i UNDP-së mbi "Përmirësimin e Menaxhimit të Mbulimit dhe Efektivitetit të Zonave të Mbrojtura Detare dhe Bregdetare" (Projekti për ZMDB-të) mbështeti krijimin e zyrës së Parkut brenda Bashkisë së Orikut. Kjo zyrë mbështet Departamentin e Mjedisit të Njesisë Administrative të Orikut dhe përdoret edhe për zbatimin e veprimtarive të Projektit për ZMDB-të. Kjo është një pikë takimi/ kontakti për rojet mjedisore/rangers, si dhe një burim informacioni për veprimtaritë që lidhen me Parkun Kombëtar Detar Karaburun-Sazan. Zyra ka tre vende pune me personel dhe është e pajisur me dy kompjuterë, lidhje interneti dhe pajisje të tjera të nevojshme për funksionim normal.

Në zonë ka dy stenda informacioni të ngritura deri tani (lutemi shihni Figurën 7). Një stendë informacioni, që ofron informacion të përgjithshëm mbi Parkun Detar është vendosur përballë Zyrës së Projektit për ZMDB-të në Orikum. Një tjetër stendë informacioni është vendosur në kepin e Shën Vasilit, që është si pikë fillimi e Parkut Kombëtar Detar në anën lindore të gadishullit Karaburunit.

2.5.2 Aksesi dhe plazhet

Për shkak të mungesës së aksesit/hyrjes nëpërmjet rrugës, fluksi turistik në ishullin e Sazanit dhe gadishullin e Karaburunit, veçanërisht anën e tyre perëndimore, ka qenë relativisht i ulët. Hyrja në zonë mund të ofrohet vetëm me varka, por kjo nuk ka qenë shumë e praktikueshme sepse plazhet e bukura rezultojnë të jenë larg nga Vlora dhe Orikumi, kështu që transporti me mjete lundrimi (me varka të vogla me motor ose jahte) është i kushtueshëm. Megjithatë, gjatë pikut të sezonit turistik në muajt korrik-gusht, plazhet e vogla të bregdetit lindor të Karaburunit (Raguza, Shën Vasili, Shën Jani) frekuentohen rregullisht, përfshirë edhe nëpërmjet eskursioneve të kryera nga disa anije. Plazhet në anën perëndimore të Karaburunit (Bristani, Dafina, Grama), megjithëse janë shumë të pastër, të qetë dhe tërheqës, frekuentohen shumë pak, për shkak të mungesës së aksesit rrugor drejt tyre. Veprimtaritë më të frekuentuara në këtë pjesë të zonës, të cilat lidhen shpesh edhe me dëmtimin e habitateve, janë zhytja dhe peshkimi me pushkë peshkimi.

Duke marrë parasysh të gjithë zonën në tërësi, numri i vizitorëve ka ardhur duke u rritur shumë çdo vit. Rreth 70% e vizitorëve janë shqiptarë ndërsa pjesa tjetër janë të huaj, kryesisht nga Kosova dhe Maqedonia. Gjatë periudhës korrik-gusht, vizitorët e përditshëm vlerësohen të jenë rreth 50.000 vetë, kryesisht përgjatë plazhit Jonufër - Radhimë - Orikum (Beqiraj etj, 2010).

2.5.3 Shëtitjet me varka

Pak vite më parë ka pasur vetëm një varkë/anije me emrin "Teuta" që ofronte vizita rreth gjirit të Vlorës dhe gadishullit të Karaburunit; më tej ajo u pasua nga një tjetër anije - "Regina Blu". Në vitin 2014 numri i anijeve/varkave që ofronin eskursione rreth gadishullit Karaburunit dhe ishullit të Sazanit arriti në katër anije të mëdha. Gjatë sezonit veror këto anije ofrojnë udhëtime të rregullta ditore nga Vlora, Radhima dhe / ose Orikumi për në pjesën lindore të Karaburunit ose ishullin e Sazanit, por mund të bëhen gjithashtu rezervime të tyre për udhëtime të veçanta përreth Parkut Kombëtar Detar deri në Gjirin e Gramës. Përveç këtyre anijeve, ka gjithashtu edhe një numër varkash të vogla peshkimit që ofrojnë vizita private në grupe të vogla (4-6 persona) në zonën përreth apo në plazhet e vogla përgjatë gadishullit të Karaburunit. Një anije peshkimi ofron gjithashtu drekë për turistët me peshkun e freskët të ditës (që peshkohet gjatë udhëtimit).

2.5.4 Zhytjet

Deri në vitin 2014 nuk ka pasur ende asnjë qendër të përshtatshme zhytjesh në këtë zonë. Pesë shoqata ofrojnë mësim zhytjeje, pajisje dhe guida zhytjeje. Kapaciteti i tyre varion nga 3-4 deri në 10 zhytës. Edhe pse nuk ka statistika të sakta, gjatë sezonit të verës së vitit 2014 ka pasur rreth 300-500 zhytës në zonë. Këto qendra janë të vendosura në Vlorë, Orikum dhe Radhimë. Ato bashkëpunojnë me qendrat e zhytjes në Itali. Vendet më të popullarizuara të zhytjes janë në kepin e Gjuhëzës, në pjesën perëndimore të ishullit të Sazanit dhe në pjesën perëndimore të gadishullit të Karaburunit. Turistët kontaktojnë me këto shoqata zhytjeje nëpërmjet agjencive turistike apo hoteleve të kësaj zone.

2.6 Sistemi social - ekonomik

Burimet kryesore të këtij seksioni janë Plani Prioritar i Veprimtimit për Zonën e Mbrojtur Detare Sazan-Karaburun (Beqiraj etj., 2010) dhe Studimi Social-Ekonomik për ZMDB "Karaburun-Sazan" (Puka, 2012).

2.6.1 Popullsia dhe fshatrat

Nuk ka fshatra apo vendbanime të përhershme në Parkun Kombëtar Detar "Karaburun-Sazan". Komuniteti më i afërt lokal është në Njesinë Administrative Orikum, në pjesën juglindore të Zonës së Mbrojtur Detare, duke përfshirë edhe Orikumin si qendër kryesore, si dhe fshatrat e Dukatit, Tragjasit dhe Radhimës. Në vitin 2011, popullsia e komunës Orikum u llogarit në 11,954 banorë, në 3,964 familje (mesatarisht 3 anëtarë për çdo familje, e cila është një rënie krahasuar me vitin 2001, kur madhësia mesatare e një familjeje ishte 4 anëtarë) (Puka, 2012).

Dendësia e popullsisë në komunën e Orikumit është e ulët. Ajo ka një mesatare prej 30 banorësh për kilometër katror. Ky fakt lidhet me territoret mjaft të mëdha të pabanuara që rrethojnë vendbanimet e komunës së Orikumit, të tilla si gadishulli i Karaburunit (56 km²) ose parku i Llogarasë (10,4 km²).

2.6.2 Struktura e familjeve

Komuniteti vendas i zonës është i organizuar në bazë të strukturës së familjes, kryesisht të përbërë nga 4 anëtarë. Marrëdhëniet ndërmjet individëve nuk tejkalojnë modele të klanit apo të organizimeve të jetës shoqërore. Emigrimi ka krijuar çekuilibër në strukturën moshore; të rinjtë e moshës 17 - 30 vjeç po largohen nga zona për të gjetur punë në zona të tjera urbane të Shqipërisë ose për të emigruar jashtë vendit. Rreth 60% e popullsisë së zonës është në emigracion.

2.6.3 Arsimi

Pesë shkolla fillore (9 vjeçare) frekuentohen nga 472 fëmijë të shkollës, dy shkolla të mesme ose kolegje (4 vjeçare) ndiqen nga 524 studentë dhe tri kopshte fëmijësh (me 250 fëmijë gjithsej). Në total, zona ka 1200 fëmijë shkolle dhe studentë dhe rreth 130 mësues në zonën përkatëse. Rreth 25% e nxënësve ndjekin studimet në Universitet.

2.6.4 Punësimi

Sektorët kryesorë të punësimit në këtë zonë janë: bujqësia dhe blegtoaria; pylltaria; sektori shtetëror publik (si arsimi, shëndetësia, shërbimet sociale, dhe administrata lokale); bizneset (si turizmi, hotelet, baret dhe restorantet, ndërtimet) dhe dyqanet; peshkimi si dhe guoret dhe minierat. Sektori privat siguron 90% të punësimit ndërsa sektori publik vetëm 10%. Veprimtaritë bujqësore dhe fermat nuk konsiderohen si burim kryesor i të ardhurave për shumicën e popullsisë vendase për shkak të vështirësive të aksesit në tregje, mungesës së mekanizimit të aktiviteteve të fermerëve, dhe zonës së kufizuar të tokës së përshtatshme

për bujqësi. Megjithatë, në një farë mënyre shumica e popullsisë është e përfshirë me veprimtari blegtorale dhe bujqësore, dhe rreth 74% e totalit të të ardhurave familjare në Njesine administrative të Orikumit vjen nga blegtoria.

2.6.5 Emigrimi

Që nga ndryshimet politike të viteve 1990, ka pasur një rritje të lëvizjes së popullsisë në tërësi. Emigrimi në këtë zonë karakterizohet nga këto lëvizje kryesore të popullatës: emigrimi nga kjo zonë për në vendet fqinje; emigrimi për në shtetet përtej detit; migrimi i banorëve drejt zonave të tjera urbane, duke kërkuar mundësi të reja në qytete të tjera ose në zonat afër tyre. Më shumë se 60% e banorëve të komunës së Orikumit kanë emigruar jashtë vendit. 75% e emigrantëve punojnë në Itali, 20% në Greqi dhe pjesa e mbetur prej 5%, në SHBA dhe në vende të tjera të BE-së.

2.6.6 Besimi fetar

Rreth 90% e popullsisë së zonës është myslimane; komuniteti ortodoks vlerësohet të jetë në 7% ndërsa bashkësia katolike në 3%. Historikisht, nuk ka pasur asnjë konflikt midis ndjekësve të feve të ndryshme.

2.6.7 Veprimtaritë Ekonomike

Peshkimi dhe Akuakultura. Sektori i peshkimit në Shqipëri është relativisht i vogël, megjithatë ky sektor është i rëndësishëm nga pikëpamja socio-ekonomike pasi përbën një burim të rëndësishëm punësimi në zonat bregdetare dhe të largëta.

Rregulloret e peshkimit përfshijnë disa kufizime në lidhje me veprimtarinë e peshkimit në interes të ruajtjes dhe mbrojtjes së tyre. Në bazë të Rregullores në lidhje me masat menaxhuese për shfrytëzimin e qëndrueshëm të burimeve të peshkut në det⁸, ndalohej çdo veprimtari peshkimi dhe akuakulture në pjesën e jashtme të bregut të Karaburunit, nga kepi i Gjuhëzës deri tek Rrugët e Bardha (Palasë) në largësi prej 1 milje detare prej vijës bregdetare apo në 50 m izobat, në rastin kur kjo thellësi arrihet në një distancë më të shkurtër. Një përmbledhje e zonave të mbrojtura nga peshkimi gjendet në Shtojcën 3.

Peshkatarët raportojnë se burimet lokale të peshkimit janë të kufizuara dhe se të ardhurat e tyre janë në rënie. Popullata e një lloji shumë të ndjeshëm, i kerrit/ rufjos *Epinephelus marginatus*, e shpërndarë përgjatë gjithë gadishullit të Karaburunit dhe bregdetit të ishullit të Sazanit tregon rënie të fuqishme për shkak të mbishfrytëzimit.

Si pjesë e studimit socio-ekonomik të ZMDB “Karaburun-Sazan” (Puka, 2012), peshkatarët e zonës plotësuan një pyetësor dhe rezultatet janë paraqitur këtu.

Në vitin 2012, në Portin e Vlorës kishte 71 anije peshkimi tregtare të regjistruara, që është një rënie në krahasim me vitin 2006 kur kishte 86 anije. Ka 2-4 anëtarë ekuipazhi në anije ose në total rreth 200 peshkatarë gjithsej. Numri i flotës aktive në gjendje pune është rreth 50 anije, të cilat nuk punojnë me të njëjtën sasi orë pune në vit. Peshkatarët më aktivë kanë shpenzuar maksimumi 2.300 orë në vit. Numri i përgjithshëm i udhëtimit të regjistruara gjatë vitit 2010 ishte 130 udhëtime, krahasuar me rreth 110 udhëtime në vitin 2012. Peshkatarët e tjerë kanë shpenzuar më pak kohë pune, nga 900 deri 1200 orë pune në vit. Në shumicën e rasteve, 80% e udhëtimit janë brenda zonës së Karaburun-Sazanit.

⁸ Regullorja Nr. 8 e datës 11.11.2009 “Mbi masat e menaxhimit për shfrytëzimin e qëndrueshëm të burimeve të peshkut në Det”

Të dhënat e intervistave të peshkatarëve tregojnë se ata kompensojnë kostot e larta të karburantit dhe të ardhurat e tyre të pakta me shtyrjen e afateve të mirëmbajtjes së anijeve dhe pajisjeve të tyre. Kostoja e lartë e karburantit ka shkaktuar uljen e numrit të udhëtimeve për peshkim në këtë zonë, dhe shumica e tyre janë lokalizuar kryesisht në zonën Karaburun-Sazan.

Për sa i përket prurjeve të peshkut të kapur në breg dhe të ardhurave nga peshkimi në këtë rajon, dhe në veçanti në zonën Karaburun-Sazan, speciet ekonomikisht më të rëndësishme të kohëve të fundit kanë qenë karkalecat, barbuni i kuq dhe merluci. Sasia vjetore e prurjeve të peshkut të kapur në breg për një anije ndryshon nga 1.500 deri 3.000 KV. Ndërsa, për sa i përket shitjes së peshkut të detit, peshkatarët shesin kryesisht direkt tek qendra e shpërndarjes së peshkut dhe te blerës të ndryshëm.

Veprimtaria e peshkimit kryhet në pjesën perëndimore dhe veri-perëndimore të gadishullit të Karaburunit, jashtë gjirit të Vlorës (peshkimi brenda gjirit dhe në thellësitë më pak se 40 m është i ndaluar). Zona nga ishulli i Sazanit deri në derdhjen e lumit Vjosa është një nga zonat më të frekuentuara nga anijet e peshkimit, kryesisht nga varkat/anijet me rrjeta fundore. Llojet më të shpeshta të peshkut që kapet në këto ujëra detare janë merluci (*Merluccius merluccius*), barbuni (*Mullus barbatus*), barbuni i shkëmbit (*Mullus surmuletus*), gjuhëza (*Solea sp.*), levreku (*Dicentrarchus labrax*), koca (*Sparus aurata*), ngjala (*Anguilla anguilla*), skumri (*Scomber scomber*), stavridhi (*Trachurus trachurus*), lojba (*Lichia amia*), sepjet (*Sepia officinalis*), kallamarët (*Loligo sp.*) dhe karkalecat e detit (*Marsupenaeus japonicus*).

Shumica e peshkatarëve që përdorin anijet e mëdha të peshkimit (kryesisht anijet me rrjeta fundore) janë banorë të qytetit të Vlorës, ndërsa peshkatarët nga fshatrat (si Radhima, Orikumi, Dukati) përdorin kryesisht varka të vogla për peshkim në lagunën e Orikumit ose ujërat e cekëta. Llojet kryesore të peshkut të kapur janë: koca e egër (*Sparus aurata*), levreku, dentali (*Sparidae*). Këta peshkatarë ia shesin prodhimet e tyre drejtpërdrejt publikut dhe/ose restoranteve të zonës së bregdetit.

Në zonat shkëmbore të dy anëve të gadishullit të Karaburunit, dhe ndonjëherë edhe në anën perëndimore të ishullit të Sazanit, ushtrohen veprimtari të paligjshme të peshkimit. Kjo veprimtari e paligjshme praktikohet kryesisht për mbledhjen e midhjes shkëmbshpuese (*Lithophaga lithophaga*), dhe të karavidheve (*Palinurus elephas*, *Homarus gammarus*) që janë lloje të mbrojtura në detin Mesdhe. Praktikohen gjithashtu zhytjet dhe peshkimi i paligjshëm me drita dhe pushkë-shtizë/ pushkë peshkimi, veçanërisht për peshkimin e kerrit/ rufjos, (*Grouper Epinephelus sp.*).

Akuakultura ushtrohet edhe në këtë zonë, kryesisht përmes kultivimit të peshqve. Kërkesa në rritje turistike për peshk deti në zonën e Vlorës ka shkaktuar kohët e fundit një rritje në prodhimin e akuakulturës. Ajo është zhvilluar në ujërat bregdetare përgjatë pjesës lindore të gadishullit të Karaburunit, jashtë zonës së mbrojtur. Aktualisht, akuakultura po luan rol të rëndësishëm në tregun e peshkut me tendenca në rritje të mëtejshme, për shkak se numri i vizitorëve në zonën bregdetare të gjirit të Vlorës, veçanërisht gjatë sezonit të verës, pritet të jetë në rritje të vazhdueshme (Beqiraj etj., 2010 dhe Puka, 2012).

Turizmi. Gjiri i Vlorës është i njohur në Shqipëri si një destinacion shumë tërheqës për kalimin e pushimeve. Në ditët e sotme, shumë shtëpi të qytetit të Orikumit ofrohen për strehim (për fjetje dhe vakti i mëngjesit) për vizitorët, sidomos gjatë pushimeve të verës. Shume hotele dhe restorante janë ndërtuar në vitet e fundit (në forma të ligjshme dhe të paligjshme) përgjatë gjithë bregdetit lindor të gjirit të Vlorës, duke përfshirë edhe qytetin e

Vlorës, si dhe fshatrat tradicionale turistike të Jonufrës, Radhimës dhe Orikumit. Këto hotele ofrojnë akomodim dhe ushqim, por edhe shërbime të tjera që lidhen me kohën e lirë dhe veprimtari argëtuese. Në shumë raste, zhvillimet e turizmit kanë qenë të paplanifikuara dhe veprimtaritë turistike të pakontrolluara, të cilat i kanë shkaktuar dëme serioze habitateve natyrore dhe biodiversitetit.

Për shkak të mungesës së aksesit rrugor, prania turistike në ishullin Sazanit dhe gadishullin e Karaburunit, veçanërisht në anën e tyre perëndimore, ka qenë relativisht e ulët. Hyrja në zonë mund të sigurohet vetëm me anije, por kjo nuk ka qenë shumë e praktikueshme sepse plazhet e përshtatshme janë larg nga Vlora dhe Orikumi, kështu që transporti me anije deri atje (me varka të vogla me motor ose jahte) është i kushtueshëm. Megjithatë, gjatë pikut të sezonit turistik në muajt korrik-gusht, plazhet e vogla në bregdetin lindor të Karaburunit (ai i Raguzës, Shën Vasilit dhe Shën Janit) frekuentohen rregullisht, përfshirë edhe nëpërmjet ekskursioneve me disa anije. Plazhet në anën perëndimore të Karaburunit (ai i Bristanit, Dafinës, dhe Gramës), megjithëse janë shumë të pastra, të qeta dhe shumë tërheqëse, frekuentohen shumë pak për shkak të mungesës së aksesit rrugor. Aktivitetet më të frekuentuara në këtë pjesë të zonës që lidhen shpesh edhe me dëmtimin e habitateve, janë zhytja dhe peshkimi me pushkë-shtizë/ pushkë peshkimi.

Duke marrë parasysh të gjithë zonën në tërësi, numri i vizitorëve është rritur shumë nga viti në vit. Rreth 70% e vizitorëve janë shqiptarë ndërsa pjesa tjetër janë të huaj, kryesisht nga Kosova dhe Maqedonia. Gjatë muajve korrik-gusht vlerësohet që zona të ketë rreth 50.000 vizitorë të përditshëm, kryesisht përgjatë plazheve të Jonufrës-Radhimës-Orikumit (Beqiraj etj, 2010).

2.6.8 Infrastruktura

Ofrimi i lehtësive të përshtatshme të infrastrukturës është parakusht i zhvillimit socio-ekonomik. Analiza e sistemeve të infrastrukturës është bërë pjesë e studimit socio-ekonomik të ZMDB “ Karaburun-Sazan” (Puka, 2012). Rezultatet paraprake të infrastrukturës në zonën e Orikumit paraqiten në Tabelën 6.

Furnizimi me ujë. Uji i pijshëm në këtë zonë sigurohet nga burimet natyrore, përmes lumenjve të Dukatit dhe Izvorit (me pompim) dhe puset e ujit. Në pjesën jugore të gadishullit të Karaburunit ka burime natyrore të ujit, ndërsa në pjesën veriore dhe qendrore ato pothuajse nuk ekzistojnë. Nuk ekziston ndonjë sistem për transportimin e ujit të pijshëm në Karaburun. Ishulli i Sazanit nuk ka burime të ujit të pijshëm, ndërsa në të shkuarën uji i pijshëm është transportuar me anije nga Vlora për banorët dhe ushtarakët në ishull. Ujërat për vaditje merren nga lumi i Izvorit (nëpërmjet stacionit të pompimit), nga lumi i Dukatit (ujë me rrjedhje të lirë), si dhe nga puset nëntokësore.

Tabela 6: Infrastruktura në zonën e Orikumit

Vlerësimi	Perspektiva
Spektori: Transporti	
Nën-Spektori: Rrugët	
Hyrje/ akses nga fshatrat për në rrugët kombëtare. Kushte të këqija të disa rrugëve hyrëse. Kushte të këqija të rrugëve për në objektet me tërheqje turistike.	Projekti i aksesit rrugor: Fshati Radhimë deri në rrugën kombëtare do të mbështetet nga Programi Shqiptar i Fondit të Zhvillimit Rural. Projektet që lidhen me objektet/vend-ndodhjet turistike të përgatitura nga Bashkia, p.sh, aksesit i rrugës tek Kisha e Marmiros.
Nën-Spektori: Portet	
Një Port Turistik Privat “Marina e Orikumit”.	Sipas investitorëve të huaj – kapaciteti maksimal rreth 600

Vlerësimi	Perspektiva
Objektet kryesore së bashku me godinat e hoteleve dhe rezidenciale.	kalata. Integrimi i Marinës së Orikumit në peizazhin detar lokal dhe ndihma ndaj banorëve vendas për përfitimin maksimal nga infrastruktura detare.
Sektori: Ujërat	
Nën-Sektorët: Furnizimi me Ujë dhe Ujërat e Zeza	
Burime të konsiderueshme ujore. Probleme me organizimin dhe menaxhimin e furnizimit ekzistues me ujë të pijshëm. 65% e familjeve në Orikum janë lidhur në sistemin e furnizimit me ujë, pjesa tjetër përdorin ujë me puse. Në fshatra ka kushte të këqija të sistemit të ujit të pijshëm, në raste të pakta me puse individuale. 60% e familjeve të lidhura me sistemin e ujërave të zeza në Orikum. Depozita/gropa septike në fshatra. Ndotje e përhapur dhe e përgjithshme dhe dëmtime mjedisore.	Situata do të përmirësohet së shpejti nga kryerja e punimeve civile për sistemin e furnizimit me ujë dhe njësinë e trajtimit të ujërave të zeza, e cila është në proces zbatimi. Punimet janë kryer me mbështetjen financiare të Bankës Islamike dhe Qeverisë Shqiptare. Është e nevojshme të përfshihen në projekt çështje të menaxhimit dhe organizimit.
Sektori: Mbetjet e ngurta	
Nën-Sektorët: Mbetjet shtëpiake dhe mbetjet e ndërtimeve	
Menaxhim i mirë nga ndërmarrja bashkiake "Baitel Ltd." por vend-grumbullim i papërshtatshëm për shkarkimin e mbetjeve, i caktuar nga Bashkia e Orikumit. Vend-depozitime të hapura të shkarkimit të mbetjeve në të gjithë zonën. Vend-grumbullimi i mbetjeve të ndërtimit dhe vend-grumbullimi i mbetjeve bashkiake kryhen së bashku në qytetin e Orikumit, si dhe disa raste edhe përgjatë rrugës.	Bashkia është në proces të caktimit të një vend-depozitimi të ri të mbetjeve, si dhe tendenca "historike" për një vend-grumbullim rajonal (Komuna Qendër dhe Bashkia Vlorë). Kontrolli i territorit nga Bashkia. Edukimi i popullsisë për këto çështje.
Sektori: Energjia Elektrike	
Vetëm një kabinë elektrike në secilin fshat. Mbulim 100% por jo i mjaftueshëm në sasi dhe cilësi të shpërndarjes për shkak të amortizimit të linjave të shpërndarjes.	Më shumë kabina elektrike në fshatra dhe përmirësimi i cilësisë së shërbimit nga operatori i OSSH-së.
Sektori: Telekomunikacioni	
Ekzistenca e vetëm Alb Telecom në qytezën e Orikumit, ndërsa në fshatra është funksional një ofrues tjetër shërbimesh. Të gjithë operatorët e telefonisë celulare janë të pranishëm në zonë. Shërbim interneti vetëm në qytezën e Orikumit.	

Burimi: Studimi socio-ekonomik për ZMDB "Karaburun-Sazan" (Puka, 2012)

2.6.9 Pronësia mbi tokën

Parku Kombëtar Detar zë vetëm zonën detare, kështu që pronësia mbi tokën nuk konsiderohet të jetë një çështje problematike. Megjithatë, për shkak se nuk ka menaxhim efektiv të Zonës së Mbrojtur, pa një bashkëpunim përkatës me tokën më të afërt, pronësia mbi tokën është gjithashtu e rëndësishme për administratën e menaxhimit të Zonës së Mbrojtur.

Pronësia mbi tokën është ende një çështje me ndjeshmëri të lartë në Shqipëri. Kjo është pranuar në mënyrë të përsëritur nga qeverisja dhe komunitetet lokale si një çështje tepër e rëndësishme dhe ende e pazgjidhur. Çështja është më e prekshme në zonën e Orikumit për shkak të trysnive të zhvillimit të pasurive të patundshme mbi zonat bregdetare dhe migracionit në rritje në drejtim të bregut të detit.

Raportet e larta të tokës në pronësi private, që janë të copëzuara në ngastra relativisht të vogla të pronarëve të ndryshëm dominon aktualisht këtë zonë, së bashku me tokat me sipërfaqe të madhe të pronësisë publike, që përfshijnë pronat e ushtrisë dhe të marinës ushtarake. (Puka, 2012). Konfliktet mbi pronësinë e tokës (ish-pronarët, anëtarët e

Ndërmarrjes Bujqësore Shtetërore, të ardhurit kohët e fundit) dhe presionet nga shoqëritë e ndërtimit, konsiderohen si kërcënimet kryesore për menaxhimin efektiv të zonës dhe ruajtjen e peizazheve të rëndësishme të tokave të hapura. Kjo çështje duhet të zgjidhet me përpjekje të përbashkëta të qeverisë qendrore dhe lokale, dhe kur është e mundur, edhe me mbështetjen e Administratës së Menaxhimit të Zonës së Mbrojtur.

2.7 Struktura aktuale dhe e parashikuar e qeverisjes

Në periudhën e hartimit të Planit të Menaxhimit nuk ka pasur administratë të menaxhimit për Parkun Kombëtar Detar “Karaburun-Sazan”⁹. Në shkurt 2014, Ministria e Mjedisit realizoi një reformë drastike të organizimit të shërbimit pyjor në Shqipëri. Reforma parashikoi ndarjen e menaxhimit dhe të roleve rregullatore në nivel lokal, si dhe krijimin e drejtorive rajonale të shërbimit pyjor, siç kërkohet nga “Ligji për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor” i vitit 2005. Kjo reformë pati ndikim të madh tek personeli i Zonës së Mbrojtur, i cili u shkurtua në mënyrë të konsiderueshme.

Seksionet e Zonave të Mbrojtura nuk kanë automjete, disponojnë pajisje të kufizuara (veçanërisht pajisjet në terren dhe për monitorimin), si dhe kanë fonde të kufizuara (pothuajse nuk kanë fare) për mbulimin e shpenzimeve operative. Nuk ka pasur asnjë investim në zonat e mbrojtura nga buxheti i shtetit gjatë këtyre 5 viteve të fundit. Me strukturën e re nuk ka më personel të caktuar për këto zona.

Megjithatë, Qeveria ka filluar një proces të reformimit të administratës të zonës së mbrojtur, duke prezantuar idenë e krijimit të agjencisë kombëtare për zonat e mbrojtura. Pavarësisht strukturës së sistemit të Zonave të Mbrojtura, ende qëndron propozimi për një strukturë qeverisjeje për Parkun Kombëtar Detar “Karaburun-Sazan”. Është e rëndësishme të pranohet që Zonat e Mbrojtura (të paktën zonat e mëdha) duhet të plotësohen me staf lokal, që do të thotë se ato duhet të kenë personel përkatës që të veprojnë në nivel lokal në çdo zonë.

Megjithatë, Meqenëse Plani i Menaxhimit për Zonën e Mbrojtur të ardhshme të Sazanit është duke u përgatitur nga Konservatori i Bregdetit / Conservatoire du Littoral (CdL), paralelisht me Planin e Menaxhimit të Parkut Kombëtar Detar “Karaburun-Sazan”, është rënë dakord që të propozohet një njësi e përbashkët menaxhimi. Si rrjedhojë propozimi në vijim është një propozim i përbashkët i strukturës qeverisëse të të dyja Zonave të Mbrojtura tokësore dhe detare të gjirit të Vlorës. Administrata e propozuar e Menaxhimit të Parkut Kombëtar Detar (PKD) të Karaburun-Sazanit jepet në figurën 5.




Figura 5: Administrata e propozuar e Menaxhimit të PKD “Karaburun-Sazan”

Duhet të theksohet se Administrata e Menaxhimit të Zonës së Mbrojtur mund të fillojë të funksionojë me një numër të kufizuar personeli, duke e rritur atë në mënyrë graduale, kur

⁹ Ligji mbi Zonat e Mbrojtura përcakton “Administratën e Zonës së Mbrojtur” si një strukturë shtetërore me detyrë ruajtjen dhe administrimin e një zone konkrete të mbrojtur.

rrethanat ta lejojnë këtë. Ligji për Zonat e Mbrojtura përcakton se ZM-të mund të financohen edhe nga veprimtaritë e tyre fitimprurëse, që në praktikë do të thotë se ZM-të mund të ofrojnë shërbime me pagesë (p.sh. vizita me udhërrëfyes) apo mund të përcaktojnë tarifën e hyrjes në zonat e mbrojtura.

Komiteti i Menaxhimit të Parkut Kombëtar të Llogarasë, të Parkut Kombëtar Detar Karaburun-Sazan, dhe të Kompleksit Natyror Karaburun-Rrëza e Kanalit-Orikum-Tragjas-Dukat është krijuar në vitin 2012. Komiteti është përgjegjës për menaxhimin dhe mbrojtjen e zonës, përfshirë edhe zbatimin e planit të menaxhimit. Ai është organizuar në nivel lokal dhe administratat e Zonës së Mbrojtur veprojnë si sekretariatet e tyre teknike.

2.8 Peizazhi dhe trashëgimia kulturore

Zona e Karaburunit dhe gjiri i Vlorës, si një zonë më e gjerë ku ndodhet Parku Kombëtar Detar dhe nga ku vijnë vizitorët për në PKD, janë të mirënjohura për vlerat e tyre kulturore dhe historike. Orikumi, që ndodhet në pjesën jug-lindore të gadishullit të Karaburunit (jashtë PKD-së pasi PKD-ja mbulon vetëm zonën detare) ka qenë një qendër e rëndësishme ekonomike dhe kulturore në Mesdhe gjatë periudhave të lashta greke dhe romake.

Vlerat historike dhe arkeologjike të zonës janë unike dhe shumë të rëndësishme për turizmin. Disa mbetje arkeologjike dhe historike janë të pranishme në lagunën e Orikumit, gjirin e Vlorës dhe Karaburunit, p.sh. gjiri i Gramës dhe disa shpella. Gjiri i Gramës gjendet në bregdetin jug-perëndimor të gadishullit të Karaburunit; ai është një ish-port i famshëm që nga lashtësia. Mbi shkëmbinjtë e gjirit të Gramës ka shumë mbishkrime në gjuhët e vjetra greke dhe latine, që datojnë më shumë se 2000 vjet më parë, të cilat e kanë bërë këtë gjiri të konsiderohet si "ditari shkëmbor" më i pasur në Mesdhe.

Pjesa nënujore e Karaburunit mban një numër të konsiderueshëm të anijeve të mbytura dhe shumë objekte arkeologjike, të cilat vërtetojnë lidhjet midis kësaj zone dhe qytetërimeve të tjera të periudhave romake dhe greke. Evidentohen një numër i madh i anijeve të mbytura kryesisht në bregdetin perëndimor (përfshirë dy luftërat botërore), si dhe amforat afër kepit të Shën Nikollës në bregun lindor të ishullit të Sazanit. Në bregun lindor të zonës janë evidentuar mbetjet e tre anijeve të mbytura në gjirin e Vlorës dhe të dy gurorëve të lashta (njëra ndodhet në veri të Pasha Limanit me skulptura me kokë të kuqe nga periudha klasike).

2.9 Studimet dhe kërkimet shkencore në lidhje me Zonat e Mbrojtura Detare.

Edhe pse administrata e parkut do të jetë kryesisht një organ menaxhimi dhe jo institucion kërkimor, menaxhimi efektiv i ruajtjes kërkon informacione të sakta të zonës përkatëse. Kështu, kërkimi i bazuar në çështjet e menaxhimit dhe me objektiva të orientuara është një komponent i rëndësishëm i objektit të punës të administratës së parkut.

Kërkimi shkencor është një nga veprimtaritë e rëndësishme, të cilat promovohen dhe lehtësohen nga ana e zonave të mbrojtura detare. Parku Kombëtar i Ekosistemit Natyror Detar pranë Gadishullit të Karaburunit dhe Ishullit të Sazanit është një burim i vlefshëm shkencor që do të tërheqë dhe inkurajojë gjithnjë e më shumë angazhimin dhe kërkimet e shkencëtarëve dhe hulumtuesve. Nga ana tjetër, disa hulumtime/kërkime mund të jenë shumë të dëmshme për burimet e rëndësishme natyrore, veçanërisht në rastet kur projekti kërkimor bazohet në mbledhjen e një numri të madh të mostrave të faunës dhe florës apo mostrave të tjera. Si rrjedhojë, veprimtaritë kërkimore duhet të rregullohen dhe projektohen në mënyrë që të kontribuojnë në menaxhimin e Zonave të Mbrojtura Detare. Një numër i madh studimesh që lidhen me zonat e mbrojtura detare janë zhvilluar deri tani në Shqipëri. Një listë e disa prej këtyre studimeve jepet në Tabelën 7.

Tabela 7: Studimet që lidhen me ZMD-të në Shqipëri

Raporti	Autori	Viti
Projekti i UNDP/ GEF mbi “Mbrojtjen e Ligatinave dhe Ekosistemit Bregdetar në Rajonin e Mesdheut		
Vlerësim i Situatës Mjedisore të Vendndodhjeve të Projektit 2000/2005 (Delta e Vjosës dhe zona e gjirit të Vlorës)	MedWetCoast (MWC)	Qershor 2006
Projekti i UNDP/ GEF mbi “Mbështetjen e Veprimeve të Vendit mbi vlerësimin e boshllëqeve të CBD PoWPA/ PA dhe zhvillimin e Zonave të Mbrojtura Detare – Shqipëria”.		
Propozim mbi Zonat e Mbrojtura Detare në Shqipëri.	Virginie Tilot	Tetor 2009
Vlerësimi i Boshllëqeve të Zonave të Mbrojtura, Biodiversiteti Detar. Legjislacioni mbi Zonat e Mbrojtura dhe ZMD-të.	Lefter Kashta	Mars 2010
Plani Prioritar i Veprimit (PPV) për Zonën e Mbrojtur Detare Sazan - Karaburun.	Sajmir Beqiraj, Violeta Zuna, Eno Dodbiba	2010
Granti Përgatitor i Projektit (GPP) për UNDP/ GEF		
Menaxhimi Detar dhe Bregdetar në Shqipëri – Vlerësimi i Nevojave të Ngritjes së Kapaciteteve.	Andrian Vaso	Dhjetor 2012
Projekti i UNDP-së për “Zonat e Mbrojtura Detare dhe Bregdetare”		
Raporti mbi Zonat e Mbrojtura Detare, Shqipëria. (analizë ligjore).	Milieu Shpk.	Tetor 2009
Vlerësimi i Zonave Bufrike me Rëndësi në Zonat e Mbrojtura Detare dhe Bregdetare.	Andrian Vaso	Tetor 2013
Projekti i UNDP/ GEF mbi “Përmirësimin e Efektivitetit të Mbulimit dhe Menaxhimit të Zonave të Mbrojtura Detare dhe Bregdetare” (Projekti për ZMDB-të).		
Një përmbledhje mbi Potencialet e Turizmit në Zonën e Mbrojtur Detare dhe Bregdetare të Sazan – Karaburunit.	Genc Metohu	Dhjetor 2012, Draft-raport
Vlerësimi i menaxhimit të burimeve pyjore të zonës bregdetare ndaj zhvillimit të tij social – ekonomik.	Bilena Hyseni	Draft-raport 2012
Studimi socio-ekonomik për ZMDB “Karaburun – Sazan”.	Madlina Puka	Dhjetor 2012
Plani Strategjik për Zonat e Mbrojtura Detare dhe Bregdetare (PSZMDB).	INCA	Prill 2013, Draft përfundimtar.
Struktura e propozuar e Administratës dhe Menaxhimit për Parkun Kombëtar Detar të Gadishullit të Karaburunit dhe Ishullit të Sazanit.	Sajmir Beqiraj Rishikuar nga Alec Dawson Shepherd	Janar 2014, draft
Fondi i Besimit CEB/Norvegji/ Projekti FSHZH (“Punët me Komunitetin III”.)		
Plani i Zhvillimit Lokal të Bashkisë së Orikumit (2009 – 2013)	Bashkia Orikum	2009, do të përgatitet një plan i ri.

Megjithë këto studime, ende mungojnë shumë kërkime themelore për zonat e mbrojtura. Si rrjedhojë, Plani i Menaxhimit propozon gjithashtu veprimtari që lidhen me kërkimet shkencore dhe monitorimin e vazhdueshëm të llojeve kryesore të detit dhe habitateve. Ky kërkim duhet të synojë përmbushjen e objektivave të menaxhimit të ZMD-së, të cilat janë identifikuar gjatë procesit të hartimit të Planit të Menaxhimit.

3 VLERËSIMI I ZONËS SË MBROJTUR DHE ANALIZA E KUADRIT INSTITUCIONAL

3.1 Analiza e Vlerave dhe Kërcënimeve

Analiza e vlerave dhe kërcënimeve u bë së bashku me grupet e interesit, nëpërmjet Seminarit/workshopit të parë për Vlerat, Kërcënimet dhe Vizionin. Së pari vlerat, dhe më pas kërcënimet u identifikuan, diskutuan dhe rishikuan në seancë plenare. Pas seminarit, u bë prioritizimi i vlerave dhe kërcënimeve. Analiza e vlerave shërbeu si pika e fillimit për analizën e kërcënimeve, dhe gjithashtu edhe për të gjitha pjesët vijuese të procesit të planifikimit.

Vlerat dhe kërcënimet u lidhën me modelin konceptual, ku gjithashtu u identifikuan edhe grupet e përdoruesve që shoqërojnë kërcënimet, sjellja që shkakton kërcënimet dhe shkakun kryesor i sjelljes. Identifikimi i shkaqeve kryesore të sjelljeve ishte i dobishëm për identifikimin në vazhdim të objektivave dhe veprimtarive të menaxhimit.

Gjithashtu, vlerat dhe kërcënimet u hodhën në hartë dhe, gjatë Seminarit për përgatitjen e propozimit të zonimit, grupet e interesit i rishikuan dhe përditësuan këto harta, të cilat më pas shërbyen si bazë për përgatitjen e propozimit të përbashkët të zonimit.

3.1.1 Vlerat

Vlerat janë grupuar në tri kategori: vlera natyrore, socio-ekonomike dhe kulturore dhe historike. Më poshtë bëhet një përshkrim i shkurtër i vlerave; një përshkrim dhe diskutim më i hollësishëm i vlerave mund të gjendet në Përshkrimin e Zonës së Mbrojtur.

3.1.1.1 Vlerat natyrore

Livadhet e Posidonia-s. *Posidonia oceanica* është endemike për Mesdheun, dhe është një nga llojet më të përhapura të leshterikëve të detit në rajon. Ai është një lloj shumë i rëndësishëm për krijimin e habitateve dhe ofron habitate për shumë lloje. *Posidonia oceanica* është një lloj që rritet shumë ngadalë dhe që i duhet një kohë e gjatë për të rikolonizuar zonat nga e cila është larguar. Për shkak të ndikimeve të ndryshme, si ndryshimi i klimës, llojet invazive dhe veprimtari të ndryshme njerëzore si hedhja e spirancës, livadhet e *Posidonia-s* janë shumë të kërcënuara.

Formacionet koralogjene dhe habitate të tjera detare të cenueshme. Biocenoza koralogjene dhe biocenoza e shpellave gjysmë të errëta janë të rëndësishme për shkak të diversitetit të lartë (pasurisë së llojeve) dhe kompleksitetit të madh strukturor. Në sipërfaqen e formacioneve koralogjene rriten disa nga llojet më të mbrojtura dhe të vlerësuara nga pikëpamja ekonomike, si koralit i kuq. Për shkak të larmisë së tyre, formacionet koralogjene konsiderohen si një nga peizazhet detare më tërheqëse për zhytjen me aparat frymëmarrjeje/bombul oksigjeni (scuba diving). Habitatit i formacioneve koralogjene kërcënohet drejtpërdrejt nga veprimtari të ndryshme njerëzore, duke përfshirë ndryshimet e klimës, peshkimin, ndotjen, sedimentimin e ngritur/rritur, agregateve e algave mucilagjenore dhe llojet invazive.

Llojet e peshqve dhe krustaceve. Lloje të rëndësishme peshqish në këtë zonë janë kerri/rufjo, toni i kuq dhe peshku shpatë. Krustace të rëndësishme janë karavidhja, karavidhja e ujërave të ëmbla, aragosta, dhe gaforrja (maja squinado). Të gjitha ato renditen si lloje shfrytëzimi i të cilave rregullohet në Mesdhe për të siguruar dhe mbajtur statusin e preferuar të ruajtjes së tyre.

Formacionet gjeologjike. Peizazhi nënujor i zonës është i një cilësie të jashtëzakonshme me shkëmbinj, shpella nënujore dhe faunën dhe florën që e shoqëron, dhe në disa vende edhe mbetje arkeologjike. Pjesa perëndimore e Karaburunit është gjithashtu e pasur me formacione koralogjene dhe tipare interesante nënujore gjeomorfologjike, dhe shkëmbinj nënujorë. Zona konsiderohet si pjesa më mbresëlënëse e bregdetit shqiptar për zhytje me bombul oksigjeni/ scuba diving, e cila ende nuk është shumë e zhvilluar në Shqipëri.

Llojet detare të rrezikuara dhe mbrojtura (duke përfshirë llojet karizmatike). Në PKD “Karaburun-Sazan” gjenden shumë lloje të rrezikuara dhe kërcënuara të faunës, të rralla në nivel global, rajonal dhe kombëtar. Të paktën 36 lloje detare, të rëndësishme ndërkombëtare dhe që janë pjesë e listave të llojeve të rrezikuara dhe/ose të mbrojtura të disa konventave, janë të pranishme në zonë. Në shkallë kombëtare, rreth 75% e llojeve të rrezikuara të kafshëve detare, kryesisht jovertebrorët e mëdhenj bentikë janë regjistruar në zonën Karaburun-Sazan. Habitatet detare dhe bregdetare shqiptare vizitohen shpesh nga të ashtuquajturat “lloje karizmatike”- vertebrorët detarë. Gjenden tri lloje breshkash detare të rrezikuara globalisht: breshka e detit, breshka e gjelbër dhe shumë më e rralla breshka lëkurore e detit. Janë raportuar pesë lloje cetacesh dhe nga këto delfini i zakonshëm, delfini turishkurtër dhe kashaloti konsiderohen si lloje të rrezikuara në Mesdhe. Në zonën Karaburun-Sazan janë regjistruar llojet e mëposhtme: delfini i zakonshëm, delfini turishkurtër, breshka e detit, por gjithashtu edhe foka mesdhetare (hera e fundit ishte në vitin 1991 rreth ishullit të Sazanit). Kjo zonë konsiderohet si një habitat potencial për fokën mesdhetare.

Peizazhi. Shpatet e gadishullit të Karaburunit janë vende shumë të thepisura në anën perëndimore dhe kulmojnë në pjesën qendrore. Bregdeti perëndimor i gadishullit është i skalitur nga shpella dhe kanione të thella që rrallë mbarojnë me plazhe me zall apo me rërë. Ai karakterizohet nga shkëmbinj të lartë vertikale që vazhdojnë edhe nën ujë në thellësi të mëdha. Këta shkëmbinj janë mjaft të gërryer dhe shpella të shumta, kryesisht nën ujë, mund të shihen ku rrjedhin shpesh burime me ujë të ëmbël. Ishulli i Sazanit shtrihet në veri të gadishullit të Karaburunit. Pjesa perëndimore e tij karakterizohet nga shkëmbinj të lartë vertikale që janë skalitur nga kanione të thella që zgjerohen nga shpellat që shfaqen pothuajse nën ujë. Në anën lindore, vija bregdetare është më e ulët dhe përbëhet nga rrudhosje shtresash të pjerrëta gurësh gëlqerorë që zhyten në det. Këto formacione janë tërheqëse për vizitorët dhe kanë vlera shtesë për shkak të bimësisë së mirë zhvilluar.

3.1.1.2 Vlerat socio-ekonomike

Peshkimi artizanal. Sektori i peshkimit në Shqipëri është relativisht i vogël, sidoqoftë është i rëndësishëm nga pikëpamja socio-ekonomike, meqenëse është një burim i konsiderueshëm vendesh pune në zonat bregdetare dhe ato të largëta. Dikur peshkimi ishte kryesor për ekonominë e bregdetit jugor të Shqipërisë. Peshkimi artizanal ekziston përgjatë bregdetit të Rrëza e Kanalit-Karaburun dhe Sazan. Peshkimi brenda gjirit të Vlorës dhe në thellësi më pak se 40 m është i ndaluar. Zona nga ishulli i Sazanit deri tek grykëderdhja e lumit Vjosa është një nga zonat më të frekuentuara nga varkat/anijet e peshkimit, kryesisht anije me rrjeta fundore.

Turizmi. Gjiri i Vlorës është i mirënjohur në Shqipëri si një destinacion shumë tërheqës për argëtim, kryesisht turizëm dielli dhe plazhi. Sot ofrohet shumë akomodim në zonë, nga hotelet deri tek apartamentet private, si edhe shumë restorante dhe bare. Në shumë raste zhvillimi i turizmit ishte i paplanifikuar dhe veprimtaritë turistike jo të rregulluara. Për shkak të mungesës së infrastrukturës rrugore, trysnia turistike në ishullin e Sazanit dhe gadishullit të Karaburunit, veçanërisht në anën perëndimore, ka qenë relativisht e ulët. Veprimtaritë

më të frekuentuara në këtë pjesë, që shpesh shoqërohen me dëmtim të habitateve janë zhytja dhe peshkimi me pushkë peshkimi.

Plazhet. Aksesit në Karaburun dhe Sazan ofrohet vetëm me varkë, por nuk është praktikuar shumë sepse plazhet e përshtatshme janë shumë larg nga Vlora dhe Orikumi, kësaj transporti me varka (me motoskafë dhe jahte të vogla) është i kushtueshëm. Sidoqoftë, gjatë kulmit të sezonit turistik, korrik-gusht, plazhet e vogla në bregdetin lindor të Karaburunit (Raguza, Shën Vasili, Shën Jani) frekuentohen rregullisht, duke përfshirë pak shëtitje me varka. Plazhet në anën perëndimore të Karaburunit (Bristani, Dafina, Grama), pavarësisht se janë të pastra, të qeta dhe mjaft tërheqëse, frekuentohen shumë pak, për shkak të mungesës së infrastrukturës rrugore.


3.1.1.3 Vlerat kulturore dhe historike

Mbetjet arkeologjike dhe historike. Kjo vlerë ka të bëjë kryesisht me anijet e mbytura dhe mbetje të ndryshme arkeologjike nënujore, të cilat konfirmojnë lidhjet mes kësaj zone dhe qytetërimeve të tjera të periudhës greke dhe romake. Ka një numër të madh rrënoja anijesh, kryesisht në bregun perëndimor (duke përfshirë anije nga dy Luftërat Botërore) si edhe amforat afër kepit të Shën Nikollës në bregun lindor të ishullit të Sazanit.

Shpellat me mbishkrime historike. Vlerat historike dhe arkeologjike të zonës janë unike dhe shumë të rëndësishme për turizmin. Disa mbetje arkeologjike dhe historike janë të pranishme në lagunën e Orikumit, gjirin e Vlorës dhe Karaburun, p.sh. gjiri i Gramës dhe disa shpella. Gjiri i Gramës shtrihet në bregun jugperëndimor të gadishullit të Karaburunit; dikur në lashtësi ishte një port shumë i famshëm. Në shkëmbinjtë e gjirit të Gramës ka mbishkrime të shumta në greqishten e vjetër dhe latinisht, që datojnë më shumë se 2.000 vjet më parë dhe që e kanë bërë këtë gji të konsiderohet si “ditari shkëmbor” më i pasur në Mesdhe. Shpella e Haxhi Aliut në Karaburun është një tjetër zonë e trashëgimisë kulturore që tërheq vizitorët.

Mbetjet historike ushtarake. Duke pasur parasysh pozicionin e ishullit të Sazanit, ai ka qenë gjithnjë një pikë strategjike dhe ushtria ka qenë e pranishme për një kohë të gjatë atje. Gadishulli i Karaburunit dhe ishulli i Sazanit kanë disa baza ushtarake, dhe gjithashtu një numër bunkerësh, tunelesh dhe llogore për mbrojtje. Kjo vlerë ka të bëjë me bunkerët ushtarakë që kanë qenë ndërtuar gjerësisht në gadishullin e Karaburunit dhe ishullin e Sazanit.

Në Figurën 6 bëhet renditja e vlerave. Turizmi, peshkimi artizanal dhe peizazhi renditen më lart. Turizmi është i rëndësishëm për komunitetin dhe ekonominë lokale, është i rëndësishëm për të ardhurat e ZMD-së, mund të ngjallë më shumë interesin e publikut të gjerë dhe është ende në gjendje mjaft të mirë kësaj menaxhimi mund të jetë efektiv në mbrojtjen e burimeve. Peshkimi artizanal është i rëndësishëm për shpalljen e ZMD-së, ai është gjithashtu i rëndësishëm për komunitetin dhe ekonominë lokale, mund të ngjallë më shumë interesin e publikut të gjerë dhe ka nevojë urgjente për mbrojtje. Peizazhi si vlerë është i rëndësishëm për komunitetin dhe ekonominë lokale, është ende në gjendje të mirë kësaj menaxhimi mund të jetë efektiv në mbrojtjen e tij, dhe administrata e parkut ka juridiksionin e duhur për ta menaxhuar.



Legjenda: vlerat natyrore – të gjelbra; vlerat socio-ekonomike – blu; vlerat kulturore dhe historike- vjollcë

Figura 4: Renditja e vlerave

3.1.2 Kërcënimet

U identifikuan kërcënimet ndaj vlerave dhe u bë lidhja e tyre me përdoruesit, sjelljen e tyre dhe shkaqet kryesore të sjelljeve. Kërcënimet e identifikuar dhe disa veprimtari njerëzore që lidhen me këto kërcënime janë përshkruar dhe diskutuar më me hollësi.

Degradimi i livadheve të Posidonia-s. Livadhet e Posidonia-s ndikohen nga hedhja e spirancës, llojet invazive (p.sh. *Caulerpa racemosa*), ndotja, peshkimi sipër livadheve, ndryshimi i klimës, etj. Ka pasur rënie në popullatën e *P. oceanica* për shkak të dëmeve mekanike të shkaktuara nga peshkimi me rrjeta fundore dhe varkat, zhvillimi i bregdetit dhe eutrofikimi. Livadhet e Posidonia-s, si terren shumimi për shumë lloje, janë përkeqësuar gjithashtu edhe për shkak të ndryshimeve në strukturën e flotës së peshkimit. Më shumë se 50% e varkave të peshkimit kanë motorë me fuqi të vogël (100 KF) dhe prandaj janë në gjendje të zbatojnë teknika të thella peshkimi (peshkimin me rrjeta fundore) në zona të cekëta meqenëse nuk janë në mund të peshkojnë në zona më të thella se 50 metra.

Degradimi i formacioneve koralogjene. Formacionet koralogjene kërcënohen nga peshkimi dhe zhytja e paligjshme, hedhja e spirancës, llojet invazive, ndotja, ndryshimi i klimës, etj. Arsyeja kryesore e degradimit të koralit të kuq të vlerësuar shumë nga pikëpamja komerciale është mbledhja e tyre e paligjshme nga zhytësit, por edhe peshkimi me rrjeta fundore peshkimi me rrjetë, hedhja e spirancës së varkave, ndotja dhe ngrohja globale në rritje.

Reduktimi i rezervave të peshkut dhe mbledhja e jovertebrorëve detarë. Intensiteti i veprimtarisë së peshkimit dhe efekti i tyre mbi popullatat e llojeve kryesore dhe atyre rastësore mbetet i panjohur. Sidoqoftë peshkatarët raportojnë që burimet lokale të peshkut janë të kufizuara, dhe që të ardhurat e tyre janë në rënie. Për shembull, popullata e një lloji shumë të ndjeshëm, kerrit/rufjos *Epinephelus marginatus*, e shpërndarë gjatë gjithë bregdetit të gadishullit të Karaburunit dhe ishullit të Sazanit tregon rënie të theksuar për shkak të mbishfrytëzimit. Shumë peshkatarë vendas që u intervistuan gjatë përgatitjes së Planit të Menaxhimit thanë që rezervat e peshkut në zonë janë zvogëluar, për shkak të peshkimit të paligjshëm dhe zbatimit të dobët të ligjit. Ata do të donin të kishte më shumë kontrolle dhe të përmirësohej zbatimi i ligjit. Rezervat e peshkut kërcënohen nga mbipeshkimi, peshkimi i paligjshëm, llojet invazive, ndotja, dhe në mënyrë të tërthortë, nga degradimi i livadheve të Posidonia-s dhe formacioneve koralogjene. Peshkimi i paligjshëm përfshin peshkimin me dinamit, peshkimin me rrjeta me madhësi të paligjshme, peshkimin në zona të ndaluara, mbledhjen e midhjes shkëmbshpuese etj. Zhvillohen veprimtari të

peshkimit të paligjshëm në zonat shkëmbore në të dy anët/faqet e gadishullit të Karaburunit dhe ndonjëherë edhe në anën perëndimore të ishullit të Sazanit. Zhvillohet veprimtaria e paligjshme e mbledhjes së midhjes shkëmbshpuese *Lithophaga lithophaga*, dhe karavidheve/aragostave (*Palinurus elephas*, *Homarus gammarus*) që janë lloje të mbrojtura në Mesdhe. Zhytja dhe peshkimi i paligjshëm me drita dhe pushkë peshkimi praktikohet po ashtu, si për peshkimin e kerrit/rufjos *Epinephelus sp.* për shembull. Peshkimi i pakontrolluar në bregdet mund të dëmtojë drejtpërdrejt jo vetëm rezervat e peshkut, por tërthorazi mund të ndikojë edhe mbi llojet e shpendëve dhe gjitarëve që ushqehen me peshq. Si u përmend më sipër, terreni i shumimit i *Posidonia oceanica* është dëmtuar shumë për shkak të ndryshimeve në strukturën e flotës së peshkimit, çka ka sjellë rënien e rezervave të peshkut.

Degradimi i formacioneve gjeologjike. Degradimi i formacioneve gjeologjike shkaktohet nga peshkatarët, zhytësit dhe turistët. Ata mund të dëmtojnë shpellat dhe shkëmbinjtë, ndonëse kërcënimet ndaj formacioneve gjeologjike kanë lidhje me degradimin e habitateve detare si shpellat gjysmë të errëta dhe formacionet koralogjene.

Akuakultura intensive. Akuakultura praktikohet gjithashtu në zonën bregdetare, kryesisht nëpërmjet kultivimit të peshkut. Në dy vendndodhje përgjatë pjesës lindore të gadishullit të Karaburunit (Raguza) ka kafaze në det ku kultivohet koca (*Sparus aurata*) dhe levreku (*Dicentrarchus labrax*). Kërkesa në rrije e turistëve për peshk deti në Vlorë ka shkaktuar rritjen e kohëve të fundit në prodhimin e akuakulturës. Efekti më i mirënjohur i kultivimit të peshkut është pasurimi bentik, d.m.th. rritja e përmbajtjes organike të sedimenteve nën kafazet/rezervuarët e peshkut. Depozitimi i materialit organik të grimcuar, d.m.th. fekalet dhe ushqimi i pangrënë nga peshqit, në afërsi të fermës, çon në një kërkesë të rritur për oksigjen, një gjendje që shpesh rezulton në metabolizëm anaerobik (pa ajër) dhe anoksi (mungesë oksigjeni në gjak).

Ndotja. Ndotja përbën një kërcënim ndaj cilësisë së ujit, jetës detare (livadhet e Posidonia-s, formacionet koralogjene, llojet e peshqve, algat, jovertebrorët detarë, etj) por edhe ndaj shëndetit të njeriut. Ndotja mund të vijë nga bregu i detit në formën e mbetjeve dhe ujërave të zeza dhe nga deti në formën e shkarkimeve dhe derdhjeve aksidentale të naftës. Kur shqyrtohet ndotja që vjen nga bregu i detit, një nga problemet kryesore në zonë janë mbetjet e ngurta, që gjenerohen gjerësisht nga veprimtaritë turistike dhe ato të transportit detar në rajon, por edhe nga komunitetet vendase (nga ndërtimi dhe mbetjet urbane). Sa i takon ujërave të zeza, ato përbëjnë një kërcënim serioz për shkak të lidhjeve të dobëta të sistemit të kanalizimeve dhe ekzistencës së shumë pak impianteve të trajtimit. Vendbanimet bregdetare (qytetet dhe fshatrat) në zonën e Vlorës mund të kenë ndikime potenciale negative mbi ZMD-në nëse modelet aktuale të veprimtarive zhvillimore nuk ndryshojnë. Kërcënimi nga ndotja zakonisht lidhet me zonat rrethuese dhe nuk mund të rregullohet pa një bashkëpunim të mirë ndër-sektorial, veçanërisht në nivel lokal dhe rajonal. Kur shqyrtohet ndotja që vjen nga deti, shkarkimet nga anijet, si ujërat e zeza nga cisternat e zeza (jashtëqitjet) dhe gri (uji i përdorur për larje) duhet të jenë shqetësimi kryesor. Anijet përfshijnë ato që kalojnë transit për në dhe nga porti i Vlorës, anijet e peshkimit që futen në Vlorë apo porte të tjera të vogla, si edhe varkat shëtitëse dhe varkat me vela që futen në ZMD për veprimtari rekreacionale/argëtuese. Këto mjete lundruese gjithashtu mund të derdhin naftë dhe të shkarkojnë mbetje të ngurta. Bojërat kundër prishjes (bojërat e fundit të anijes) gjithashtu përbëjnë një shqetësim të madh. Rreziku i një incidenti të madh ndotjeje për shkak të një derdhjeje aksidentale të naftës në ZMD është i lartë duke pasur parasysh vëllimin e anijeve tregtare që kalojnë në këtë zonë. Një dergje naftë në apo ngjitur më ZMD-në do të kishte efekte të dëmshme jo vetëm mbi cilësinë e ujit

por edhe ndikime të mëdha ekologjike tek zogjtë/ shpendët dhe tek shoqërimet në zonën ndërmjet baticës në ZMD.

Llojet invazive. Llojet e huaja invazive përbëjnë një nga problemet më të mëdha me të cilat përballet biodiversiteti sot në shkallë globale. Në sistemet detare të moderuara, llojet invazive janë shkaqet e dokumentuara të shkatërrimit të komunitetit detar. Ekziston një port i rëndësishëm në Vlorë në të cilin vijnë anije nga ujërat rajonale dhe kombëtare. Llojet e futura në këto porte mund të përhapen në ujërat fqinje. Llojet e huaja të faunës detare përdoren gjithashtu në marikulturë në pjesë të ndryshme të Mesdheut. Një kërcënim për biodiversitetin detar është ai i llojeve invazive të *Caulerpa racemosa* var. *cylindracea* që është përhapur gjerësisht në pellgun e Mesdheut, duke përfshirë gjirin e Vlorës dhe pjesën lindore të gadishullit të Karaburunit (Kashta *et al.*, 2005). Në gjirin e Vlorës gjendet edhe *Halophila stipulacea*, që e ka origjinën nga Oqeani Indian dhe është një lloj invaziv në Mesdhe (Kashta, 1992).

Potenciali i pashfrytëzuar. Mbizotërimi i diellit dhe plazhit, vizitat e paorganizuar, mungesa e ofertës për zhytje, mungesa e aksesit/infrastrukturës rrugore në zonë, etj. janë të gjitha veprimtari që kanë të bëjnë me potencialin e pashfrytëzuar turistik. Në anën tjetër, hedhja e plehrave, shkarkimet, ndotja, ndërtimi dhe mbishfrytëzimi (plazhet e mbipopulluara) lidhen me efektet negative të veprimtarive turistike. Ndikimet që shoqërojnë veprimtaritë që turistët kryejnë gjatë një vizite si noti, lundrimi, zhytja me tub ajrimi (snorkelling) dhe zhytja me aparat frymëmarrjeje/ (bombul oksigjeni) scuba diving mund të jetë një burim i vazhdueshëm shqetësimi për organizmat detare dhe mund të rezultojë në shkatërrimin fizik të lokalizuar të leshterikëve të detit, algave apo formacioneve koralogjene, madje edhe në nivelet e përdorimit. Pritet që turizmi do të jetë një nga përdorimet më të rëndësishme të ZMD-së për shkak të burimeve natyrore dhe kulturore të saj. Ajo mund të jetë një burim i besueshëm i rritjes ekonomike të qëndrueshme dhe të konsiderueshme, nëse krijohet dhe menaxhohet siç duhet. Përveç se krijon mundësi ekonomike dhe vende pune për sektorin privat dhe sjell përfitime për komunitetin vendas për rritjen e standardit të tyre të jetesës, ajo është një burim i rëndësishëm të ardhurash për administratën e parkut për t'u investuar në menaxhimin e saj. Lehtësimi dhe menaxhimi i turizmit dhe promovimi i ekoturizmit në zonë është rrjedhimisht një nga çështjet kryesore të menaxhimit për administratën e parkut. Karaburun-Sazani ka një potencial të shkëlqyer për zhvillimin e ekoturizmit duke pasur parasysh burimet e saj unike të trashëgimisë natyrore dhe kulturore. Një gamë e gjerë veprimtarish turistike në natyrë mund të parashikohen të zhvillohen në ZMD, duke përfshirë soditjen e jetës së egër (kafshëve/shpendëve të egra), zhytjen, zhytjen me tub ajrimi/ snorkelling apo shëtitjet në det meqë kjo zonë ka një potencial të lartë për turizëm të kohës së lirë, rekreacional/argëtues, të aventurës, të plazhit dhe turizëm të trashëgimisë kulturore. Administrata e parkut duhet të ketë parasysh zhvillimin e planifikuar të turizmit në rajon që pritet të rritet në mënyrë eksponenciale në pesë-dhjetë vitet e ardhshme. Pritet që ZMD-ja të bëhet atraksioni kryesor turistik teksa rajoni bëhet më i njohur, kësaj është shumë e rëndësishme të sigurohet zhvillimi i qëndrueshëm i turizmit, që do t'u sjellë përfitime komuniteteve vendase.

Degradimi i zonave arkeologjike dhe historike. Degradimi i zonave arkeologjike dhe historike lidhet me humbjen e vlerave të këtyre zonave. Zhytësit, turistët dhe vizitorët e varkave/varkëtarët mund të dëmtojnë apo vjedhin pasuritë arkeologjike, si edhe artefaktet nga anijet e mbytura, dhe ata gjithashtu mund të hedhin spirancën në këto zona, çka shkakton shkatërrimin e tyre. Rritja e ndërgjegjësimit, rregullore më të mira dhe zbatimi i ligjit do të siguronte përmirësimin e gjendjes së zonave arkeologjike dhe historike.

Të gjitha kërcënimet u renditën sipas numrit të burimeve dhe zonës së ndikuar, nivelit të ndikimit dhe vëmendjes së kërkuar. Mund të shihet qartë nga figura 7 që ulja e rezervave të peshkut përbën kërcënimin më të madh, sepse ky kërcënim shënjestron numrin më të madh të burimeve (vlerave), mbulon të gjithë zonën, ndikimi i tij është i lartë dhe kërkon vëmendje të menjëhershme.

Potenciali i pashfrytëzuar, që ka lidhje me turizmin, duhet të konsiderohet si një mundësi, që zona të zhvillohet në mënyrë të qëndrueshme. Kjo do të thotë që komunitetet vendase duhet të përfitojnë nga ky zhvillim, por gjithashtu zhvillimi të mos ndikojë negativisht tek Parku Kombëtar Detar.




Figura 5: Renditja e kërcënimeve

3.1.3 Modelet konceptuale

Modelet konceptuale u përgatitën për të gjitha temat e Planit të Menaxhimit. Ato ndihmojnë të kuptohet lidhja ndërmjet vlerave, kërcënimeve, përdoruesve, si edhe sjelljes së tyre dhe shkaqeve themelore të sjelljeve. Në shtojcën 4 paraqitet një hartë e përbashkët e vlerave dhe kërcënimeve të PKD “Karaburun-Sazan”. Në Figurat 7-10 tregohen modelet konceptuale për temat e ruajtjes së biodiversitetit, trashëgimisë kulturore dhe historike, peshkimit dhe turizmit vendas.




Figura 6: Modeli konceptual për ruajtjen e biodiversitetit




Figura 7: Modeli konceptual për trashëgiminë kulturore dhe historike




Figura 8: Modeli konceptual për peshkimin lokal




Figura 9: Modeli konceptual i turizmit

4 MENAXHIMI I ZONËS SË MBROJTUR

4.1 Vizioni

PKD Karaburun-Sazan është një zonë detare e mirë menaxhuar me vlera të jashtëzakonshme natyrore, ku burimet përdoren në mënyrë të qëndrueshme për të mbështetur një ofertë të larmishme turistike.

Vizioni i Parkut Kombëtar Detar “Karaburun-Sazan” pasqyron pikëpamjet e grupeve të interesit, dhe elementet e vizionit u hartuan në bashkëpunim me grupet e interesit.

4.2 Temat, Objektivat dhe Veprimtaritë e Planit të Menaxhimit

Temat janë pjesa planifikuese e Planit të Menaxhimit që trajtojnë çështje të ngjashme, me fjalë të tjera temat përfaqësojnë çështjet kryesore me të cilat merret Plani i Menaxhimit.

Qëllimet specifikojnë thelbin e çdo teme, dhe duke i ndarë në disa objektiva, jepet një pamje më e qartë e asaj që synohet të arrihet nëpërmjet Planit. Me anë të përdorimit të treguesve është e mundur të bëhet monitorimi i arritjes së objektivave të menaxhimit. Objektivat realizohen nëpërmjet zbatimit të veprimtarive të planifikuara. Treguesit e zbatimit të veprimtarive mundësojnë monitorimin e zbatimit të Planit të Menaxhimit, si edhe punën e administratës së menaxhimit. Ata ndahen në tregues afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë, për shkak të periudhës së gjatë të zbatimit dhe për të siguruar një monitorim më efektiv.

Për të kuptuar më mirë programin dhe prioritetet e veprimtarive të veçanta të menaxhimit, është përcaktuar një kuadër kohor i planifikuar për të gjitha veprimtaritë të ndara sipas viteve. Gjithashtu është hartuar lista e partnerëve, pa të cilët zbatimi i disa elementeve të të gjithë veprimtarisë nuk do të ishte i mundur.

Për shkak të burimeve të kufizuara njerëzore dhe financiare, veprimtaritë prioritare janë identifikuar si më poshtë:

Prioriteti 1 – veprimtaritë që duhet të zhvillohen gjatë zbatimit të Planit të Menaxhimit. Këto janë veprimtaritë kryesore dhe moszbatimi i tyre minon suksesin e të gjithë Planit të Menaxhimit.

Prioriteti 2 – veprimtaritë që duhet të zbatohen gjatë vënies në zbatim të Planit të Menaxhimit. Ekziston një farë fleksibiliteti, por duhet të ketë një arsye të fortë për të mos i zbatuar këto veprimtari.

Prioriteti 3 – veprimtaritë që mund të ndërmerren kur të ketë kohë dhe fonde të disponueshme.

4.2.1 Tema A: Ruajtja e biodiversitetit

Si pjesët detare edhe ato tokësore të gadishullit të Karaburunit dhe ishullit të Sazanit kanë vlera të larta sa i takon biodiversitetit dhe habitateve natyrore.

Zona detare karakterizohet nga biocenoza të ndryshme duke përfshirë livadhet e Posidonia-s, algat ndërbregdetare, formacionet koralogjene, shpellat gjysmë të errëta, etj. dhe disa lloje mbrohen me ligj, disa lloje dhe habitate gjithashtu konsiderohen të kërcënuara në nivel mesdhetar. Ndonëse janë bërë disa studime në zonë, pjesa nënujore e Karaburun-Sazanit nuk është eksploruar shumë. Prandaj është e nevojshme të bëhen kërkime për të marrë njohuri për llojet dhe shpërndarjen e tyre, në mënyrë që ndikimet e mundshme negative mbi popullata të caktuara të mund të vëzhgohen dhe zgjidhen në kohë.

Së pari është e nevojshme të bëhet përditësimi i hartës ekzistuese të habitateve në Parkun Kombëtar Detar dhe pastaj të bëhet monitorimi i statusit të habitateve dhe llojeve të rëndësishme, si livadhet e Posidonia-s, formacionet koralogjene, dhe gjitarët dhe breshkat e detit. Është gjithashtu e nevojshme të monitorohet sjellja e njeriut, si numri i varkave që futen në ZMD, intensiteti i zhvillimit të akuakulturës në zonën rrethuese dhe gjithashtu ndërmarrja e masave për rregullimin e sjelljes, si peshkimi i paligjshëm, etj. ngritja e bovave të ankorimit dhe riparimi i dokeve/skelave të vogla ekzistuese janë të rëndësishme për zbutjen e trysnisë së hedhjes së spirancave mbi livadhet e Posidonia-s si edhe për sigurinë e vizitorëve.

Për vlerat e mëposhtme janë hartuar objektiva specifike:

AA Livadhet e Posidonia-s

AB Formacionet koralogjene dhe habitate të tjera detare të cënueshme

AC Llojet e rrezikuara dhe mbrojtura detare (duke përfshirë llojet karizmatike)

Në Tabelën 7 paraqitet analiza e shpejtë SWOT e temës së ruajtjes së biodiversitetit.

Tabela 5: Analiza SWOT për ruajtjen e biodiversitetit

FUQITË	DOBËSITË
<ul style="list-style-type: none">- Biodiversiteti i pasur- Njohja nga grupet e interesit	<ul style="list-style-type: none">- Menaxhim joefektiv- Ndërgjegjësim i ulët për ruajtjen e biodiversitetit- Të dhëna të pamjaftueshme për vlerat e biodiversitetit (mungon harta e habitateve)
MUNDËSITË	KËRCËNIMET
<ul style="list-style-type: none">- Mbështetja e qeverisë për ruajtjen e biodiversitetit- Mbështetja e donatorëve	<ul style="list-style-type: none">- Zbatim i dobët i ligjit- Zhvillim i parregulluar me ligj

TEMA: RUAJTJA E BIODIVERSITETIT																
QËLLIMI: Ruajtja dhe mbrojtja e llojeve dhe habitateve detare me vlerë nëpërmjet rregullimit të veprimtarive në det dhe përmirësimit të njohurive mbi rëndësinë e biodiversitetit.																
VEPRIMTARIA	Nr. Vep.	TREGUESIT E ZBATIMIT			Prio ritet	KUADRI KOHOR I ZBATIMIT (VITI)										PARTNERËT
		AFATSHKURT	AFATMESEM	AFATGJATË		1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	
OBJEKTIVI SPECIFIK: Reduktimi i degradimit dhe ruajtja e madhësisë dhe statusit të livadheve të Posidonias para plazheve (pjesa përëndimore) gjatë kuadrit kohor të planit të menaxhimit (10 vjet) TREGUESI I OBJEKTIVIT: Asnjë ndryshim apo ndryshime pozitive në statusin e livadheve të Posidonias (parametrat e monitorimit- dendësia e filizave, mbulimi i tokës, kufiri më i ulët, CI, SI)																
Hartëzimi i habitateve dhe pastaj monitorimi i statusit të Posidonias	AA1	Hartë e përditësuar e habitateve	Raportet e monitorimit	Raportet e monitorimit	2			x	x		x		x		x	Universiteti i Tiranës
Rregullimi dhe monitorimi i numrit të varkave në ZMD	AA2	Marrëveshje për rregulloren e varkave në ZMD	Statistikat e varkave	Statistikat e varkave	1	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	Rojet mjedisore/ Operatorët e varkave/ Qendrat e zhytjes
Rregullimi dhe monitorimi i intensitetit të akuakulturës; kërkimet për ndikimin e akuakulturës dhe monitorimi i tij	AA3		Raporti i monitorimit akuakulturës	Raporti i monitorimit akuakulturës	2			x	x	x	x	x	x	x	x	Universiteti i Vlorës
Ndërtimi i bovave ankoruese: vlerësimi, projektimi dhe shpërndarja	AA4		Vlerësimi i nevojave të sistemit të ankorimit	Ngritja dhe mirëmbajtja e sistemit të ankorimit	3				x	x	x	x	x			Kontraktuesi
Vlerësimi i statusit, dhe riparimi dhe mirëmbajtja e 2-3 dokeve ekzistues	AA5		Statusi i dokeve të vlerësuara; riparimi i dokeve	Mirëmbajtja e dokeve	2			x	x		x		x		x	Kontraktuesi
OBJEKTIVI SPECIFIK: Ndalimi i degradimit dhe ruajtja e statusit të formacioneve koralogjene dhe habitateve të tjera detare të cënueshme gjatë kuadrit kohor të planit të menaxhimit (10 vjet) TREGUESI I OBJEKTIVIT: Të paktën asnjë ndryshim negativ në statusin e formacioneve koralogjene (parametrat e monitorimit – p.sh. një listë e llojeve dhe bollëku i tyre)																

TEMA: RUAJTJA E BIODIVERSITETIT																
QËLLIMI: Ruajtja dhe mbrojtja e llojeve dhe habitateve detare me vlerë nëpërmjet rregullimit të veprimtarive në det dhe përmirësimit të njohurive mbi rëndësinë e biodiversitetit.																
VEPRIMTARIA	Nr. Vep.	TREGUESIT E ZBATIMIT			Prioritet	KUADRI KOHOR I ZBATIMIT (VITI)										PARTNERËT
		AFATSHKURT	AFATMESEM	AFATGJATË		1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	
Hartëzimi i habitateve dhe më pas monitorimi i statusit të koralogjeneve	AB1	Hartë e përditësuar e habitateve	Raportet e monitorimit	Raportet e monitorimit	2			x	x			x			x	Universiteti i Tiranës
Kryerja e kërkimeve për shpërndarjen, përbërjen dhe cenueshmërinë e habitateve detare	AB2		Raportet e kërkimeve	Raportet e kërkimeve	2		x		x		x		x		x	Shkencëtarë, Ekspertë
OBJEKTIVI SPECIFIK: Ruajtja e statusit të favorshëm të llojeve detare të rrezikuara dhe të mbrojtura dhe sigurimi i kalimit të sigurt të llojeve karizmatike (breshkave të ujit/detare, fokave mesdhetare, delfinëve dhe balenave) përmes korridorit gjatë kuadrit kohor të planit të menaxhimit (10 vjet)																
TREGUESI I OBJEKTIVIT: Ndryshimet në parametrat e monitorimit të llojeve detare të rrezikuara dhe mbrojtura																
Bashkëpunimi mes peshkatarëve dhe ushtarakëve për monitorimin (vëzhgimin) e llojeve karizmatike (vertebrorëve të mëdhenj detarë - (breshkave të ujit/detare, fokave mesdhetare, delfinëve dhe balenave)	AC1	Takimet e organizuara me peshkatarët dhe ushtarakët	Numri i raporteve të vëzhgimit	Numri i raporteve të vëzhgimit	2	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	Rangers, Peshkatarët, Ushtarakët
Zhvillimi dhe zbatimi i kodit të sjelljes për soditjen e kafshëve të egra në bashkëpunim me operatorët turistike	AC2	Hartimi i kodit të sjelljes	Projektimi, printimi dhe shpërndarja mjeteve të informimit; Raportet e rangersave	Numri i mjeteve të informimit të shpërndara; Raportet e Rangersave	1	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	Administrata e ZM, Rojet mjedisore /Rangers, Operatorët turistikë
Bërja e kërkimeve për shpërndarjen dhe rrezikimin e llojeve detare të rrezikuara dhe mbrojtura	AC3		Raportet e kërkimeve, inventari i llojeve	Raportet e kërkimeve, inventari i llojeve	2			x		x		x		x		Shkencëtarë, Ekspertë

4.2.2 Tema B: Trashëgimia kulturore dhe peizazhi

Zona e Karaburunit dhe gjiri i Vlorës, si një zonë më e gjerë ku shtrihet PKD-ja dhe nga ku vizitorët vijnë në PKD, janë të mirënjohura për vlerat e tyre historike dhe kulturore. Vlerat historike dhe arkeologjike të zonës janë unike dhe janë shumë të rëndësishme për turizmin, duke përfshirë zhytjen. Gjiri i Gramës dikur në lashtësi ishte një port shumë i famshëm dhe mbi shkëmbinj ka mbishkrime të shumta në greqishten e vjetër dhe në latinisht. Shpella e Haxhi Aliut është gjithashtu një vend i rëndësishëm që tërheq vizitorët. Shpellat dhe shkëmbinjtë duhet të inventarizohen dhe monitorohen në mënyrë që të ruhen.

Peizazhi nënujor në zonë është i një cilësie të jashtëzakonshme, me shkëmbinj, shpella nënujore, dhe në disa vende mbetje arkeologjike, anije të mbytura dhe objekte arkeologjike. Një vlerësim bazë i mbetjeve arkeologjike nënujore dhe monitorimi i tyre është i nevojshëm për ruajtjen e këtyre vlerave.

Pjesët perëndimore të gadishullit të Karaburunit dhe ishullit të Sazanit karakterizohen nga shkëmbinj të lartë vertikale që vazhdojnë nën ujë në thellësi të mëdha. Në pjesën perëndimore të Karaburunit dhe Sazanit vija bregdetare është më e ulët dhe më shumë e aksesueshme. Është e rëndësishme të ruhet vlera estetike e peizazhit, meqë peizazhi është ajo që e dallon këtë zonë nga zonat e tjera. Për këtë, duhet të mbahet monitorimi i ndërtimeve të paligjshme.

Për vlerat e mëposhtme janë hartuar objektiva specifike:

BA Peizazhi

BB Formacionet gjeologjike

BC Mbetjet arkeologjike nënujore

Tabela 8 paraqet një analizë të shpejtë SWOT të temës së trashëgimisë kulturore dhe peizazhit.

Tabela 6: Analiza SWOT për trashëgiminë kulturore dhe peizazhin

FUQITË	DOBËSITË
<ul style="list-style-type: none">- Prania e karakteristikave historike dhe peizazheve- Pranimi dhe krenaria e vendasve	<ul style="list-style-type: none">- Nuk ka rregullore të veprimtarive (vizitave, zhytësve)- Nuk ka qendra zhytjeje- Nuk ka shërbim të rregullt për varkat (vetëm në nivel personal)
MUNDËSITË	KËRCËNIMET
<ul style="list-style-type: none">- Potenciali për vizita turistike- Rregullim më i mirë i veprimtarive (vizitorët, zhytësit)	<ul style="list-style-type: none">- Numër i papërshtatshëm turistësh- Zhvillim i papërshtatshëm (restorante dhe bare në plazhe)

TEMA: TRASHËGIMIA KULTURORE DHE PEIZAZHI																
QËLLIMI: Ruajtja dhe mbrojtja e karakteristikave kulturore dhe historike dhe e formacioneve të mahnitshme gjeologjike nëpërmjet përmirësimit të rregulloreve dhe promovimit të praktikave të mira.																
VEPRIMTARIA	Nr. Vep.	TREGUESIT E ZBATIMIT			Prio ritet	KUADRI KOHOR I ZBATIMIT (VITI)										PARTNERËT
		AFATSHKURT	AFATMESEM	AFATGJATË		1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	
OBJEKTIVI SPECIFIK: Ruajtja e vlerës estetike të peizazhit gjatë kuadrit kohor të planit të menaxhimit (10 vjet) TREGUESI I OBJEKTIVIT: Asnjë shenjë degradimi të vlerës estetike të peizazhit (monitorimi i ndërtimeve pa leje dhe monitorimi i ndryshimeve në dokumentet e planifikimit hapësinor)																
Monitorimi i përgatitjes së dokumenteve të planifikimit hapësinor dhe pjesëmarrja në takime	BA1	Numri i takimeve të planifikimit që janë ndjekur	Numri i takimeve të planifikimit që janë ndjekur	Numri i takimeve të planifikimit që janë ndjekur	1	x	x	x	x	x	x	x	x	x	Autoritetet e Planifikimit Hapësinor	
Mbikëqyrja/vëzhgimi i ndërtimeve pa leje dhe inspektime informuese	BA2	Raportet e mbikëqyrjes/vëzhgimit (inspektim informues)	Raportet e mbikëqyrjes/vëzhgimit (inspektim informues)	Raportet e mbikëqyrjes/vëzhgimit (inspektim informues)	1	x	x	x	x	x	x	x	x	x	Rojet mjedisore	
OBJEKTIVI SPECIFIK: Ruajtja e formacioneve gjeologjike duke ndaluar degradimin e shkëmbinjve dhe shpellave (Shpella e Haxhi Aliut, Gjiri i Gramës etj.), në 5 vitet e ardhshme TREGUESI I OBJEKTIVIT: Asnjë shenjë degradimi dhe shkatërrimi të shpellave dhe shkëmbinjve (vëzhgimi i gjendjes së shpellave dhe shkëmbinjve)																
Përditësimi i inventarit të shpellave dhe shkëmbinjve dhe monitorimi i gjendjes së tyre (vëzhgimi)	BB1		Inventari i shpellave dhe shkëmbinjve	Raportet e mbikëqyrjes/vëzhgimit të rangersave	1		x	x	x	x	x	x	x	x	Shkencëtarë, Ekspertë, Rojet mjedisore Administrativa	
OBJEKTIVI SPECIFIK: Ruajtja e gjendjes aktuale të mbetjeve/rrënojave arkeologjike nënujore në zonat arkeologjike gjatë kuadrit kohor të planit të menaxhimit (10 vjet) TREGUESI I OBJEKTIVIT: Asnjë dëmtim i objekteve arkeologjike dhe i njëjti numër objektesh arkeologjike (monitorimi i numrit dhe gjendjes së objekteve arkeologjike)																
Vlerësimi bazë i mbetjeve/rrënojave arkeologjike nënujore dhe monitorimi i tyre	BC1		Rezultatet e vlerësimit bazë	Rezultatet e monitorimit	1			x	x	x	x	x	x	x	Universiteti dhe OSHC-të	

4.2.3 Tema C: Mbështetja e komuniteteve vendase dhe përdorimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore

Komuniteti vendas pranë ZM-së ka një rol të rëndësishëm në zhvillimin e zonës, si edhe në mënyrën se si bëhet menaxhohet ajo. Angazhimi i komunitetit vendas në arritjen e objektivave strategjike të menaxhimit është i rëndësishëm. Për të krijuar kushtet për përmirësimin e standardeve të jetesës të vendasve, është e rëndësishme të inkurajohen veprimtaritë tradicionale (p.sh. peshkimi artizanal), si edhe të mbështetet komuniteti vendas në realizimin e produkteve të tyre.

Gjiri i Vlorës është i mirënjohur në vend si një destinacion shumë tërheqës për argëtim, kryesisht për turizmin e diellit dhe plazhit. Sot ka shumë akomodim në zonë, nga hotelet në apartamentet private, si edhe shumë restorante dhe bare. Për shkak të mungesës së infrastrukturës rrugore, trysnia e turizmit në ishullin e Sazanit dhe gadishullin e Karaburunit, veçanërisht në pjesën perëndimore, ka qenë relativisht e vogël.

Akresi në Karaburun dhe Sazan ofrohet vetëm me varka, por nuk është praktikuar shumë, sepse plazhet e përshtatshme janë shumë larg Vlorës dhe Orikumit. Sidoqoftë, gjatë stinës së verës, plazhet e vogla në bregdetin lindor të Karaburunit frekuentohen rregullisht, duke përfshirë edhe disa shëtitje me varkë. Plazhet në pjesën perëndimore të Karaburunit frekuentohen shumë pak, për shkak të mungesës së infrastrukturës rrugore. Pritet që turizmi të jetë një nga përdorimet më të rëndësishme të ZMD-së për shkak të burimeve natyrore dhe kulturore të saj, prandaj duhet bërë monitorimi i numrit të vizitorëve (duke përfshirë zhytësit, varkat për shëtitje, etj.) dhe ndikimeve e tyre, si edhe i cilësisë së ujit.

Një gamë e gjerë veprimtarish turistike në natyrë mund të parashikohen të zhvillohen në ZMD, duke përfshirë soditjen e jetës së egër (kafshëve/shpendëve të egra), zhytjen, zhytjen me tub ajrimi/ snorkelling apo shëtitjet në det meqë kjo zonë ka një potencial të lartë për turizëm të kohës së lirë, rekreacional/argëtues, të aventurës, të plazhit dhe turizëm të trashëgimisë kulturore. Diversifikimi dhe përmirësimi i ofertës turistike është një hap i rëndësishëm në arritjen e turizmit të qëndrueshëm që do t'u sillte përfitim komuniteteve vendase dhe do të siguronte ruajtjen afatgjatë të burimeve detare. Akresi i lehtë në ZMD, nga toka dhe deti, është kërkuar në mënyrë të përsëritur nga komuniteti vendas dhe bizneset lokale, si pronarët e varkave për shëtitje. Është e rëndësishme të sigurohet akses i lirë në zonë, por në të njëjtën kohë është e nevojshme të bëhet rregullimi ligjor i veprimtarive që zhvillohen në ZMD. Plani i Menaxhimit dhe zonimi i tij parashikojnë rregullimin ligjor të veprimtarive, por është e rëndësishme të sigurohen burimet e duhura për zbatimin e këtyre rregulloreve.

Ka një numër llojesh të rëndësishme peshqish dhe krustacësh shfrytëzimi i të cilave rregullohet me ligj në Mesdhe. Dikur peshkimi ishte kryesor për ekonominë e bregdetit jugor të Shqipërisë. Peshkimi artizanal ekziston përgjatë bregdetit të Rrëza e Kanalit-Karaburun dhe Sazan, por intensiteti i veprimtarisë së peshkimit dhe efekti i tyre mbi popullatat e llojeve kryesore dhe atyre rastësore mbetet i panjohur. Sidoqoftë peshkatarët raportojnë që burimet lokale të peshkut janë të kufizuara, dhe që të ardhurat e tyre janë në rënie.

Për shkak të mungesës së kërkimeve, është e rëndësishme të zhvillohen studime ekologjike dhe socio-ekonomike. Për të siguruar përmirësimin e rezervave të peshkut dhe përmirësimin e kushteve të jetesës së peshkatarëve vendas, duhet të ndërmerret vlerësimi bazë i rezervave të peshkut dhe pastaj monitorimi i tyre, si edhe studime socio-ekonomike të peshkimit lokal. Mbikëqyrja periodike dhe zbatimi i ligjit, si edhe bashkëpunimi me inspektoratin, policinë dhe rojet bregdetare do të minimizonte peshkimin e paligjshëm, i cili për momentin konsiderohet si problemi kryesor nga shumë grupe interesi.

Për vlerat e mëposhtme janë hartuar objektiva specifike:

CA Llojet e peshqve

CB Turizmi

CC Plazhet

Në Tabelën 9 paraqitet një analizë e shpejtë SWOT e temës së mbështetjes së komuniteteve vendase dhe përdorimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore.

Tabela 7: Analiza SWOT për mbështetjen e komuniteteve vendase dhe përdorimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore

FUQITË	DOBËSITË
<ul style="list-style-type: none"> - Ekzistenca e Organizatës së Menaxhimit të Peshkimit (OMP) - Ekzistenca e shërbimit të rojeve mjedisore/rangers për monitorimin e veprimtarive të paligjshme - Mikpritja dhe oferta lokale (ushqimi) - Zhvillimi i vazhdueshëm i Planit të Menaxhimit të Turizmit - 	<ul style="list-style-type: none"> - Zbatim i dobët i ligjit - Prania e peshkimit të paligjshëm - Potenciali i pashfrytëzuar për turizëm të qëndrueshëm - Vizita të paorganizuar - Zhvillim i pakontrolluar - Fokusimi tek dielli dhe plazhi - Menaxhimi i mbetjeve
MUNDËSITË	KËRCËNIMET
<ul style="list-style-type: none"> - Destinacion i mirënjohur për diell dhe plazh - Oferta e biznesit lokal (shtëpi me qira, hotele, restorante, bare) - Vlerë në rritje e peshqve (meqë vjen nga ZM-ja) - Mbështetja e qeverisë dhe donatorëve - Rritja e promovimit të ZMD-së - Promovimi i turizmit natyror 	<ul style="list-style-type: none"> - Zhvillim i pakontrolluar - Numër i pamjaftueshëm i peshkatarëve - Politikat qeveritare që mbështesin vetëm turizmin e diellit dhe të plazhit - Menaxhimi i mbetjeve - Shumë varka (konfliktojnë me peshkatarët vendas)

TEMA: MBËSHETJTA E KOMUNITETEVE VENDASE DHE PËRDORIMI I QËNDRUESHËM I BURIMEVE NATYRORE																
QËLLIMI: Mbështetja e zhvillimit të komunitetit vendas nëpërmjet promovimit të praktikave të suksesshme të peshkimit dhe turizmit të qëndrueshëm që sigurojnë përdorimin e matur të burimeve natyrore.																
VEPRIMTARIA	Nr. Vep.	TREGUESIT E ZBATIMIT			Prio ritet	KUADRI KOHOR I ZBATIMIT (VITI)										PARTNERËT
		AFATSHKURTË	AFATMESËM	AFATGJATË		1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	
OBJEKTIVI SPECIFIK: Përmirësimi i rezervave të peshkut nëpërmjet ruajtjes së numrit të llojeve dhe rritjes së sasisë të popullatave të peshkut në 5 vitet e ardhshme.																
TREGUESI I OBJEKTIVIT: Ruajtja e numrit të llojeve të peshqve dhe përmirësimi i sasisë të popullatave me 10% në lidhje me nivelin bazë në 5 vitet e ardhshme (monitorimi i numrit të llojeve të peshqve dhe sasisë të popullatave)																
Vlerësimi bazë i rezervave të peshkut dhe më pas monitorim periodik	CA1		Vlerësimi bazë i raporteve për rezervat e peshkut	Rezultatet e monitorimit të rezervave të peshkut	1			x		x		x		x	Universiteti, OMP-ja	
Studimi social-ekonomik mbi peshkimin lokal (të ardhurat, pajisjet, përpjekjet për peshkim) dhe më pas monitorimi	CA2		Raporti i studimit socio-ekonomik për peshkimin lokal	Rezultatet e monitorimit social-ekonomik	1			x		x		x		x	Universiteti, OMP-ja, OSHC-të	
Mbikëqyrja/vëzhgimi i peshkimit të paligjshëm dhe inspektim informues	CA3	Raportet e mbikëqyrjes/vëzhgimit (inspektim informues)	Raportet e mbikëqyrjes/vëzhgimit (inspektim informues)	Raportet e mbikëqyrjes/vëzhgimit (inspektim informues)	1	x	x	x	x	x	x	x	x	x	Rojet mjedisore	
Veprimtari periodike për zbatimin e ligjit nga ana e policisë dhe inspektoratit (kontroll në det i zbatuar nga autoritetet)	CA4	Takimi i organizuar me Ministrinë e Bujqësisë dhe Policinë	Numri i gjobave (për peshkimin e paligjshëm)	Numri i gjobave (për peshkimin e paligjshëm)	1	x	x	x	x	x	x	x	x	x	Policia, Inspektorat i	
Krijimi i një shoqate të peshkatarëve artizanale (meqë nuk janë pjesë e OMP-së dhe kësaj nuk përfaqësohen)	CA5	Vlerësimi i interesit të peshkatarëve për krijimin e shoqatës	Krijimi i shoqatës; Raportet vjetore		3	x	x	x							Peshkatarët, OSHC-të	
Promovimi i vlerave të peshkimit vendas: ngritja e sistemit të etiketimit për produktet e peshkut	CA6			Ngritja e sistemit të etiketimit për	3							x	x	x	Peshkatarët, OSHC-të, Ministria e	

TEMA: MBËSHETJA E KOMUNITETEVE VENDASE DHE PËRDORIMI I QËNDRUESHËM I BURIMEVE NATYRORE																
QËLLIMI: Mbështetja e zhvillimit të komunitetit vendas nëpërmjet promovimit të praktikave të suksesshme të peshkimit dhe turizmit të qëndrueshëm që sigurojnë përdorimin e matur të burimeve natyrore.																
VEPRIMTARIA	Nr. Vep.	TREGUESIT E ZBATIMIT			Prio ritet	KUADRI KOHOR I ZBATIMIT (VITI)										PARTNERËT
		AFATSHKURTË	AFATMESËM	AFATGJATË		1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	
				produktet e peshkut											Bujqësisë	
OBJEKTIVI SPECIFIK: Sigurimi i një oferte cilësore dhe të shumëllojshme turistike dhe arritja e nivelit të qëndrueshëm të turizmit në plazhe, shpella dhe zona zhytjeje gjatë kuadrit kohor të planit të menaxhimit (10 vjet) TREGUESI I OBJEKTIVIT: Rritja e numrit të ofertave dhe shërbimeve turistike (bizneseve); Rritja e të ardhurave me të njëjtin nivel të turizmit; Rritja e kënaqësisë së vizitorëve (pyetësorët)																
Hartimi i listës së atraksioneve turistike dhe përditësimi periodik i saj	CB1	Lista e atraksioneve turistike	Lista e përditësuar e atraksioneve turistike	Lista e përditësuar e atraksioneve turistike	1	x		x		x		x		x	OSHC-të, operatorët turistikë, autoritetet vendore	
Lehtësimi i procedurave të qarta dhe të lehta për hyrjen/aksesin e operatorëve turistikë (nga deti dhe toka)	CB2	Takimi i organizuar me Ministrinë e Mbrojtjes	Marrëveshja për procedurat e hyrjes në zonë (nga toka dhe deti)		1	x	x								Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Turizmit, OSHC-të, operatorët turistikë	
Lehtësimi i lejimit të hyrjes/aksesit të lirë për turistët në ZMD nga toka	CB3	Takimi i organizuar me Ministrinë e Mbrojtjes	Mundësimi i hyrjes/aksesit të lirë në ZMD nga toka dhe deti		1	x	x								Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Turizmit, OSHC-të, operatorët turistikë	
Forcimi i bashkëpunimit mes operatorëve turistikë për cilësinë e paketave turistike dhe produkteve (standardet, cilësia e shërbimeve)	CB4	Takimi i organizuar me operatorët turistikë dhe marrëveshja e bashkëpunimit	Organizimi i vizitave studimore; ofrimi i standardeve të cilësisë në lidhje me ZMD-të për operatorët	Shkëmbimi i përvojës së vizitave studimore; miratimi i standardeve të cilësisë nga disa operatorë turistikë	1	x	x	x	x	x	x	x	x	x	Operatorët turistikë, OSHC-të, Agjencia e Turizmit (AKT-ja)	

TEMA: MBËSHTETJA E KOMUNITETEVE VENDASE DHE PËRDORIMI I QËNDRUESHËM I BURIMEVE NATYRORE

QËLLIMI: Mbështetja e zhvillimit të komunitetit vendas nëpërmjet promovimit të praktikave të suksesshme të peshkimit dhe turizmit të qëndrueshëm që sigurojnë përdorimin e matur të burimeve natyrore.

VEPRIMTARIA	Nr. Vep.	TREGESIT E ZBATIMIT			Prio ritet	KUADRI KOHOR I ZBATIMIT (VITI)										PARTNERËT	
		AFATSHKURTË	AFATMESËM	AFATGJATË		1	2	3	4	5	6	7	8	9	10		
			turistikë														
Përmirësimi i bashkëpunimit mes operatorëve turistikë kombëtarë dhe operatorëve turistikë vendas	CB5	Takimi i organizuar para-sezonal që operatorët turistikë kombëtarë të bashkëpunojnë në nivel lokal	Takimi i organizuar para-sezonal që operatorët turistikë kombëtarë bashkëpunojnë në nivel lokal	Takimi/evenimenti i organizuar para-sezonal që operatorët turistikë kombëtarë të bashkëpunojnë në nivel lokal	1	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	Operatorët turistikë, OSHC-të, Agjencia e Turizmit (AKT-ja)
Futja e standardeve të cilësisë në bizneset turistikë (sistemi i licencimit)	CB6		Vlerësimi i futjes së sistemit të licencimit të bizneseve turistike (studimi)	Veprimtaritë e mbështetura tek rezultatet e studimit	3					x	x	x	x	x	x		Operatorët turistikë, OSHC-të, AKT Ministria e Turizmit, autoritetet vendore
Certifikimi (kriteret GSTC) për destinacionet e turizmit të qëndrueshëm	CB7	Nisja e veprimtarive përgatitore për certifikimin	Minimalisht 1 shërbim i certifikuar	Minimalisht 5 shërbime të certifikuara	3	x	x	x	x	x							Operatorët turistikë, OSHC-të, autoritetet vendore
Qendër informacioni në Karaburun (kioskë)	CB8		Studimi i fizibilitetit; ngritja e qendrës së informacionit		2			x	x	x							Operatorët turistikë, OSHC-të, autoritetet vendore
Studimi i fizibilitetit për futjen e sistemit të tarifave	CB9		Studimi i fizibilitetit për futjen e sistemit të tarifave		2				x								Universiteti, OSHC-të

TEMA: MBËSHETJJA E KOMUNITETEVE VENDASE DHE PËRDORIMI I QËNDRUESHËM I BURIMEVE NATYRORE

QËLLIMI: Mbështetja e zhvillimit të komunitetit vendas nëpërmjet promovimit të praktikave të suksesshme të peshkimit dhe turizmit të qëndrueshëm që sigurojnë përdorimin e matur të burimeve natyrore.

VEPRIMTARIA	Nr. Vep.	TREGUESIT E ZBATIMIT			Prio ritet	KUADRI KOHOR I ZBATIMIT (VITI)										PARTNERËT	
		AFATSHKURTË	AFATMESËM	AFATGJATË		1	2	3	4	5	6	7	8	9	10		
Mbështetja e qendrave profesionale të zhytjes (materiale promovuese, evenimente etj.)	CB 10	Takimi i organizuar me qendrat lokale të zhytjes dhe marrëveshja për veprimtari të përbashkëta	Numri i evenimentev e për zhytësit dhe sondazhet për kënaqësinë e vizitorëve	Numri i evenimenteve për zhytësit dhe sondazhet për kënaqësinë e vizitorëve	3	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	Qendrat e zhytjes, OSHC-të
Propozimi i kuadrit ligjor për rregullimin e veprimtarive të zhytjes (duke përfshirë edhe kodin e sjelljes për zhytësit)	CB 11	Propozimi i kuadrit ligjor për rregulloren e zhytjes	Kuadri ligjor i miratuar për rregulloren e zhytjes		1	x	x										OSHC-të
Lista e vendeve/pikave të zhytjes dhe ngritja e infrastrukturës (bovat)	CB 12		Marrëveshja për listën e pikave të zhytjes; ndërtimi i bovave		1		x	x	x								Qendrat e zhytjes, OSHC-të
Mbikëqyrja/vëzhgimi dhe monitorimi i veprimtarive të zhytjes, duke përfshirë numrin e zhytësve në një vend/pikë zhytjeje (në bashkëpunim me qendrat e zhytjes)	CB 13		Dakortësimi i sistemit të monitorimit me qendrat e zhytjes, raportet e rangersave	Raportet e monitorimit për numrin e zhytësve (qendrat e zhytjes); raportet e rangersave	1			x	x	x	x	x	x	x	x	x	Rojet mjedisore Qendrat e zhytjes
OBJEKTIVI SPECIFIK: Sigurimi i një përvoje cilësore turistike, duke përfshirë plazhe natyrore të qeta, të pastra dhe jo të mbipopulluara, gjatë kuadrit kohor të planit të menaxhimit (10 vjet)																	
TREGUESI I OBJEKTIVIT: Përmirësimi i kënaqësisë së vizitorëve në lidhje me plazhet (pyetësorët)																	
Pastrimi i plazhit para fillimit të sezonit	CC1	Raporti vjetor për pastrimin e plazhit	Raporti vjetor për pastrimin e	Raporti vjetor për pastrimin e plazhit	1	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	OSHC-të, autoritetet vendore,

TEMA: MBËSHETJA E KOMUNITETEVE VENDASE DHE PËRDORIMI I QËNDRUESHËM I BURIMEVE NATYRORE

QËLLIMI: Mbështetja e zhvillimit të komunitetit vendas nëpërmjet promovimit të praktikave të suksesshme të peshkimit dhe turizmit të qëndrueshëm që sigurojnë përdorimin e matur të burimeve natyrore.

VEPRIMTARIA	Nr. Vep.	TREGUESIT E ZBATIMIT			Prio ritet	KUADRI KOHOR I ZBATIMIT (VITI)										PARTNERËT	
		AFATSHKURTË	AFATMESËM	AFATGJATË		1	2	3	4	5	6	7	8	9	10		
			plazhit														bizneset
Realizimi i një studimi për kapacitetin mbajtës të varkave (duke përfshirë varkat për ekskursionet/shëtitje, varkat lokale dhe turistët që vijnë me anije) dhe turistët në zonë	CC2		Studimi i kapacitetit mbajtës		2			x	x								Shkencëtarët, Ekspertët
Monitorimi i numrit të turistëve në plazhe gjatë sezonit të verës	CC3	Raportet e monitorimit për numrin e turistëve	Raportet e monitorimit për numrin e turistëve	Raportet e monitorimit për numrin e turistëve	1	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	Rojet mjedisore
Monitorimi i cilësisë së ujit të detit gjatë sezonit të verës	CC4	Raportet e monitorimit për cilësinë e ujit	Raportet e monitorimit për cilësinë e ujit	Raportet e monitorimit për cilësinë e ujit	2	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	Instituti i Shëndetit Publik

4.2.4 Tema D: Ndërgjegjësimi dhe Edukimi

Rritja e ndërgjegjësimit të vizitorëve dhe publikut të gjerë në lidhje me vlerat e ZMD-së duhet të jetë një nga veprimtaritë kryesore të administratës së parkut. Kjo mund të realizohet nëpërmjet evenimenteve të përvitshme, projektimit dhe shpërndarjes së mjeteve të informimit (si fletëpalosje, broshura, kode sjelljeje, etj.), ngritjes së stendave të informacionit, etj.

Nuk ka itinerare tematike, shtigje edukative, qendra vizitorësh apo pika informacioni në zonën rrethuese të ZMD-së, konkretisht në gadishullin e Karaburunit dhe ishullin e Sazanit. Duke e përmirësuar ofertën gradualisht, vizitorët, por edhe komuniteti vendas do të merrte më shumë njohuri në lidhje me vlerat natyrore dhe kulturore të zonës.

Edukimi i grupeve të interesit për çështje që lidhen me kontributin e tyre për përmirësimin e menaxhimit është gjithashtu një aspekt i rëndësishëm i menaxhimit të ZMD-së. Ky mund të përfshinte trajnimin e policëve në lidhje me llojet e mbrojtura, mësimin e metodave të peshkimit të qëndrueshëm peshkatarëve, trajnimin e komunitetit vendas për cilësinë e ofertës, etj.

Për vlerat e mëposhtme janë hartuar objektiva specifike:

DA Rritja e ndërgjegjësimit

DB Edukimi

Në Tabelën 10 paraqitet një analizë e shpejtë SWOT e temës së ndërgjegjësimit dhe edukimit.

Tabela 8: Analiza SWOT për ndërgjegjësimin dhe edukimin

FUQITË	DOBËSITË
<ul style="list-style-type: none">- Shumë OSHC- Universiteti i Vlorës- Mbështetja e projekteve- Biodiversiteti i pasur dhe vlerat kulturore dhe historike ndihmojnë promovimin dhe edukimin	<ul style="list-style-type: none">- Nuk ka përpjekje për komunikim nga Administrata e Menaxhimit- Burime të pamjaftueshme për fushatat e ndërgjegjësimit- Mungesa e përvojës në promovimin e turizmit natyror
MUNDËSITË	KËRCËNIMET
<ul style="list-style-type: none">- Mbështetja e donatorëve- Kanalet e medias sociale (Facebook, Twitter,...)- Vizitat në shkolla (brenda programit mësimor)- Strategjia e re për zhvillimin e turizmit	<ul style="list-style-type: none">- Mungesa e interesit nga ana e grupeve të interesit (shkollat, agjencitë turistike, operatorët turistikë)- Mungesa e burimeve financiare

TEMA: NDËRGJEGJËSIMI DHE EDUKIMI																
QËLLIMI: Rritja e ndërgjegjësimit dhe përmirësimi i njohurive në drejtim të rëndësisë së ruajtjes së biodiversitetit dhe përdorimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore, si edhe promovimi i vlerave dhe përfitimeve të ZMD-ve.																
VEPRIMTARIA	Nr. Vep.	TREGUESIT E ZBATIMIT			Prio ritet	KUADRI KOHOR I ZBATIMIT (VITI)										PARTNERËT
		AFATSHKURT	AFATMESËM	AFATGJATË		1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	
OBJEKTIVI SPECIFIK: Rritja e ndërgjegjësimit të vizitorëve dhe publikut të gjerë për vlerat e ZMD-së																
TREGUESI I OBJEKTIVIT: Rritja e shkallës së ndërgjegjësimit të të gjitha grupeve të synuara (pyetësorët)																
Rritja e ndërgjegjësimit dhe përhapjes së informacionit për ZMD-të, vlerat dhe statusin e saj për komunitetin vendas dhe turistët (duke përfshirë sasinë e plehrave në plazhe, cilësinë e ujit, zonimin, etj.), nëpërmjet faqeve të internetit dhe mediave	DA1	Shpërndarja e informacionit nëpërmjet mediave	Shpërndarja e informacionit nëpërmjet mediave dhe takimeve vjetore	Shpërndarja e informacionit nëpërmjet mediave dhe takimeve vjetore	1	x	x	x	x	x	x	x	x	x	Operatorët turistikë, OSHC-të, autoritetet vendore	
Përgatitja dhe shpërndarja e instrumenteve të informimit në lidhje me vlerat e ZMD-së, (Posidonia, llojet e mbrojtura, llojet karizmatike), si edhe për kërcënimet (si të bëhet ankorimi i duhur, llojet invazive, etj.)	DA2	Zhvillimi i instrumenteve të informimit mbi vlerat	Zhvillimi i mjeteve të informimit mbi ZMD dhe kërcënimet; Numri/lloji i mjeteve të informimit të shpërndara	Numri dhe lloji i mjeteve të informimit që janë shpërndarë; prezantimi i rezultateve të monitorimit	1	x	x	x	x	x	x	x	x	x	OSHC-të,	
Përgatitja dhe shpërndarja e instrumenteve të informimit të restorantet në lidhje me llojet e kufizuara/mbrojtura (p.sh. midhjet shkëmbshpuese etj.)	DA3	Mjetet e informimit të zhvilluara për restorantet	Numri dhe lloji i mjeteve të informimit të shpërndara	Numri dhe lloji i mjeteve të informimit të shpërndarë	1	x	x	x	x	x	x	x	x	x	Operatorët turistikë, OSHC-të	
Përgatitja dhe shpërndarja e fletëpalosjeve të informimit për rritjen e ndërgjegjësimit të zhytësve (kodi i sjelljes)	DA4	Numri i fletëpalosjeve të informimit të prodhuara	Numri i fletëpalosjeve të informimit të shpërndara	Numri i fletëpalosjeve të informimit të shpërndara	1	x	x	x	x	x	x	x	x	x	Qendrat zhytjes, OSHC-të	
Projektimi, prodhimi dhe ngritja e stendave të informacionit/mirëmbajtja e stendave	DA5		Projektimi dhe ngritja e stendave të informacionit	Mirëmbajtja periodike e stendave	2	x	x								Autoritetet vendore, operatorët turistikë,	

TEMA: NDËRGJEGJËSIMI DHE EDUKIMI																	
QËLLIMI: Rritja e ndërgjegjësimit dhe përmirësimi i njohurive në drejtim të rëndësisë së ruajtjes së biodiversitetit dhe përdorimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore, si edhe promovimi i vlerave dhe përfitimeve të ZMD-ve.																	
VEPRIMTARIA	Nr. Vep.	TREGUESIT E ZBATIMIT			Prio ritet	KUADRI KOHOR I ZBATIMIT (VITI)										PARTNERËT	
		AFATSHKURT	AFATMESEM	AFATGJATË		1	2	3	4	5	6	7	8	9	10		
Projektimi dhe krijimi i shtegut nënujor	DA6		Projektimi dhe krijimi i shtegut nënujor	Mirëmbajtja periodike e shtegut nënujor	3	x	x										Autoritetet vendore, qendrat e zhytjes, OSHC-të
OBJEKTIVI SPECIFIK: Edukimi i grupeve të interesit në lidhje me çështje që kanë të bëjnë me kontributin e tyre në përmirësimin e menaxhimit të ZMD-së																	
TREGUESI I OBJEKTIVIT: Mendimi i të trajnuarve për njohuritë e marra nëpërmjet veprimtarive të edukimit (pyetësorët e vlerësimit)																	
Zhvillimi dhe zbatimi i programeve të edukimit në bashkëpunim me shkollat lokale	DB1		Programet e edukimit	Numri/lloji i veprimtarive të edukimit numri i përdoruesve	2			x	x	x	x	x	x	x	x		Shkollat lokale, OSHC-të operatorët turistikë,
Rritja e ndërgjegjësimit dhe trajnimi i oficerëve të policisë në fushat që lidhen me menaxhimin e ZMD-së	DB2		Takimi i organizuar me oficerët e policisë; numri i oficerëve të policisë së trajnuar	Numri i oficerëve të policisë së trajnuar	2				x	x	x	x	x	x	x		Policia, OSHC-të, autoritetet vendore
Mësimdhënia e metodave të peshkimit të qëndrueshëm peshkatarëve të rinj artizanalë (edukimi i peshkatarëve për përdorimin e pajisjeve)	DB3		Takimi i organizuar me Ministrinë e Bujqësisë; numri i peshkatarëve që u trajnuar	Numri i peshkatarëve që u trajnuar	1		x		x		x		x		x		Peshkatarët, OMP-ja, OSHC-të
Ngritja e kapaciteteve të komunitetit vendas për sigurimin e ofertës cilësore	DB4			Numri i veprimtarive të trajnimit sipas temës dhe numrit të pjesëmarrësve	2								x	x	x	x	Bizneset, operatorët turistikë, OSHC-të

4.2.5 Tema E: Menaxhimi, administrimi dhe qëndrueshmëria

Parku Kombëtar i Ekosistemit Natyror Detar pranë Gadishullit të Karaburunit dhe Ishullit të Sazanit është ZMD-ja e parë në Shqipëri dhe juridiksioni i administratës së parkut ende duhet të zbatohet në terren. Administrata e parkut nuk ka autoritet mbi tokën në zonë, meqë Parku Kombëtar Detar mbulon vetëm zonën detare. Për të pasur menaxhim efektiv, krijimi i Administratës së Menaxhimit dhe punësimi i stafit është veprimtaria e parë dhe më kryesore që duhet ndërmarrë.

Investimi në edukimin e stafit do të mundësonte zbatimin e mirë të Planit të Menaxhimit, si edhe menaxhimin e qëndrueshëm të zonës. Zbatimi i mirë i ligjit, që përfshin mbikëqyrjen nga rojet mjedisore/rangers, është kryesor për ruajtjen dhe monitorimin e një zone të mbrojtur, prandaj edukimi i rojeve mjedisore/ rangers është thelbësor për zbatimin efektiv të ligjit. Duhet të planifikohen kurse të ndryshme trajnimi për stafin e ZM-së, në varësi të arsimimit dhe përvojës së tyre. Gjithashtu, blerja e pajisjeve të duhura, si pajisje zyre, varka, GPS, etj. është thelbësore për zbatimin efektiv të Planit të Menaxhimit.

Komunikimi i mirë dhe bashkëpunimi i Administratës së Menaxhimit më autoritete të ndryshme dhe komunitetin vendas është një parakusht për menaxhimin e mirë. Veprimtaritë në lidhje me këtë mund të përfshijnë takime periodike me grupet lokale të interesit para dhe pas sezonit turistik, krijimi dhe mbështetja e bashkëpunimit me autoritete të ndryshme duke përfshirë policinë, inspektoratet, ushtrinë, autoritetet lokale dhe rajonale, etj.

Për vlerat e mëposhtme janë hartuar objektiva specifike:

EA Administrata e Menaxhimit, ngritja e kapaciteteve dhe pajisjet

EB Komunikimi dhe bashkëpunimi

Në Tabelën 11 paraqitet një analizë e shpejtë SWOT e temës së menaxhimit, administrimit dhe qëndrueshmërisë.

Tabela 9: Analiza SWOT për menaxhimin, administrimin dhe qëndrueshmërinë

FUQITË	DOBËSITË
<ul style="list-style-type: none"> - Përvoja afatgjatë në menaxhimin e ZM-së (Drejtorja e Pyjeve) dhe reputacioni - Infrastruktura ekzistuese (Drejtorja e ZM-së e Shërbimit Pyjor dhe Zyra e Parkut të Llogarasë) - Partneritetet (Projekti për ZMDB-të, UNDP, ËËF, INCA...) 	<ul style="list-style-type: none"> - Mungesa e burimeve njerëzore dhe financiare - Mungesa e pajisjeve - Marrëdhëniet e dobëta me grupet e interesit - Mungesa e njohurive specifike dhe kapaciteteve në lidhje me çështjet detare - Mungesa e juridiksionit të qartë- shumë institucione
MUNDËSITË	KËRCËNIMET
<ul style="list-style-type: none"> - Mbështetja nga donatorët dhe projektet - Rrjetet rajonale – AMD-të mesdhetare - Përmirësimi i kuadrit legjislativ (më mbështetës për ZMD-të) - Turistët/ vizitorët vendas që kërkojnë më shumë diell dhe plazh(potenciali për restorantet lokale, agro-turizmin, turizmin detar, zhytjen) - Krijimi i Agjencisë së Menaxhimit të 	<ul style="list-style-type: none"> - prirjet aktuale të zhvillimit (zhvillim jo i rregulluar me ligj) - strukturë e paqartë institucionale - financimi i pamjaftueshëm - mungesa e stafit cilësor

Bregdetit	
-----------	--

TEMA: MENAXHIMI, ADMINISTRIMI DHE QËNDRUESHMËRIA																
QËLLIMI: Sigurimi i menaxhimit efektiv të ZMD-së nëpërmjet ngritjes së kapaciteteve, sigurimit të burimeve të nevojshme njerëzore dhe financiare, dhe përmirësimi i komunikimit dhe bashkëpunimit me grupet përkatëse të interesit.																
VEPRIMTARIA	Nr. Vep.	TREGUESIT E ZBATIMIT			Prio ritet	KUADRI KOHOR I ZBATIMIT (VITI)										PARTNERËT
		AFATSHKURTË	AFATMESËM	AFATGJATË		1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	
OBJEKTIVI SPECIFIK: Krijimi i Administratës së Menaxhimit, marrja në punë e stafit, rritja e nivelit të njohurive dhe aftësive të tij, dhe pajisja e duhur e stafit në lidhje me gjendjen e ekzistuese në vitin 2014.																
TREGUESI I OBJEKTIVIT: Vështrim i përgjithshëm i trajnimit të ekspertëve/specialistëve dhe lista e pajisjeve																
Krijimi i Administratës së Menaxhimit dhe punësimi i stafit	EA1	Krijimi i Administratës së Menaxhimit dhe marrja në punë e punonjësve të parë	Punonjës të rinj	Punonjës të rinj	1	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	Ministria e Mjedisit
Forcimi i kapaciteteve të Administratës së Menaxhimit nëpërmjet trajnimit të stafit (pjesëmarrja në programin NC (ngritja e kapaciteteve) për ZMD-të)	EA2		Kurset sipas nevojave (numri i pjesëmarrësve, certifikatat, etj.)	Kurset sipas nevojave (numri i pjesëmarrësve, certifikatat, etj.)	1			x	x	x	x	x	x	x	x	Universiteti, OSHC-të
Ndarja e përvojave përmes pjesëmarrjes në seminare, konferenca (ekspertësh dhe shkencore) dhe shoqata kombëtare dhe ndërkombëtare	EA3		Lista e pjesëmarrësve dhe anëtarëve	Lista e pjesëmarrësve dhe anëtarëve	2			x	x	x	x	x	x	x	x	Projektet, shoqatat kombëtare dhe ndërkombëtare
Sigurimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve të nevojshme për performancën cilësore të ekspertëve/specialistëve dhe rojeve mjedisore/rangers	EA4	Inventari i pajisjeve	Inventari i pajisjeve	Inventari i pajisjeve	1	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	Shërbimi i Ruajtjes, Shërbimi i rojeve mjedisore/rangers
OBJEKTIVI SPECIFIK: Përmirësimi i komunikimit dhe bashkëpunimit me banorët vendas dhe autoritetet vendore.																
TREGUESI I OBJEKTIVIT: Mendimi i komunitetit vendas për shkallën e përfshirjes dhe njohjes me punën në ZMD																
Përmirësimi i komunikimit dhe	EB1		Veprimtari	Veprimtari të	1			x	x	x	x	x	x	x	x	Universiteti

TEMA: MENAXHIMI, ADMINISTRIMI DHE QËNDRUESHMËRIA
QËLLIMI: Sigurimi i menaxhimit efektiv të ZMD-së nëpërmjet ngritjes së kapaciteteve, sigurimit të burimeve të nevojshme njerëzore dhe financiare, dhe përmirësimi i komunikimit dhe bashkëpunimit me grupet përkatëse të interesit.

VEPRIMTARIA	Nr. Vep.	TREGUESIT E ZBATIMIT			Prioritet	KUADRI KOHOR I ZBATIMIT (VITI)										PARTNERËT		
		AFATSHKURTË	AFATMESËM	AFATGJATË		1	2	3	4	5	6	7	8	9	10			
bashkërendimit me grupet lokale të interesit me anë të takimeve periodike para dhe pas sezonit turistik (Universiteti i Vlorës, Marina/porti i Orikumit, autoritetet vendore, bizneset, OSHC-të, etj.)			të përbashkët a të dakortësuar a, procesverbale të mbledhjeve lista e pjesëmarrësve	përbashkëta të dakortësuarat procesverbalet e mbledhjeve, lista e pjesëmarrësve														i Vlorës, porti i Orikumit, OMP, OSHC, etj.
Forcimi i bashkëpunimit me administratën në nivel lokal dhe rajonal	EB2	Takime periodike me bashkitë dhe Prefekturën	Takime periodike me bashkitë dhe Prefekturën	Takime periodike me bashkitë dhe Prefekturën	1	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	Qeverisja vendore dhe rajonale, sektori publik
Bashkëpunimi me policinë, inspektoratin e peshkimit dhe ushtrinë për përmirësimin e zbatimit të ligjit	EB3	Takimi i organizuar me policinë dhe inspektoratin e peshkimit, marrëveshja e bashkëpunimit	Procesverbale të mbledhjeve, korrespondenca	Procesverbale të mbledhjeve, korrespondenca	1	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	Policia, Inspektorati i Peshkimit
Përmirësimi i menaxhimit të peshkimit nëpërmjet vendosjes në bashkëpunimit mes bashkisë dhe Organizatës së Menaxhimit të Peshkimit (në zbatimin e kontrollit në zonë)	EB4		Takimi i organizuar me Bashkinë dhe OMP-në	Raportet e takimeve periodike mes Bashkisë dhe OMP-së	3				x	x	x	x	x	x	x	x	x	Autoritetet vendore, OMP-ja, OSHC-të

4.3 Zonat e menaxhimit të Parkut Kombëtar të Ekosistemit Natyror Detar pranë Gadishullit të Karaburunit dhe Ishullit të Sazanit

4.3.1 Përgatitja e planit të zonimit

Zonimi i një territori është qasja/metoda e rregullimit të përdorimit të tokës që konsiston në ndarjen e një territori në zona të treguara në një hartë dhe që ndryshojnë nga lloji dhe intensiteti i përdorimit të tyre sipas objektivave për ruajtjen e biodiversitetit dhe vlerave ekologjike të ekuilibruara me zhvillimin e qëndrueshëm.

Zonimi i detit ndjek një regjim të veçantë mbrojtjeje, që është i ndryshëm nga pjesa tokësore. Në det, zonat krijohen sipas llojit të veprimtarive që zhvillohen, efektit të tyre në sipërfaqen e detit/ kolonën ujore/shtratin e detit/ dhe pajtueshmërisë së tyre me veprimtari të tjera që lejohet të zhvillohen në të njëjtën zonë.

Plani i zonimit për territorin e Parkun Kombëtar të Ekosistemit Natyror Detar pranë Gadishullit të Karaburunit dhe Ishullit të Sazanit ndoqi këto hapa:

- a. Mbledhja e informacionit të plotë të nevojshëm për natyrën, biodiversitetin, përdorimin e zonës, nevojat e komunitetit dhe mjetet e jetesës, etj.
- b. Përgatitja e projekt-planit të zonimit në bashkëpunim me grupet e interesit dhe komunitetet vendase.
- c. Rishikimi i projekt-planit të zonimit, duke përfshirë përshkrimin e zonave dhe rregullimin më të hollësishëm të veprimtarive.
- d. Finalizimi i projekt-planit të zonimit.

Për përgatitjen e propozimit të zonimit, një seminar dy-ditor u organizua në Vlorë, ku grupet e interesit u informuan mbi konceptin e zonimit dhe kuadrin rregullator për zonimin e ZMD-ve dhe gjatë së cilit u përgatit propozimi i përbashkët për zonimin e Parkut Kombëtar Detar. Propozimi u hartua në bazë të elementeve të përgatitura më parë, si qëllimet, objektivat, veprimtaritë e menaxhimit, dhe vlerat dhe kërcënimet/përdorimet.

Duke u mbështetur në “Udhëzime mbi qasjen dhe kriteret për zonimin e territorit brenda një zone të mbrojtur” të përgatitura nga GIZ për Ministrinë e Mjedisit, që u rishikuan pak, grupi propozoi katër zona menaxhimi dhe shtrirjen e tyre në hapësirë. Në secilën prej zonave, u përcaktuan përdorimi i burimeve natyrore dhe veprimtaritë e ndaluara dhe të lejuara. Gjithashtu, u bë lista e veprimtarive që duhet të rregullohen dhe përshkrimi se si do të rregullohen.

Përcaktimi i kufijve i zonave të brendshme mund të jetë i dobishëm për vendosjen e shenjave kufizuese në kufijtë shumë të ndjeshëm të disa zonave të posaçme, për të sqaruar se ku zbatohen rregulloret përkatëse. Mënyra më e mirë dhe e pagabueshme për të bërë të qartë vendndodhjen e zonave të mbrojtura dhe zonave të tyre është përzgjedhja e kufijve natyrorë (apo artificialë- të krijuar nga njeriu) për të shënuar kufijtë e tyre. Kësisoj është e lehtë të shpjegohet se ku ndodhen zonat e mbrojtura dhe zonat e tyre si edhe të dihet vendndodhja e kufijve të tyre në terren. Kufij të tillë tipikë janë kreshtat, luginat, lumenjtë, ndryshimet e papritura natyrore apo artificiale në bimësi dhe/ose strukturat e përdorimit, strukturat e trafikut si rrugët, hekurudha, kanalet, etj.

Një mënyrë tjetër jo e kushtueshme për të siguruar informacion në lidhje me pozicionin e zonave të mbrojtura dhe zonave përkatëse të tyre është ngritja e tabelave të informacionit në vendet publike aty pranë. Këto tabela duhet të paraqesin një hartë të hollësishme të kufirit të jashtëm të zonës së mbrojtur dhe kufijtë e brendshëm të zonave përkatëse. Gjithashtu, këto tabela mund të japin informacion të hollësishëm në lidhje me natyrën e territorit dhe rregulloret për të gjithë zonën e mbrojtur dhe zonat përkatëse të saj.









4.3.2 Zonat e Menaxhimit ⁽¹⁾

Në këtë kuadër, duke pasur parasysh kushtet reale të vendit, kategoritë e menaxhimit dhe përvojat e kaluara dhe duke përdorur praktikatat më të mira ndërkombëtare, sistemi i mëposhtëm i zonimit mund të përdoret.

1. **Zona Qendrore (ZQ)** ku zbatohet niveli i parë i mbrojtjes.
2. **Zona e Menaxhimit Efektiv (ZME)**, ku zbatohet niveli i dytë i mbrojtjes.
3. **Zona e Rekreacionit (ZR)**, ku zbatohet niveli i tretë i mbrojtjes.
4. **Zona e Zhvillimit të Qëndrueshëm (ZZHQ)**, ku zbatohet niveli i tretë i mbrojtjes.

Ky sistem është në përputhje me Udhëzimin për qasjen/metodën dhe kriteret e zonimit të territorit brenda një zone të mbrojtur (GIZ/GOPA 2013), që u përgatit nga GIZ për Ministrinë e Mjedisit. Në tabelën 12 tregohet mbulimi i zonës (sipërfaqja dhe përqindja) dhe shënimi i zonave të ndryshme në hartë.

Tabela 10: Mbulimi i zonës dhe shënimi i zonave të ndryshme në harta

Nr.	Emri i zonës	Akronimi	Sipërfaqja (ha)	Përqindja (%)	Kodi KGJB	Ngjyra	Bardhë dhe zi
1	Zona Qendrore	ZQ	781,2	6,29	I kuq 0 I gjelbër 200 Blu 0		
2	Zona e Menaxhimit Efektiv	ZME	8579,1	69,03	I kuq135 I gjelbër 225 Blu 135		
3	Zona e Rekreacionit	ZR	1926,8	15,50	I kuq 255 I gjelbër 255 Blu 100		
4	Zona e Zhvillimit të Qëndrueshëm	ZZHQ	1140,9	9,18	I kuq 200 I gjelbër 200 Blu 200		

Udhëzimi për qasjen/metodën dhe kriteret e zonimit të territorit brenda një zone të mbrojtur (GIZ/GOPA 2013) propozon edhe një zonë shtesë- Zonën e Përdorimit Tradicional (ZPT), por u ra dakord që ZPT-ja është e ngjashme me ZZHQ-në dhe është më e rëndësishme për zonat e mbrojtura tokësore. Kësisoj, ZPT-ja u bashkua me ZZHQ-në.

Koment: (1). Ky zonim hyn në fuqi pas amendimit të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 289, datë 28.04.2010 "Për shpalljen "Park Kombëtar" të ekosistemit natyror detar pranë Gadishullit të Karaburunit dhe Ishullit të Sazanit". Bazuar në Ligjin nr. 8906 datë 06.06.2002 "Për zonat e mbrojtura" i ndryshuar, pika 3 e nenit 4/2, zonimi i territorit të zonës së mbrojtur miratohet me Vendim të Këshillit të Ministrave.

4.3.2.1 Zona Qendrore (ZQ)

Kjo përfshin zonat me performancë shumë të lartë natyrore, me pak ose aspak ndërhyrje nga veprimtaritë njerëzore si: 1) zona rreth ishullit të Sazanit jo më larg se 1 km nga bregu; 2) pjesa perëndimore e Karaburunit deri 200 metra larg bregut.

Në pjesën veriore, perëndimore dhe jugore (deri te Kepi Jugor) të ishullit të Sazanit ka shkëmbinj nënujorë dhe formacione koralogjene shumë të rëndësishme. Ka gjithashtu shkëmbinj nënujorë interesantë në pjesën lindore të ishullit ngjitur me Kepin e Shënkollit. Bregdeti jugor i ishullit mbulohet me livadhe të Posidonia-s. Pjesa perëndimore e Karaburunit është gjithashtu e pasur në formacione koralogjene dhe veçori interesante nënujore gjeomorfologjike, shkëmbinj nënujorë dhe shkëmbinj.

Prioritet këtu është ruajtja e natyrës, biodiversitetit (livadhet e Posidonia-s, formacionet koralogjene), monumentet natyrore (Falëzat e Sazani), llojet e rrezikuara (koralin e kuq, shkëmbshpuesi, kerr/rufjo, ylli i detit, delfini i zakonshëm, breshka e ujit/breshka e detit, etj.), peizazhe unike tokësore dhe detare (shkëmbinj nënujorë dhe shkëmbinj), veçori të jashtëzakonshme natyrore gjeomorfologjike dhe paleontologjike pa ndonjë ndërhyrje mbështetëse të përhershme. Këto zona menaxhohen në mënyrë të tillë që të ruhet statusi i tyre natyral, të mbahet evolucioni dinamik i burimeve gjenetike dhe ato përdoren vetëm për studime shkencore. Kjo zonë përfiton nga natyra strikte e mbrojtjes. Zona mbështet studimet dhe kërkimet shkencore; monitorimi i nivelit të ulët lejohet me leje të posaçme; dhe vizitat, n.q.s. ka, rregullohen në mënyrë shumë rigoroze.

Normalisht, kontaktet me publikun janë të kufizuara dhe veprimtaritë socio-ekonomike dhe argëtuese/rekreacionale janë plotësisht të ndaluara. Lejohen proceset natyrore me ndërhyrje minimale nga ana e menaxhimit dhe nuk ka zhvillim të infrastrukturës. Në zonë nuk duhet të ketë shqetësime/ndërhyrje nga ndonjë veprimtari socio-ekonomike, stërvitje ushtarake, ndotja dhe shkarkimet nga anijet, apo hedhja e materialeve të ndryshme (metale, qelqi, etj.) dhe mbetjet që mbeten në shtratin e detit.

Vizitat ditore janë rreptësisht të kufizuara në numër dhe vendet që vizitohen. Për këtë nevojiten leje të posaçme nga administrata e ZM-së. Vizitat me udhërrëfyes lejohen vetëm në itinerare të caktuara me shumë pak ndikim mbi një pjesë të vogël të zonës që mbulon maksimalisht 10% të saj, nën drejtimin e administratës së PS-së në një nivel që i shërben mirëqenies fizike dhe shpirtërore dhe ruan cilësitë e natyrës së egër së zonës për brezat e sotëm dhe të ardhshëm.

Në këtë zonë zbatohet niveli i parë i mbrojtjes. Zbatimi i ligjit sigurohet nga administrata e ZM-së me anë të patrullimit dhe vënies në zbatim të rregullave dhe qasjeve rreptësisht të përcaktuara.

Veprimtaritë e lejuara: Asnjë veprimtari nuk duhet të zhvillohet brenda Zonës Qendrore me përjashtim të veprimtarive të rregulluara të renditura më poshtë.

Veprimtaritë që nuk lejohen: Zhvillimi i veprimtarive të mëposhtme është rreptësisht i ndaluar brenda Zonës Qendrore: zhytja, noti dhe zhytja me tub ajrimi/snorkelling (plazhet dhe banjat e diellit), peshkimi, shëtitjet me varkë(ekskursionet), hedhja e spirancës, ankorimi, lundrimi, lundrimi me kajak/kaikë, të gjitha llojet e sporteve ujore, trafiku detar, të gjitha llojet

e zhvillimit të infrastrukturës, nxjerrja e mineraleve, mbledhja e bimëve, mineraleve, gurëve, gjetjeve paleontologjike, zhvillimi i akuakulturës dhe të gjitha veprimtaritë ushtarake.

Veprimtaritë e rregulluara: Veprimtaritë e mëposhtme mund të zhvillohen pas dhënies së një lejeje të posaçme nga administrata e ZM-së: kërkimi shkencor (leje e posaçme dhe numri i shkencëtarëve që lejohen është i kufizuar) dhe monitorimi (nevojitet leje e posaçme), largimi i mbetjeve, vetëm vizita me udhërrëfyes në itineraret e përcaktuara nën udhëheqjen e administratës së ZM-së (rreptësisht të kufizuara në drejtim të numrit dhe vendeve), zhytja lejohet vetëm për qëllime kërkimi dhe monitorimi shkencor.

4.3.2.2 Zona e Menaxhimit Efektiv (ZME)

Kjo përfshin zonat me performancë të lartë natyrore me habitate natyrore shumë të rëndësishme apo biotope të llojeve të rralla dhe rrezikuara. Prioritet është ruajtja e biodiversitetit, zonave natyrore dhe peizazheve me rëndësi kombëtare dhe ndërkombëtare për qëllime shpirtërore, shkencore, edukative/arsimore dhe integrimi i menaxhimit të zonës së mbrojtur me përdorimin e qëndrueshëm dhe të ekuilibruar.

Zona përfshin: 1) zonën rreth ishullit të Sazanit që nuk përfshihet në Zonën Qendrore; 2) zonën rreth gadishullit të Sazanit nga Kepi i Shën Vasilit deri në kufirin jugor të parkut që nuk është përfshirë në zonat e tjera.

Kjo zonë karakterizohet nga vlera të ekosistemeve, peizazhit dhe vlera të tjera natyrore ku mund të zhvillohen veprimtaritë që nuk bien ndesh me qëllimin e mbrojtjes dhe objektivat e menaxhimit. Vetëm ekoturizmi mjedisor edukativ lejohet në bazë të rregullave të qarta dhe duhet të ketë kufizime për zonat dhe shtigjet e lejuara. Lejohen proceset natyrore me ndërhyrje minimale nga ana e menaxhimit dhe nuk ka zhvillim infrastrukture. Në zonë nuk duhet të ketë shqetësime/ ndërhyrje nga veprimtaritë socio-ekonomike, stërvitjet ushtarake, ndotja dhe shkarkimet nga anijet, apo hedhja e materialeve të ndryshme (metale, qelqi, etj.) dhe mbetjet që mbeten në shtratin e detit.

Zona mbështet studimet dhe kërkimet shkencore si edhe monitorimin e statusit të biodiversitetit dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore detare.

Në këtë zonë lejohen disa veprimtari argëtuese, si lundrimi, lundrimi me kajak/ kaike dhe sporte të tjera uji jomotorike, por sportet masive nuk lejohen. Zhytja lejohet brenda pikave të caktuara të zhytjes në kepin e Pulëbardhës dhe kepin e Jugut, ku ndodhen disa rrënoja anijesh të mbytura. Suditja e balenave, delfinëve, breshkave detare etj. lejohet po ashtu përgjatë vendeve dhe itinerareve të caktuara, por me disa kufizime (kodi i sjelljes: nuk lejohet të notosh me kafshët dhe t'i ushqesh ato; kafshëve nuk duhet t'u afroresh nga përpara por nga prapa; varkat duhet t'u afrohen ngadalë kafshëve dhe të lundrojnë paralelisht me to, motori duhet të fiket; nuk duhet t'u afroresh kafshëve më shumë se 50 m- atyre u duhet lënë hapësirë e mjaftueshme; koha maksimale për të qëndruar me to është 30 minuta).

Në këtë zonë zbatohet niveli i dytë i mbrojtjes. Zbatimi i ligjit sigurohet nga administrata e ZM-së me anë të patrullimit dhe vënies në zbatim të rregullave dhe qasjeve rreptësisht të përcaktuara.

Veprimtaritë e lejuara: Asnjë veprimtari nuk lejohet brenda Zonës së Menaxhimit Efektiv me përjashtim të veprimtarive të rregulluara që renditen më poshtë.

Veprimtaritë që nuk lejohen: Zhvillimi i veprimtarive të mëposhtme është rreptësisht i ndaluar brenda Zonës së Menaxhimit Efektiv: zhytja, noti dhe zhytja me tub ajrimi/snorkelling (plazhet dhe banjat e diellit), peshkimi, hedhja e spirancës, trafiku detar, të gjitha llojet e zhvillimit të infrastrukturës, nxjerrja e mineraleve, mbledhja e bimëve, mineraleve, gurëve, gjetjeve paleontologjike, zhvillimi i akuakulturës dhe të gjitha veprimtaritë ushtarake.

Veprimtaritë e rregulluara: Veprimtaritë e mëposhtme mund të zhvillohen pas dhënies së një lejeje të posaçme nga administrata e ZM-së: kërkimi shkencor (leje e posaçme dhe numri i shkencëtarëve që lejohen është i kufizuar) dhe monitorimi (nevojitet leje e posaçme), largimi i mbetjeve, zhytja (pikat e zhytjes duhet të specifikohen dhe zhytja lejohet vetëm në ato vende të caktuara, vetëm vizita me udhërrëfyes, numër i kufizuar zhytësish, monitorimi nga administrata e ZM-së), ekskursionet me varka (ekskursionet me varkë të kufizuara dhe me udhërrëfyes, leje e posaçme për varkat, koha dhe akseset në zonë duhet të përcaktohet nga administrata e ZM-së), lundrimi dhe ankorimi (disa zona duhet të jenë jashtë kufijve- këto janë pikat e zhytjes dhe zonat e caktuara për sporte uji; duhen vendosur shenjat për varkat), lundrimi me kajak/kaikë, sportet e ujit (nuk lejohet përdorimi i skive të ujit dhe sporte të tjera motorike uji; ndarje e qartë e zonave të sporteve të ujit dhe zonave të notimit), vizitat (vizita me udhërrëfyes, të kufizuara në numër), soditja e kafshëve/shpendëve të egër (duke respektuar kodin e sjelljes).

4.3.2.3 Zona e Rekreacionit (ZR)

Kjo zonë ka një performancë të mirë natyrore. Ajo përkufizohet si një zonë që përmban territore të përshtatshme tokësore, ujore dhe detare ku kombinimi i veprimtarive, produktet tradicionale të komunitetit, bizneset dhe turizmi janë në përputhje me standardet e ruajtjes së natyrës dhe biodiversitetit. Ajo përfshin: 1) zonën nga kepi i Shën Janit tek kepi i Gallovecit; 2) nga kepi i Gjuhëzës te Moli i Jugut dhe në jug deri te zona qendrore; 3) nga gjiri i Bristanit te Shpella e Duk Gjonit, dhe 4) nga plazhi i Llovizit te gjiri i Gramës deri në jug te gjiri i Shën Andreas.

Kjo zonë duhet të mundësojë kënaqjen e publikut nëpërmjet turizmit dhe veprimtarive argëtuese në përputhje me karakterin dhe madhësinë e karakteristikave kryesore të zonës, duke promovuar veprimtari shkencore dhe edukative/mësimore që do të ndihmojnë zhvillimin afatgjatë dhe mirëqenien e vendasve dhe do të ofrojë mbështetjen e publikut të gjerë për ruajtjen e natyrës. Zona ka potencial të madh për edukim, argëtim në botën e egër, sporte dhe facilitete që respektojnë funksionet dhe vlerat ekologjike të zonës së mbrojtur.

Brenda parkut janë 4 shpella (shpella e Haxhi Aliut ngjitur me Molin e Veriut; shpella e Duk Gjonit 2 km nga gjiri i Bristanit; shpella e Ujit dhe shpella e Inglizit rreth 1 km në veri të gjirit të Inglizit). Në zonën nënujore ndërmjet kepit të Gallovecit dhe kepit të Gjuhëzës veçanërisht ngjitur me Molin e Veriut ndodhen rrënojat e 5 anijeve të mbytura. Një anije tjetër e mbytur është afër gjirit të Bristanit. Zona ka shumë vlera historike dhe kulturore.

Ka disa pika zhytjeje të identifikuara në këtë zonë: 1) pika e zhytjes te Moli i Veriut afër shpellës së Haxhi Aliut, 2) pika e zhytjes mes kepit të Gjuhëzës dhe Molit të Jugut; 3) pika e zhytjes në gjirin e Bristanit afër shpellës së Ujit; 4) pika e zhytjes në gjirin e Inglizit; dhe 5) pika e zhytjes në gjirin e Shën Andreas në cepin jugor të parkut. Kjo zonë përfshin një pikë vëzhgimi për balenat, delfinët dhe breshkat detare rreth 4 km në jug të kepit të Gjuhëzës. Soditja e këtyre kafshëve lejohet me disa kufizime (kodi i sjelljes: nuk lejohet të notosh me kafshët dhe

t'i ushqesh ato; kafshëve nuk duhet t'u afroresh nga përpara por nga prapa; varkat duhet t'u afrohen ngadalë kafshëve dhe të lundrojnë paralelisht me to, motori duhet të fiket; nuk duhet t'u afroresh kafshëve më shumë se 50 m- atyre u duhet lënë hapësirë e mjaftueshme; koha maksimale për të qëndruar me to është 30 minuta).

Gjithashtu kjo zonë përfshin disa plazhe të vogla si: kepi i Shën Vasilit, kepi i Shën Janit, gjiri i Bristanit (3 km në veri të gjirit), gjiri i Llovizit dhe gjiri i Gramës. Pranë kepit të Shën Vasilit dhe kepit të Shën Janit ka disa doke/skela të vogla dhe shërbime të biznesit turistik që mund të përdoren për të ankoruar dhe për t'u shërbyer varkave të vogla me vizitorë. Brenda kësaj zone ka disa shpella (gjiri i Gramës) dhe vende të tjera kulturore dhe historike me interes të madh për vizitorët. Në gjirin e Gramës ka disa mbetje arkeologjike të rëndësishme. Vende të tjera të mundshme për ankorim janë caktuar në kepin e Shën Vasilit, Molin e Veriut, kepin e Gjuhëzës dhe gjirin e Bristanit si edhe në disa plazhe të vogla.

Sa u takon sporteve të tjera, duhet të ketë një ndarje të qartë të zonave për sportet e ujit dhe zonat për të notuar. Gjithashtu, skitë e ujit nuk lejohen në asnjë pjesë të ZMD-së. Sporte të tjera motorike të ujit dhe sporte të tjera të ujit lejohen në Zonën e Rekreacionit.

Në këtë zonë zbatohet niveli i tretë i mbrojtjes. Zbatimi i ligjit mundësohet nëpërmjet bashkëpunimit me autoritetet vendore nga ana e administratës së ZM-së për patrullimin dhe vënien në zbatim të rregullave dhe qasjeve rreptësisht të përcaktuara.

Veprimtaritë e lejuara: Veprimtaritë e mëposhtme mund të zhvillohen lirisht në këtë zonë pa ndonjë autorizim paraprak: lundrimi (disa zona duhet të jenë jashtë kufijve, si pikat e zhytjes; duhet të vendosen shenjat për varkat, nuk lejohen shkarkimet e mbetjeve, administrata e ZM-së duhet të përcaktojë kapacitetin mbajtës të varkave, noti dhe zhytja me tub ajrimi/snorkelling, hedhja e spirancës, ankorimi, lundrimi me kajak/kaikë, sportet e ujit (por jo skitë e ujit sepse ato nuk lejohen në këtë zonë) dhe vizitat.

Veprimtaritë që nuk lejohen: Zhvillimi i veprimtarive të mëposhtme është rreptësisht i ndaluar brenda Zonës së Rekreacionit: trafiku detar, nxjerrja e mineraleve, dhe mbledhja e bimëve, mineraleve, gurëve, gjetjeve paleontologjike, zhvillimi i akuakulturës dhe të gjitha veprimtaritë ushtarake.

Veprimtaritë e rregulluara: Veprimtaritë e mëposhtme mund të zhvillohen pas dhënies së një lejeje të posaçme nga administrata e ZM-së: kërkimi shkencor dhe monitorimi, zhytja (pikat e zhytjes duhet të specifikohen dhe zhytja lejohet vetëm vendet e caktuara, vetëm vizita me udhërrëfyes, numër i kufizuar zhytësish, monitorimi nga administrata e ZM-së), peshkimi (lejohet vetëm peshkimi sportiv (me grepa) dhe peshkimi tradicional, leja e posaçme për peshkim duhet të miratohet nga administrata e ZM-së, nuk lejohet peshkimi tregtar) ekskursionet me varka (ekskursionet me varka të kufizuara dhe me udhërrëfyes, leje e posaçme për varkat, koha dhe aksesit në zonë duhet të përcaktohet nga administrata e ZM-së, soditja e kafshëve/shpendëve të egër (duke respektuar kodin e sjelljes), zhvillimi i infrastrukturës (zhvillimi i infrastrukturës duhet të bëhet në përputhje me Planetin e Zhvillimit dhe Planin e Menaxhimit, nuk lejohen ndërtesat e përhershme, lejohet vetëm infrastruktura e "lehtë", si doke/skela (për 2-3 varka), platforma (duke përdorur materiale ndërtimi miqësore ndaj mjedisit), nuk lejohet infrastruktura e sporteve masive dhe e turizmit masiv.

4.3.2.4 Zona e Zhvillimit të Qëndrueshëm (ZZHQ)

Zona ka një performancë natyrore të kënaqshme. Ajo përfshin zonën e parkut nga Kepi i Shën Vasilit te Kepi i Gjuhëzës. Përparësi ka harmonizimi i mbrojtjes së biodiversitetit, natyrës dhe peizazhit nëpërmjet bashkërendimit të menaxhimit të zonës së mbrojtur me zhvillimin e qëndrueshëm social-ekonomik.

Kjo zonë duhet të mundësojë ndërveprimin e harmonizuar të natyrës dhe kulturës nëpërmjet ruajtjes së cilësisë së peizazhit, përdorimit tradicional të vazhdueshëm të burimeve, manifestimin e zakoneve tradicionale, sociale dhe kulturore, dhe shmangien dhe parandalimin ku është e nevojshme e zhvillimit të veprimtarive të papërshtatshme në madhësi dhe/ose përmbajtje.

Ndërmjet qëllimeve kryesore të kësaj zone është gjithashtu sigurimi i përfitimeve ekonomike dhe kontributi në përmirësimin e jetesës së vendasve duke përdorur mallrat natyrore, shërbimet apo përfitimet që vijnë nga format e përshtatshme të turizmit. Nëpërmjet përdorimit afatgjatë të ekuilibruar dhe të qëndrueshëm, zona do t'u japë një mundësi vendasve që jetojnë brenda zonës së mbrojtur të kenë përfitime ekonomike që nuk bien ndesh me objektivat e tjera të menaxhimit. Pra, zona mbështet mënyrën e jetesës dhe veprimtaritë ekonomike që janë në harmoni me natyrën dhe ruajtjen e identitetit shpirtëror dhe kulturor të vendasve.

Kjo zonë duhet të kontribuojë në zhvillimin rajonal dhe kombëtar, të promovojë praktikën e menaxhimit që synojnë prodhimin e qëndrueshëm dhe mbrojtjen e burimeve natyrore bazë nga lloje të tjera të përdorimit të tokës që mund të jenë të dëmshme për biodiversitetin e zonës. Zhvillimi urban i objekteve të ndryshme apo infrastrukturës për nevojat e banorëve dhe bizneseve vendase bëhet në përputhje me Planin e Menaxhimit dhe Planet e Zhvillimit të miratuara nga Këshilli Kombëtar Territorial.

Së bashku me zhvillimin socio-ekonomik, zona duhet mirëmbajë dhe të ruajë kushtet e nevojshme të habitateve për mbrojtjen e llojeve, grupeve të llojeve, komunitetet biotike apo veçoritë fizike të mjedisit që kërkojnë ndërhyrje të veçantë nga dora e njeriut për një menaxhim efektiv. Po ashtu, ajo duhet të eliminojë atje ku është e nevojshme dhe të shmangë përdorimin apo zënien e territorit me veprimtari që bien ndesh me qëllimin për të cilin mbrohet zona.

Përveç kësaj, zona duhet të mundësojë kënaqësinë e publikut nëpërmjet veprimtarive të turizmit dhe atyre argëtuese në përputhje me karakterin dhe madhësinë e veçorive themelore të zonës duke promovuar veprimtari shkencore dhe edukative që do të ndihmojnë zhvillimin afatgjatë dhe mirëqenien e vendasve dhe do të sigurojë mbështetjen e publikut të gjerë për ruajtjen e natyrës.

Në këtë zonë zbatohet niveli i tretë i mbrojtjes. Zbatimi i ligjit mundësohet nëpërmjet bashkëpunimit me autoritetet vendore nga ana e administratës së ZM-së për patrullimin dhe vënien në zbatim të rregullave dhe qasjeve të përcaktuara.

Veprimtaritë e lejuara: Veprimtaritë e mëposhtme mund të zhvillohen lirisht në këtë zonë pa ndonjë autorizim paraprak: lundrimi (disa zona duhet të jenë jashtë kufijve, si zonat e caktuara për sportet e ujit; duhet të vendosen shenjat për varkat, nuk lejohen shkarkimet e mbetjeve,

administrata e ZM-së duhet të përcaktojë kapacitetin mbajtjes të varkave), noti dhe zhytja me tub ajrimi/snorkelling, hedhja e spirancës, ankorimi, lundrimi me kajak/kaike dhe vizitat.

Veprimtaritë që nuk lejohen: Zhvillimi i veprimtarive të mëposhtme është rreptësisht i ndaluar brenda Zonës së Zhvillimit të Qëndrueshëm: trafiku detar, nxjerrja e mineraleve, dhe mbledhja e bimëve, mineraleve, gurëve, gjetjeve paleontologjike, zhvillimi i akuakulturës dhe të gjitha veprimtaritë ushtarake.

Veprimtaritë e rregulluara: Veprimtaritë e mëposhtme mund të zhvillohen pas dhënies së një lejeje të posaçme nga administrata e ZM-së: kërkimi shkencor dhe monitorimi , zhytja (pikat e zhytjes duhet të specifikohen dhe zhytja lejohet vetëm vendet e caktuara, vetëm vizita me udhërrëfyes, numër i kufizuar zhytësish, monitorimi nga administrata e ZM-së), peshkimi (lejohet vetëm peshkimi sportiv (me grepa) dhe peshkimi tradicional, leja e posaçme për peshkim duhet të miratohet nga administrata e ZM-së, nuk lejohet peshkimi tregtar) ekskursione me varka (ekskursione me varka të kufizuara dhe me udhërrëfyes, leje e posaçme për varkat, koha dhe aksesit në zonë duhet të përcaktohet nga administrata e ZM-së), sportet e ujit (nuk lejohet përdorimi i skive të ujit; ndarje e qartë e zonave për sportet e ujit dhe zonave për notim), soditja e kafshëve/shpendëve të egër (duke respektuar kodin e sjelljes), zhvillimi i infrastrukturës (zhvillimi i infrastrukturës duhet të bëhet në përputhje me Planet e Zhvillimit dhe Planin e Menaxhimit, nuk lejohen ndërtesat e përhershme, lejohet vetëm infrastruktura e “lehtë”, si doke/skela (për 2-3 varka), platforma (duke përdorur materiale ndërtimi miqësore ndaj mjedisit), nuk lejohet infrastruktura e sporteve masive dhe e turizmit masiv.

4.3.2.5 Harta e zonave dhe rregullimi i veprimtarive

Harta e zonimit të Parkut Kombëtar të Ekosistemit Natyror Detar pranë Gadishullit të Karaburunit dhe Ishullit të Sazanit tregohet në Figurën 12. Një hartë e përbashkët e vlerave, kërcënimeve dhe zonave të Parkut Kombëtar Detar jepet në Shtojcën 5. Rregullimi i veprimtarive në secilën zonë paraqitet në Tabelën 13.

Tabela 11: Zonat dhe rregullimi i veprimtarive

Legjenda: Y – E lejuar; N – E ndaluar; R – E rregulluar

Veprimtaria	ZQ	ZME	ZR	ZZH Q	Rregullimi i veprimtarive
Kërkimi shkencor	R	R	R	R	Leje e posaçme nga administrata e ZM-së për të gjitha zonat. Në ZQ dhe ZME- leje të posaçme dhe lejohet një numër i kufizuar shkencëtarësh.
Monitorimi	R	R	R	R	Leje e posaçme nga administrata e ZM-së për të gjitha zonat . Në ZQ- leje e posaçme dhe lejohet monitorim i kufizuar.
Zhytja	N	R	R	R	Vendet/pikat e zhytjes duhet të specifikohen dhe zhytja lejohet vetëm në ato vende të caktuara. Zhytja lejohet vetëm me udhërrëfyes. Numër i kufizuar zhytësish. Monitorimi i veprimtarive të zhytjes nga administrata e ZM-së. Lejohet bërja e fotografive dhe filmimi i videove.
Notimi dhe zhytje me tub ajrimi (plazhe dhe banja dielli)	N	N	Y	Y	Lejohet bërja e fotografive dhe filmimi i videove.

Veprimtaria	ZQ	ZME	ZR	ZZH Q	Rregullimi i veprimtarive
Bërja e vizitave	R	R	Y	Y	Në ZQ – vizitë turistike me udhërrëfyes në itinerarin e caktuar vetëm nën drejtimin e administratës së ZM-së; rreptësisht të kufizuara në numër dhe vende. Në ZME- vizitë turistike me udhërrëfyes, të kufizuara në numër.
Soditja e kafshëve të egra	N	R	R	R	Duhet të respektohet kodi i sjelljes për soditjen e kafshëve të egra.
Peshkimi	N	N	R	R	Leje e posaçme për peshkim (Ligji për Peshkimin). Vetëm sportet dhe peshkimi tradicional lejohet, peshkimi komercial nuk lejohet.
Shëtitje me varkë (ekskursione)	N	R	R	R	Leje e posaçme nga administrata e ZM-së për varkat që kanë të drejtë hyrjeje/akses në zonë. Ekskursione të kufizuara dhe me udhërrëfyes me varkë- koha dhe akses në zonë duhet të përcaktohen; duhet të përcaktohet kapaciteti mbajtës i varkave.
Hedhja e spirancës(anchoring)	N	N	Y	Y	Derisa të bëhet vlerësimi i sistemit të ankorimit dhe, nëse është e nevojshme derisa të instalohet sistemi i ankorimit, hedhja e spirancës (anchoring) lejohet në ZR dhe ZZHQ.
Ankorimi (mooring)	N	R	Y	Y	Vend-ankorime, skela/doke të vogla dhe platforma- vetëm konstruksione "të lehta". Të gjitha vend-ankorimet duhet të kenë një imazh miqësor ndaj mjedisit.
Lundrimi	N	R	Y	Y	Leje e posaçme nga administrata e ZM-së për varkat. Në ZME- disa zona duhet të jenë jashtë kufijve (si vendet e zhytjes), duhen vendosur shenjat për varkat. Duhet të përcaktohet kapaciteti mbajtës i varkave.
Lundrimi me kajak/kaike	N	R	Y	Y	Leje e posaçme nga administrata e ZM-së.
Sportet e ujit	N	R	Y	R	Nuk lejohet përdorimi i skive të ujit në asnjë zonë. Sportet e tjera motorike të ujit lejohen vetëm në ZR. Në ZME dhe ZZHQ– vetëm sporte uji jomotorike. Ndarje e qartë e zonave të sporteve të ujit dhe zonave të notimit.
Zhvillimi i infrastrukturës	N	N	R	R	Zhvillimi i infrastrukturës duhet të jetë në përputhje me Planet e Zhvillimit dhe Planin e Menaxhimit. Nuk lejohen ndërtesa të përhershme, vetëm infrastrukturë "e lehtë" (vend-ankorime, doke/skela të vogla, platforma).
Trafiku detar	N	N	N	N	1 milje detare larg sipas ligjit
Nxjerrja e mineraleve	N	N	N	N	
Mbledhja e bimëve, mineraleve, gurëve, gjetjeve paleontologjike	N	N	N	N	
Akuakultura	N	N	N	N	
Veprimtaritë ushtarake	N	N	N	N	



Figura 10: Harta e zonimit të Parkut Kombëtar të Ekosistemit Natyror Detar pranë Gadishullit të Karaburunit dhe Ishullit të Sazanit

5 PLANI FINANCIAR

Burimet financiare për operacionet në Parkun Kombëtar Detar sigurohen nga Buxheti i shtetit, vetëfinancimi nga të ardhura të ndryshme (p.sh. biletat e hyrjes, lejet, shërbimet profesionale të menaxhimit, shitja e suvenireve), donacionet dhe sponsorizimet nga kompani të ndryshme, si edhe pjesëmarrja në projekte në kuadrin e programeve kombëtare apo ndërkombëtare bashkëfinancuese. Komiteti i Menaxhimit do të sigurojë fondet për zbatimin e Planit të Menaxhimit nga burimet e mëposhtme të financimit:

- Buxheti i Shtetit
- Vetëfinancimi
- Asistenca nga organizatat ndërkombëtare
- Donacionet dhe sponsorizimet

Totali i fondeve të parashikuara të nevojshme për zbatimin e Planit të Menaxhimit për PKD “Karaburun-Sazan” për periudhën 10 vjeçare është **678.000 Euro**, duke përfshirë burimet njerëzore dhe veprimtaritë e menaxhimit (Tabela 16). Është llogaritur që **498.000 Euro** nevojiten për zbatimin e veprimtarive të Planit të Menaxhimit në 10 vjet (mesatarisht 49.800 Euro në vit). Financimi i burimeve njerëzore u përlogarit për një staf prej 6 personash gjithsej dhe shkon në **180.000 Euro** për 10 vjet. Kostot operative nuk janë përlogaritur, meqë pritet që stafi i ZM-së do të punësohet në zyrën rajonale.

Kostoja e veprimtarive të menaxhimit sipas temave paraqitet të Tabelën 14, sipas prioriteteve në Tabelën 15, dhe sipas qasjeve të menaxhimit në Tabelën 16.

Tabela 12: Kostoja e veprimtarive të menaxhimit sipas temave

TEMA E MENAXHIMIT	KOSTOJA(EURO)	%
Ruajtja e biodiversitetit	163.000	33%
Trashëgimia kulturore dhe peizazhi	22.000	4%
Mbështetja e komuniteteve vendase dhe përdorimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore	210.000	42%
Ndërgjegjësimi dhe edukimi	62.000	13%
Menaxhimi, administrimi dhe qëndrueshmëria	41.000	8%
TOTALI	498.000	100%

Tabela 13: Kostot e veprimtarive të menaxhimit sipas prioriteteve

PRIORITETI	KOSTOJA (EURO)	Përqindja
Prioriteti 1	185.000	37%
Prioriteti 2	215.000	43%
Prioriteti 3	98.000	20%
TOTALI	498.000	100%

Tabela 14: Kostot e veprimtarive të menaxhimit sipas qasjeve të menaxhimit

QASJA E MENAXHIMIT	KOSTOJA (EURO)	%
Kërkimi	91.000	18%
Monitorimi	134.000	27%
Edukimi	41.000	8%
Informimi	9.000	3%
Rregullimi	18.000	4%
Promovimi	75.000	15%
Bashkëpunimi	48.000	10%
Infrastruktura	72.000	15%
TOTALI	498.000	100%

Në Tabelën 17 tregohet ndarja e zërave të buxhetit sipas veprimtarive për zbatimin e veprimtarive të menaxhimit gjatë 10 viteve.

Tabela 15: Burimet financiare për veprimtaritë e menaxhimit (10 vjet)

Nr. vep.	VEPRIMTARITË	BURIMI I FINANCIMIT	SHPENZIMET E ZBATIMIT (EURO)	SHËNIME SHPJEGUESE
RUAJTJA E BIODIVERSITETIT				
AA1	Hartëzimi i habitateve dhe pastaj monitorimi i statusit të Posidonias	Buxheti i jashtëm-hartëzimi/Buxheti i Shtetit- monitorimi	30.000	24.000 punë në terren 6.000 hartimi i metodologjisë, bashkërendimi i punës në terren dhe analiza e të dhënave
AA2	Rregullimi dhe monitorimi i numrit të varkave në ZMD	Buxheti i Shtetit	0	10% Shërbimi i Rojeve Mjedisore/Rangers
AA3	Rregullimi dhe monitorimi i intensitetit të akuakulturës; kërkimet për ndikimin e akuakulturës dhe monitorimi i tij	Buxheti i jashtëm	24.000	Dy vitet e para- kërkime; monitorim vjetor-20 ditë në vit = 3.000 EURO në vit
AA4	Ndërtimi i bovave ankoruese: vlerësimi, projektimi dhe shpërndarja	Buxheti i jashtëm (projekt, biznes)	15.000	Në varësi të nevojave, duke pasur parasysh doket/skelat; kostoja është për analizën dhe krijimin e sistemit; gjithashtu, çdo bovë kushton afërsisht 700 EURO
AA5	Vlerësimi i statusit, dhe riparimi dhe mirëmbajtja e 2-3 dokeve ekzistues	Buxheti i jashtëm (projekt, biznes)	10.000	10.000 EUR – vlerësimi, riparimi dhe mirëmbajtja e dokeve/skelave
AB1	Hartëzimi i habitateve dhe më pas monitorimi i statusit të koralogjeneve	Buxheti i jashtëm-hartëzimi/Buxheti i Shtetit- monitorimi	45.000	Metodologjia, 2 vite hartëzimi, çdo 3 vjet monitorim
AB2	Kryerja e kërkimeve për shpërndarjen, përbërjen dhe cenueshmërinë e habitateve detare	Buxheti i Shtetit dhe Buxheti i Jashtëm	20.000	Në varësi të prioriteteve dhe disponueshmërisë së kërkuesve, bërja e kërkimeve (rreth 4.000 EURO në vit)
AC1	Bashkëpunimi mes peshkatarëve dhe ushtarakëve për monitorimin (vëzhgimin) e llojeve karizmatike (vertebrorëve të mëdhenj detarë - (breshkave të ujit/detare, fokave mesdhetare, delfinëve dhe balenave)	Buxheti i Shtetit	0	5% Shërbimi i Rojeve Mjedisore/Rangers
AC2	Zhvillimi dhe zbatimi i kodit të sjelljes për soditjen e kafshëve të egra në bashkëpunim me operatorët turistike	Buxheti i Shtetit dhe Buxheti i Jashtëm	3.000	Hartimi i kodit në vitin e parë- 1.000 EURO; mjetet e informimit - 2.000 EURO (duke përfshirë riprintimin)
AC3	Bërja e kërkimeve për shpërndarjen dhe rrezikimin e llojeve detare të rrezikuara dhe mbrojtura	Buxheti i Shtetit dhe Buxheti i Jashtëm	16.000	Në varësi të prioriteteve dhe disponueshmërisë së kërkuesve, bërja e kërkimeve (rreth 4.000 EURO në vit)
TRSHËGIMIA KULTURORE DHE PEIZAZHI				
BA1	Monitorimi i përgatitjes së dokumenteve të planifikimit hapësinor dhe pjesëmarrja në takime	Buxheti i Shtetit	0	5% Shërbimi i Ruajtjes
BA2	Mbikëqyrja/vëzhgimi i ndërtimeve pa leje dhe inspektime	Buxheti i Shtetit	0	10% Shërbimi i Rojeve Mjedisore/Rangers

Nr. vep.	VEPRIMTARITË	BURIMI I FINANCIMIT	SHPENZIMET E ZBATIMIT (EURO)	SHËNIME SHPJEGUESE
	informuese			
BB1	Përditësimi i inventarit të shpellave dhe shkëmbinjve dhe monitorimi i gjendjes së tyre (vëzhgimi)	Buxheti i jashtëm-inventarizimi/Buxheti i Shtetit- monitorimi	10.000	Inventari - 1 vit; Monitorimi nga Shërbimi i Rojeve Mjedisore/rangers apo nga Shërbimi i Ruajtjes - 5% për monitorimin
BC1	Vlerësimi bazë i mbetjeve/rrënojave arkeologjike nënujore dhe monitorimi i tyre	Buxheti i jashtëm	12.000	Vlerësimi - 1 vit - 5.000 EURO; monitorimi vjetor - 1.000 EURO
MBËSHTETJA E KOMUNITETEVE VENDASE DHE PËRDORIMI I QËNDRUESHËM I BURIMEVE NATYRORE				
CA1	Vlerësimi bazë i rezervave të peshkut dhe më pas monitorim periodik	Buxheti i jashtëm	24.000	Vlerësimi - 1 vit - 15.000 EURO; monitorim çdo dy vjet - 3.000 EURO
CA2	Studimi social-ekonomik mbi peshkimin lokal (të ardhurat, pajisjet, përpjekjet për peshkim) dhe më pas monitorimi	Buxheti i jashtëm	4.000	Metodologjia dhe analiza - 15 ditë - 2.500 EURO; puna në terren - 10 ditë - 50 EURO = 500 EURO
CA3	Mbikëqyrja/vëzhgimi i peshkimit të paligjshëm dhe inspektim informues	Buxheti i Shtetit	0	40% Shërbimi i Rojeve Mjedisore/Rangers
CA4	Veprimtari periodike për zbatimin e ligjit nga ana e policisë dhe inspektoratit (kontroll në det i zbatuar nga autoritetet)	Buxheti i Shtetit (jo për ZMD)	0	Komunikimi; 5% Shërbimi i Rojeve Mjedisore/Rangers (punë e përbashkët në terren)
CA5	Krijimi i një shoqate të peshkatarëve artizanale (meqë nuk janë pjesë e OMP-së dhe kësaj nuk përfaqësohen)	Buxheti i jashtëm	5.000	Takime, komunikim dhe regjistrim
CA6	Promovimi i vlerave të peshkimit vendas: ngritja e sistemit të etiketimit për produktet e peshkut	Buxheti i jashtëm	30.000	Analiza e marketingut, analiza e produktit, ngritja e sistemit, etj.
CB1	Hartimi i listës së atraksioneve turistike dhe përditësimi periodik i saj	Buxheti i jashtëm	5.000	Takime
CB2	Lehtësimi i procedurave të qarta dhe të lehta për hyrjen/aksesin e operatorëve turistikë (nga deti dhe toka)	Buxheti i Shtetit	0	10% Shërbimi i Ruajtjes
CB3	Lehtësimi i lejimit të hyrjes/aksesit të lirë për turistët në ZMD nga toka	Buxheti i Shtetit	0	Së bashku me sa më sipër
CB4	Forcimi i bashkëpunimit mes operatorëve turistikë për cilësinë e paketave turistike dhe produkteve (standardet, cilësia e shërbimeve)	Buxheti i jashtëm, AKT	20.000	Takime (4 në vit)
CB5	Përmirësimi i bashkëpunimit mes operatorëve turistikë kombëtarë dhe operatorëve turistikë vendas	Buxheti i jashtëm, AKT	10.000	Takime (2 në vit)
CB6	Futja e standardeve të cilësisë në bizneset turistikë (sistemi i licencimit)	Buxheti i jashtëm, AKT	10.000	Përgatitja e standardit - 2 vjet (kontraktuesi); përmirësimi në takime(shih më sipër)
CB7	Certifikimi (kriteret GSTC) për destinacionet e turizmit të qëndrueshëm	Buxheti i jashtëm	10.000	Mbledhjet e forumeve të grupeve të interesit, procesi i certifikimit (p.sh. ECST)
CB8	Qendër informacioni në Karaburun (kioskë)	Buxheti i jashtëm	10.000	1 qendër informacioni për Karaburunin-

Nr. vep.	VEPRIMTARITË	BURIMI I FINANCIMIT	SHPENZIMET E ZBATIMIT (EURO)	SHËNIME SHPJEGUESE
				kioskë e re, pajisje të reja
CB9	Studimi i fizibilitetit për futjen e sistemit të tarifave	Buxheti i jashtëm	10.000	Studimi i fizibilitetit
CB10	Mbështetja e qendrave profesionale të zhytjes (materiale promovuese, evenimente etj.)	Buxheti i jashtëm	15.000	Materialet promovuese, evenimentet e promovimit
CB11	Propozimi i kuadrit ligjor për rregullimin e veprimtarive të zhytjes (duke përfshirë edhe kodin e sjelljes për zhytësit)	Buxheti i jashtëm	10.000	Eksperti ligjor dhe konsultimi
CB12	Lista e vendeve/pikave të zhytjes dhe ngritja e infrastrukturës (bovat)	Buxheti i jashtëm	12.000	Lista e pikave të zhytjes- konsultimi - 2.000 EURO; bovat - 10.000 EURO për 15 pika zhytjeje (p.sh. Manta Ray)
CB13	Mbikëqyrja/vëzhgimi dhe monitorimi i veprimtarive të zhytjes, duke përfshirë numrin e zhytësve në një vend/pikë zhytjeje (në bashkëpunim me qendrat e zhytjes)	Buxheti i Shtetit		10% Shërbimi i Rojeve Mjedisore/Rangers
CC1	Pastrimi i plazhit para fillimit të sezonit	Buxheti i Shtetit	10.000	1 ditë para sezonit, 1 ditë pas sezonit
CC2	Realizimi i një studimi për kapacitetin mbajtës të varkave (duke përfshirë varkat për ekskursionet/shëtitorje, varkat lokale dhe turistët që vijnë me anije) dhe turistët në zonë	Buxheti i jashtëm	5.000	Studimi i kapacitetit mbajtës për zonën-varkat dhe turistët
CC3	Monitorimi i numrit të turistëve në plazhe gjatë sezonit të verës	Buxheti i Shtetit		10% Shërbimi i Rojeve Mjedisore/Rangers gjatë stinës së verës
CC4	Monitorimi i cilësisë së ujit të detit gjatë sezonit të verës	Buxheti i Shtetit	20.000	Më shumë vende se skema kombëtare; çdo dy javë gjatë stinës së verës (qershor-shtator)
NDËRGJEGJËSIMI DHE EDUKIMI				
DA1	Rritja e ndërgjegjësimit dhe përhapjes së informacionit për ZMD-të, vlerat dhe statusin e saj për komunitetin vendas dhe turistët (duke përfshirë sasinë e plehrave në plazhe, cilësinë e ujit, zonimin, etj.), nëpërmjet faqeve të internetit dhe mediave	Buxheti i Shtetit	7.000	Eveniment i Përvitshëm për të prezantuar gjendjen e ZMD-së; Faqja e Internetit- – 2.000 EUR; 5% Shërbimi i Ruajtjes
DA2	Përgatitja dhe shpërndarja e instrumenteve të informimit në lidhje me vlerat e ZMD-së, (Posidonia, llojet e mbrojtura, llojet karizmatike), si edhe për kërcënimet (si të bëhet ankorimi i duhur, llojet invazive, etj.)	Buxheti i jashtëm	6.000	Viti i parë – përgatitja e 3 fletëpalosjeve - 3.000; më vonë – riprintimi (10.000 kopje)
DA3	Përgatitja dhe shpërndarja e instrumenteve të informimit te restorantet në lidhje me llojet e kufizuara/mbrojtura (p.sh. midhja shkëmbshpuese etj.)	Buxheti i jashtëm	3.000	Përgatitja, printimi dhe riprintimi
DA4	Përgatitja dhe shpërndarja e fletëpalosjeve të informimit për rritjen e ndërgjegjësimit të zhytësve (kodi i sjelljes)	Buxheti i jashtëm	3.000	Përgatitja, printimi dhe riprintimi

Nr. vep.	VEPRIMTARITË	BURIMI I FINANCIMIT	SHPENZIMET E ZBATIMIT (EURO)	SHËNIME SHPJEGUESE
DA5	Projektimi, prodhimi dhe ngritja e standave të informacionit/ mirëmbajtja e standave	Buxheti i jashtëm	1.000	Projektimi dhe ndërtimi - 2 stenda
DA6	Projektimi dhe krijimi i shtegut nënujor	Buxheti i jashtëm	8.000	Projektimi dhe ndërtimi - 1 shteg
DB1	Zhvillimi dhe zbatimi i programeve të edukimit në bashkëpunim me shkollat lokale	Buxheti i jashtëm	2.000	Përgatitja e programeve të edukimit/ mësimore - 2.000 EURO; zbatimi së bashku me shkollat lokale; 5% Shërbimi i Ruajtjes
DB2	Rritja e ndërgjegjësimit dhe trajnimi i oficerëve të policisë në fushat që lidhen me menaxhimin e ZMD-së	Buxheti i jashtëm	5.000	Trajnim i përvitshëm 1 ditor
DB3	Mësimdhënia e metodave të peshkimit të qëndrueshëm peshkatarëve të rinj artizanalë (edukimi i peshkatarëve për përdorimin e pajisjeve)	Buxheti i jashtëm	15.000	Përgatitja e trajnimit (5-ditë) dhe zbatimi çdo vit të dytë; 5.000 EURO për përgatitjen; 20 peshkatarë çdo vit të dytë
MENAXHIMI, ADMINISTRIMI DHE QËNDRUESHMËRIA				
EA1	Ngritja e Administratës së Menaxhimit dhe punësimi i stafit	Buxheti i Shtetit		Në planin e burimeve njerëzore
EA2	Forcimi i kapaciteteve të Administratës së Menaxhimit nëpërmjet trajnimit të stafit (pjesëmarrja në programin NC (ngritja e kapaciteteve) për ZMD-të)	Buxheti i Shtetit dhe Buxheti i Jashtëm	2.000	Shuma totale për pjesëmarrje në trajnime
EA3	Ndarja e përvojave përmes pjesëmarrjes në seminare, konferenca (ekspertësh dhe shkencore) dhe shoqata kombëtare dhe ndërkombëtare	Buxheti i Shtetit dhe Buxheti i Jashtëm	5.000	Shuma totale për pjesëmarrje në konferenca
EA4	Sigurimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve të nevojshme për performancën cilësore të ekspertëve/specialistëve dhe rojeve mjedisore	Buxheti i Shtetit dhe Buxheti i Jashtëm		
EB1	Përmirësimi i komunikimit dhe bashkërendimit me grupet lokale të interesit me anë të takimeve periodike para dhe pas sezonit turistik (Universiteti i Vlorës, Marina/porti i Orikuimit, autoritetet vendore, bizneset, OSHC-të, etj.)	Buxheti i Shtetit	8.000	2 takime në vit
EB2	Forcimi i bashkëpunimit me administratën në nivel lokal dhe rajonal	Buxheti i Shtetit		10% Shërbimi i Ruajtjes dhe Shërbimi i Rojeve Mjedisore/Rangers
EB3	Bashkëpunimi me policinë, inspektoratin e peshkimit dhe ushtrinë për përmirësimin e zbatimit të ligjit	Buxheti i Shtetit	5.000	Takimi i përvitshëm (minimalisht)
EB4	Përmirësimi i menaxhimit të peshkimit nëpërmjet vendosjes në bashkëpunimit mes bashkisë dhe Organizatës së Menaxhimit të Peshkimit (në zbatimin e kontrollit në zonë)	Buxheti i jashtëm	5.000	Takime, etj.

5.1 Plani i Burimeve Njerëzore

Në momentin e hartimit të Planit të Menaxhimit nuk ka Administratë Menaxhimi për PKD “Karaburun-Sazan”. Në konsultim me Ministrinë e Mjedisit u ra dakord që në Planin e Menaxhimit duhet të propozohet një strukturë efektive minimale për administratën e ZM-së.

Duke pasur parasysh strukturën aktuale të qeverisjes dhe planet e menaxhimit, mund të pritet që Administrata e Menaxhimit të PKD-së “Karaburun-Sazan” (madje edhe nëse ajo do të menaxhojë të gjitha ZM-të e rajonit) duhet të fillojë punë me dy specialistë/teknikë dhe 4 roje mjedisore. Pritet që të ketë një drejtor rajonal të ZM-së (ose diçka e ngjashme), kështu që ky pozicion nuk është llogaritur në Planin e Burimeve Njerëzore. E njëjta gjë vlen edhe për shërbimet mbështetëse, meqë pritet që të ketë shërbime mbështetëse në nivel rajonal.

Duhet të theksohet se Administrata e Menaxhimit të ZM-së mund të fillojë punë me një staf të vogël dhe pastaj të rritet, nëse e lejojnë rrethanat. Tabela 18 paraqet planin e burimeve njerëzore

Tabela 16: Plani i Burimeve Njerëzore

POZICIONI	NUMRI	PAGA MUJORE (EURO)	PAGA VJETORE (EURO)	BUXHETI TOTAL (10 VJET) (EURO)
Specialisti i Ruajtjes	1	300	3.600	36.000
Specialisti i Komunikimit dhe Zhvillimit Rural	1	300	3.600	36.000
Përgjegjësi i rojeve mjedisore (Rangers)	1	300	3.600	36.000
Roje mjedisore (rangers)	3	200	7.200	72.000
TOTALI	6	1.100	18.000	180.000

6 MONITORIMI DHE VLERËSIMI I MENAXHIMIT

6.1 Monitorimi i Planit të Menaxhimit

Qëllimi i monitorimit të zbatimit të Planit të Menaxhimit është të kontrollojë nëse Plani i Menaxhimit po zbatohet me efektivitet dhe nëse po arrihen objektivat e përcaktuara. Monitorimi gjithashtu mundëson mbledhjen e informacionit nëpërmjet vëzhgimit të ndikimeve të menaxhimit, në bazë të të cilave do të përshtaten veprimtaritë e menaxhimit.

I gjithë stafi i ZM-së duhet të jetë në dijeni të veprimtarive të nevojshme për monitorimin e ndikimeve të Planit të Menaxhimit dhe të mbledhë të dhëna dhe informacionin që do të tregojnë nëse po arrihen objektivat e Planit të Menaxhimit. Në bazë të rezultateve të monitorimit të ndikimeve të Planit të Menaxhimit, do të rekomandohen ndryshime të rregullta të përvitshme në programin e monitorimit të zbatimit. Në atë mënyrë veprimtaritë për vitin e ardhshëm do të mund të përshtaten me përvojën nga realizimi i Planit të një viti më parë ose me rrethanat e ndryshuara dhe njohuritë e reja.

Pas pesë viteve, bëhet analiza e rezultateve të arritura dhe zbatimit të Planit të Menaxhimit, dhe, nëse është e nevojshme, edhe rishikimi i Planit të Menaxhimit bëhet në mënyrën e përcaktuar për adoptimin e Planit të Menaxhimit. Në rast se është e nevojshme, veprimtaritë e menaxhimit do të hartohen përsëri. Në seksionin për monitorimin e zbatimit të Planit të Menaxhimit, është e nevojshme të përfshihet edhe analiza e suksesit të zbatimit të veprimtarive deri atëherë, me fjalë të tjera, e çfarë është dhe nuk është bërë dhe arsyet përse

disa veprimtari nuk janë zbatuar, si edhe njohuri dhe përvoja që u përdorën për rishikimin e Planit të Menaxhimit. Në vitin e fundit të zbatimit të Planit të Menaxhimit, është e nevojshme të ndërmerret vlerësimi i plotë i rezultateve, objektivave dhe vizionit të Planit të Menaxhimit. Rezultatet e këtij vlerësimi do të përfshihen në Planit të Menaxhimit për periudhën e ardhshme të planifikimit. Në Tabelën 19 tregohen veprimtaritë për monitorimin e zbatimit të Planit të Menaxhimit.

Tabela 17: Veprimtaritë për monitorimin e zbatimit të Planit të Menaxhimit

OBJEKTIVI	
Monitorimi dhe mbledhja/dokumentimi i rezultateve të veprimtarive të menaxhimit dhe arritjes së objektivave	
VEPRIMTARITË PËR MONITORIMIN E ZBATIMIT TË PLANIT TË MENAXHIMIT	VEPRIMTARITË E MENAXHIMIT QË PO MONITOROHEN
M1 Siguroni që të bëhen kërkime dhe përgatiten raporte monitorimi dhe që studimet teknike të realizohen nga staf i kualifikuar apo nga stafi i ZM-së, dhe që raportet të paraqiten brenda një kuadri kohor të caktuar.	AA1, AA2, AA3, AB1, AB2, AC3, BC1, CA1, CA2, CB6, CB8, CB9, CB13, CC2, CC4
M2 Regjistroni të dhënat për seminarët edukative të organizuara, programet dhe prezantimet dhe numrin përkatës të pjesëmarrësve.	CB4, CB5, CB6, CB7, CB10, CC1, DA1, DB1, DB2, DB3, DB4
M3 Regjistroni të dhënat për takimet e ndjekura dhe të organizuara dhe rezultatet përkatëse.	AC1, BA1, CA4, CA5, CB2, CB3, CB4, CB10, CB12, EB2, EB3, EB4
M4 Hartoni rregullat dhe rregulloret brenda kuadrit kohor të caktuar dhe përditësoni dokumentet kryesore për të siguruar funksionimin normal të Administratës së Menaxhimit.	AA2, AC2, CB2, CB11
M5 Siguroni futjen e të dhënave mbi llojet kryesore, habitatet, kërkimet, kufijtë e ZMD-së dhe zonave të ZMD-së në bazën e të dhënave GIS.	AA1, AB1, AB2, AC3, BB1, BC1, CA1, CB1
M6 Organizoni dy takime vjetore çdo vit për të siguruar që Administrata e Menaxhimit mund të përgatisë dhe zbatojë planet, projektet, programet dhe strategjitë kryesore të përshkruara në Planin e Menaxhimit.	DA1, EB1, EB3, EB3
M7 Mbani një listë të përditësuar të inventarit dhe të dhënave mbi kushtet e infrastrukturës.	AA4, AA5, CB8, CB12, DA5, DA6, EA4
M8 Vlerësoni nivelin e ndërgjegjësimit të banorëve vendas dhe grupeve të synuara nëpërmjet një sondazhi para dhe pas zbatimit të 50% të veprimtarive edukative.	DB1, DB2, DB3, DB4
M9 Përditësoni rregullisht bibliotekën, arkivat dhe sistemin e informacionit teknik.	All
M10 Regjistroni të dhënat mbi numrin dhe llojin e materialeve informuese.	AC2, DA2, DA3, DA4
M11 Siguroni që Administrata e Menaxhimit të informohet për planet, strategjitë dhe legjislacionin në lidhje me ZMD-në të përgatitura nga agjenci dhe autoritete të jashtme, dhe që të përfshihet në mënyrë aktive në hartimin e tyre nëpërmjet rekomandimeve me shkrim.	BA1
M12 Siguroni që rojet mjedisore/ rangers dhe stafi në terren të raportojnë mbi veprimtaritë e kontrollit dhe monitorimit në lidhje me llojet dhe habitatet e rrezikuara dhe aksesin ndaj zonave të ndjeshme.	AA2, AC2, BA2, BB1, CA3, CB13, CC3
M13 Krijoni dhe mirëmbani një bazë të dhënash për përdoruesit në shkallë të vogël të Parkut dhe veprimtaritë e tyre (peshkatarët, vizitorët e varkave/ varkëtarët, operatorët turistikë, qendrat e zhytjes, etj.).	CA5, CA6, CB6, CB7
M14 Siguroni trajnimin e stafit dhe ngritjen e kapaciteteve.	EA1, EA2, EA3
M15 Përgatisni një vlerësim të plotë të Planit të menaxhimit në vitin e pestë të zbatimit të tij dhe hartoni një version të rishikuar.	

6.2 Vlerësimi i Efektivitetit të menaxhimit

Vlerësimi i efektivitetit të menaxhimit është shumë më i gjerë sesa monitorimi i hollësishëm i zbatimit të Planit të Menaxhimit. Ai realizohet çdo vit nga Administrata lokale e Menaxhimit/ Komiteti i Menaxhimit, së bashku me stafin e Ministrisë së Mjedisit, duke përdorur një instrument vlerësimi si Mjeti i Gjurmimit të Efektivitetit të Menaxhimit (METT).

7 REFERENCAT / BIBLIOGRAFIA

Dedej Z. (2002) Raporti Kombëtar mbi Biodiversitetin Detar dhe Bregdetar. Republika e Shqipërisë, Tiranë.

Antolovic, J., Vaso A., Kashta L., Shutina V., Anagnosti S., Bogdanovic S., Adamic L., Antolovic N. (2005) Mbrojtja e Fokës Mesdhetare (*Monachus monachus*) dhe Habiteteve të Saj. EURASLIC 11. Konferenca e 11-të Bienale e Shoqatës Evropiane të Bibliotekave Shkencore Akuatike dhe Qendrave të Informimit, 4-6 Maj 2005, Split, Kroaci.

Belmonte G., Costantini A., Moscatello S., Denitto F., Shkurtaj, B. (2006) Shpellat nënujore të gadishullit të Karaburunit. (Shqipëri): Të dhënat e para. *Thalassia Salentina*, vol. 29, suppl., faqe. 15-28.

Beqiraj S., Zuna V., Dodbiba E. (2010) Plani Prioritar i Veprimit për ZMD “Sazan- Karaburun”. GEF/UNDP. Tiranë, 74 faqe.

GIZ/GOPA (2013) Udhëzime për qasjen dhe kriteret e zonimit të territorit brenda një zone të mbrojtur. GIZ/GOPA, 21 faqe.

INCA (2013) Plani Strategjik për Zonat e Mbrojtura Detare dhe Bregdetare (SPMCPAs). GEF/UNDP. Tiranë, 70 faqe. + Shtojcat.

IUCN (2014) Lista e Kuqe e Llojeve të Kërcënuara të IUCN-së, [Online], e disponueshme në: <http://www.iucnredlist.org/> [31 dhjetor 2014].

Kashta L. (1992-93) Rezultate të studimit të florës detare të brigjeve shqiptare të Adriatikut. Buletini i Shkencave Natyrore, Tiranë, seria B, Kimi-Biologji, nr.1-4.

Kashta L. (2010) Vlerësimi i Boshllëqeve të ZM-ve, Biodiversiteti detar, Legjislacioni për ZM-të dhe ZMD-të. GEF, UNDP. Tiranë, 195 faqe.

Kashta L., Beqiraj S., Mato Xh., Xhulaj M., Gaçe A. & Mullaj A. (2005) Inventari i habitateve me *Posidonia oceanica* dhe habitateve bregdetare në Shqipëri. Raport Teknik, APAWA, Tiranë, mbështetur nga Ministria e Mjedisit (Raport i pabotuar, në shqip dhe italisht).

NEA (1999) Strategjia e Biodiversitetit dhe Plani i Veprimit - Shqipëri (NBSAP). NEA (Ministria e Mjedisit).

Pergent G., Bellan-Santini D., Bellan G., Bitar G., Harmelin J-G. (2002) Manuali për interpretimin e llojeve të habitateve detare për përzgjedhjen e zonave që do të përfshihen në inventarin kombëtar të zonave natyrore me interes për ruajtjen. UNEP, Plani i Veprimit për Mesdheun. RAC/ SPA, 208 faqe. + Shtojcat.

Puka M. (2012) Studimi Socio-ekonomik e ZMD “ Karaburun-Sazani”. GEF/UNDP. Tiranë, 32 faqe.

Qiriazhi P., Sala S. (2006) Monumentet Natyrore të Shqipërisë. Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave. Ed. IDEART. Tiranë, 1-160.

Sala S., Krutaj F., Meçaj N. (2006) Gjeomorfologjia e Bregdetit Jonian. Ak. Shk. Shqipërisë, Qendra e Studimeve Gjeografike. Tiranë, 1-146.

Stolton S., Hockings M., Dudley N., KacKinnon K., Whitten T., Leverington F. (2007) Mjeti i Gjurmimit të Efektivitetit të Menaxhimit. WWF International: Gland, Switzerland, 22 faqe.

Tilot V. (2009) Propozimi për një Zonë të Mbrojtur Detare në Shqipëri. GEF, UNDP. Tiranë, 93 faqe.

Tilot V., Jeudy de Grissac A. (1994) Diagnostikimi i mjedisit detar dhe bregdetar të Shqipërisë së Veriut dhe Jugut. Dobbin Milus International dhe Programi Prioritar i Veprimeve të Planit Mjedisor të Kombeve të Bashkuara/ Plani i Veprimit për Mesdheun (UNEP-MAP), 105 faqe.

UNDP/GEF dhe Ministria e Mjedisit (2005a) Plani i Menaxhimit. Kompleksi: Llogora-Rrëza e Kanalit-Dukat-Orikum-Tragjas-Radhimë-Karaburun. GEF UNDP-Projekti për Ruajtjen e Ligatinave dhe Ekosistemeve Bregdetare në Rajonin e Mesdheut. Ed. Shqipëri. Drafti Përfundimtar. Ed. MedWetCoast (në anglisht dhe shqip), 144 faqe.

UNDP/GEF dhe Ministria e Mjedisit (2005b) Plani i Menaxhimit të Kompleksit të Ligatinave Vjosë-Nartë. MedWetCoast, 148 faqe.

UNDP/GEF dhe Ministria e Mjedisit (2005c) Ekosistemet Karaburun, Llogora, Rrëza e Kanalit, Orikum dhe Nartë. Vlerat ekologjike, monumentet natyrore, historike dhe kulturore. GEF UNDP- Projekti për Ruajtjen e Ligatinave dhe Ekosistemeve Bregdetare në Rajonin e Mesdheut. Ed. Shqipëri , 47 faqe.

Upton M. (2006) Një studim zhytjeje i bregdetit shqiptar mes Sarandës dhe Vlorës për vlerësimin e potencialit për Turizmin e Zhytjes. Projekti Pilot për Peshkimin i Qeverisë së Shqipërisë dhe Bankës Botërore, planifikimi dhe zhvillimi i ekoturizmit detar. (Faza 1), 69 faqe.

Vangeluwe D., Beudels M-O., Lamani F. (1994) Statusi i Ruajtjes së Ligatinave Bregdetare Shqiptare dhe Popullatat e tyre të Shpendëve Kolonialë (Pelecaniformes dhe Ciconiiformes). Shpendët Kolonialë 19 (Botim i posaçëm 1): 81-90, 1996.

8 SHTOJCAT

Shtojca 1: Llojet detare me interes ndërkombëtar në zonën Karaburun-Sazan të renditura në konventat më të rëndësishme

Shtojca 2: Llojet detare me interes kombëtar në zonën Karaburun-Sazan (sipas Listës së kuqe Shqiptare 2007)

Shtojca 3: Përmbledhje e zonave të mbrojtura nga peshkimi

Shtojca 4: Harta e Parkut Kombëtar Detar “Karaburun-Sazan” (vlerat, kërcënimet, zonat)

8.1 Shtojca 1: Llojet detare me interes ndërkombëtar në zonën Karaburun-Sazan që janë renditur në konventat më të rëndësishme

Emri i llojit	ZVM/BD Protokoll i Konventës së Barcelonës ¹⁰ (1996)		Konventa e Bonit ¹¹ (2006)		Konventa CITES ¹² (2006)	Konventa e Bernës ¹³ (1993)
	Shtojca II	Shtojca III	Shtojca1	Shtojca 2		
Magnoliophyta						
<i>Posidonia oceanica</i>	+					+
<i>Cymodocea nodosa</i>						+
Phaeophyta						
<i>Cystoseira amentacea var. spicata</i>	+					+
Rhodophyta						
<i>Lithophyllum byssoides</i>	+					
<i>Lithophyllum trochanter</i>	+					
Spongia						
<i>Geodia cydonium</i>	+					
<i>Hippospongia communis</i>		+				+
<i>Spongia officinalis</i>		+				+
<i>Petrobiona massiliana</i>						+
Cnidaria						
<i>Corallium rubrum</i>		+				+
Mollusca						
<i>Ranella olearia</i>	+					+
<i>Tonna galea</i>	+					+
<i>Charonia tritonis</i>	+					+
<i>Zonaria pyrum</i>	+					+
<i>Pholas dactylus</i>	+					+
<i>Pinna nobilis</i>	+					
<i>Lithophaga lithophaga</i>	+				+	+
Crustacea						
<i>Homarus gammarus</i>		+				+
<i>Maja squinado</i>		+				+
<i>Scyllarides latus</i>		+				+
<i>Scyllarus arctus</i>		+				+
<i>Palinurus elephas</i>		+				+
Echinodermata						
<i>Paracentrotus lividus</i>		+				+
<i>Ophidiaster ophidianus</i>	+					+
<i>Centrostephanus longispinus</i>	+					+
Pisces						
<i>Anguilla anguilla</i>		+				
<i>Umbrina cirrhosa</i>		+				+
<i>Thunnus thynnus</i>		+				
<i>Sciaena umbra</i>		+				+
<i>Hippocampus guttulatus</i>					+	
<i>Epinephellus marginatus</i>		+				+
<i>Xiphias gladius</i>		+				
Reptilia						

¹⁰Protokoll i për Zonat Veçanërisht të Mbrojtura dhe Biodiversitetit në Mesdhe i Konventës për Mbrojtjen e Detit Mesdhe nga Ndotja

¹¹Konventa e Llojeve Shtegtuese të Kafshëve të Egra

¹²Konventa për Tregtinë Ndërkombëtare të Llojeve të Rrezikuara të Faunës dhe Florës së Egër

¹³ Konventa për Ruajtjen e Jetës së Egër dhe Habiteteve Natyrore Evropiane

Emri i llojit	ZVM/BD Protokoll i Konventës së Barcelonës ¹⁰ (1996)		Konventa e Bonit ¹¹ (2006)		Konventa CITES ¹² (2006)	Konventa e Bernës ¹³ (1993)
	Shtojca II	Shtojca III	Shtojca1	Shtojca 2		
<i>Caretta caretta</i>	+		+	+		+
Pinnipedia						
<i>Monachus monachus</i>	+		+	+	+	+
Cetacea						
<i>Tursiops truncatus</i>	+			+	+	+
<i>Delphinus delphis</i>	+		+	+		+

Burimi: Beqiraj S., Zuna V., Dodbiba E. (2010): Plani Prioritar i Veprimit për ZMD “Sazan – Karaburun”.. GEF/UNDP. Tiranë: 74 faqe.

8.2 Shtojca 2: Llojet detare me interes kombëtar në zonën Karaburun-Sazan (sipas Listës së Kuqe Shqiptare 2007)

Leshterikët e detit

Posidonia oceanica
Cymodocea nodosa

Leshterikët (algat e detit)

Cystoseira amentacea var.
spicata
Lithophyllum byssoides
Lithophyllum trochanter
Tenarea tortuosa
Bornetia secundiflora
Catenella caespitosa
Digenea simplex
Polyphysa parvula

Sfungjerët

Geodia cydonium
Spongia officinalis
Hippospongia communis
Raspailia viminalis
Petrobiona massiliana

Knidarët

Aurelia aurita
Chrysaora hysoscella
Actinia cari
Bunodactis verrucosa
Cladocora cespitosa
Corallium rubrum
Eunicella singularis
Eunicella cavolinii

Anelidët

Sabella spallanzani

Gastropodët

Patella caerulea
Monodonta turbinata
Diodora graeca
Haliotis lamellosa
Aporrhais pespelecani
Ranella olearia
Charonia tritonis variegata
Zonaria pyrum
Tonna galea

Dykapakorët/Bivalvorët

Mytilus galloprovincialis
Lithophaga lithophaga
Pinna nobilis
Pteria hirundo
Glossus humanus
Ostrea edulis
Pecten jacobaeus
Solen marginatus
Chamelea gallina
Tapes decussatus
Venus verrucosa

Krustacetë

Alpheus dentipes

Callinassa tyrrhena
Crangon crangon
Dardanus arrosor
Eriphia verrucosa
Galathea intermedia
Maja squinado
Paguristes oculatus
Palaemon serratus
Palinurus elephas
Penaeus kerathurus
Scyllarus arctus

Ekinodermët

Paracentrotus lividus
Ophidiaster ophidianus
Centrostephanus
longispinus

Peshqit

Hippocampus guttulatus
Mola mola

Zvarranikët

Caretta caretta

Fokat

Monachus monachus

Cetacetë

Delphinus delphis
Tursiops truncatus

Burimi: Beqiraj S., Zuna V., Dodbiba E. (2010): Plani Prioritar i Veprimit për ZMD "Sazan – Karaburun".. GEF/UNDP. Tiranë: 74 faqe.

8.3 Shtojca 3: Përmbledhje e zonave të mbrojtura nga peshkimi

Nenet e ligjit	Zonat e mbrojtura nga peshkimi	Legjenda e hartës	Sipërfaqja (km ²)	% e ujërave territoriale
Rreg. Nr. 1, 2005: Neni . 43/2	Zonë buferike me rreze 2 km nga gryka e lumit Buna dhe rreze 1 km nga gryka e lumenjve të tjerë të Shqipërisë ku ndalohet peshkimi	Grykat e lumenjve	18,40	0,31%
Rreg. Nr. 1, 2005: Neni 43/3/j	Zonë buferike në largësinë 1 milje detare nga vija e bregut ose 50 m izobate, pjesa e jashtme e bregdetit të Karaburunit nga Kepi i Gjuhëzës deri te Rrugët e Bardha	Ndalimi total i peshkimit	6,50	0,11%
Rreg. Nr. 1, 2005: Neni 44/1	Gjiri i Vlorës – kufizohet në veri nga vija bazë e Gjirit të Karaburunit deri në Treport	Ndalohet përdorimi i rrjetave me tërheqje (fundore ose pelagjike)		
Rreg. Nr. 1, 2005: Neni 45/1	Zonë buferike me rreze 2 km nga gryka e kanaleve të komunikimit det-lagunë	Kanalet e lagunave	45,00	0,76%
Rreg. Nr. 8, 2009: Neni 12/1	3 milje detare ose deri në 50 m izobate zonë buferike në bregdet ku ndalohet përdorimi i rrjetave fundore	Ndalohet përdorimi i rrjetave fundore	1599,60	26,87%
Rreg. Nr. 8, 2009: Neni 12/2	Zonë buferike 1,5 milje nga vija bregdetare ku ndalohet përdorimi i rrjetave çift	Ndalohet përdorimi i rrjetave çift	1077,00	18,09%
Rreg. Nr. 8, 2009: Neni 12/2	Zonë buferike 0,3 milje detare nga vija bregdetare ku ndalohet përdorimi i dragave hidraulike	Ndalohet përdorimi i dragave hidraulike	220,00	3,69%
Rreg. Nr. 8, 2009: Neni. 12/3	300 m zonë buferike nga vija e bregut ku ndalohet peshkimi me mrezha	Ndalohet përdorimi i mrezhave	143,00	2,40%

Burimi: INCA (2013): Plani Strategjik për Zonat e Mbrojtura Detare dhe Bregdetare (PSZMDB). GEF/UNDP. Tiranë, 70 faqe. + Shtojcat

8.4 Shtojca 4: Harta e Parkut Kombëtar Parkut Kombëtar të Ekosistemit Natyror Detar pranë Gadishullit të Karaburunit dhe Ishullit të Sazanit (vlerat, kërcënimet, zonat)

